



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në

“ Përkthim Profesional ”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “LOGOS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali
2. Dr. Eriona Çela

Mars /2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Përkthim Profesional” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “LOGOS”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Përkthim Profesional”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH nr.596, datë 04.10.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht, Shqip (pjesërisht gjuhë e huaj e dytë)
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 10 PAK v.a. 2023-2024 10 PAE/ 12 PAK v.a. 2022-2023
18	Numri i studentëve:	5 Studentë v.a. 2023-2024 3 Studentë v.a. 2022-2023
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Master i Shkencave në “Përkthim Profesional” ofrohet nga Departamenti i Gjuhës dhe i Civilizimit Grek, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, i Kolegjit Universitar “LOGOS”, IAL privat, Tiranë.

Programi Master i Shkencave në “Përkthim Profesional” është hapur me urdhër të MASH, Nr. 596, datë 04. 10. 2022 me emërtim diplome Master i Shkencave në “Përkthim Profesional”, në sistemin 2-vjeçar me shkëputje nga puna.

Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata si profesionistë dhe përkthyes të gjuhëve të huaja. Kurrikula e programit është e ristrukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit dytë Krediteve në 120 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në 2 vite akademike.

Programi ofron kualifikim të nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit për të përvijuar studimet në programe të ciklit të tretë në fushën përkthimit dhe studimeve të specializuara gjuhësore.

Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek ofron përveç këtij programi edhe 2 programe të ciklit të parë Bachelor:

- Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek;
- Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi (i paaktivizuar aktualisht).

Këto Programe Bachelor formojnë studentët e ardhshëm të Programit Master në “Përkthim Profesional”, për të cilin është kërkuar ky akreditimi.

Në programin Master i Shkencave në “Përkthim Profesional” rezultojnë të regjistruar:

1. Viti Akademik 2022- 2023: 5 studentë për vitin e parë;
2. Viti Akademik 2023- 2024: 5 studentë për vitin e parë;

Programi Master i Shkencave në “Përkthim Profesional” nuk ka akoma studentë të diplomuar.

DGJCG ka një personel akademik që numëron për vitin akademik 2023- 2024, 8 pedagogë efektive dhe 10 pedagogë me kontratë. Personeli akademik i këtij departamenti është një personel i kualifikuar dhe përmbush të gjitha kriteret e një mësimdhënie cilësore dhe efikase për këtë program studimi.

DGJCG ka marrëdhënie të afërta bashkëpunimi dhe konsultohet vazhdimisht me personelin akademik të Universitetit Aristoteli në Greqi dhe jo vetëm. Kjo gjë i mundëson atij të përmirësojë dhe të marrë eksperiencat më të mira të rajonit për një mësimdhënie cilësore dhe efikase në për zhvillimin e kompetencave të duhura të një përkthyesi cilësor.

Programi i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të Programit Master i Shkencave në “Përkthim Profesional” filloi nga ASCAL, i cili bazuar në kërkesën e KU “LOGOS” për akreditimin e këtij programi, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për:

- Shqyrtimin e dokumentacionit e përcjellë nga institucioni;
- Kryerjen e vizitës në institucion;
- Hartimin e GVJ.

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhet nga:

1. Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali
2. Dr. Eriona Çela

GVJ e përzgjedhur filloi punën e saj fillimisht me shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga KU “LOGOS” në sistemin e Ascal, seksioni ekspertit të jashtëm.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ hartoi pyetjet e nevojshme lidhur me agjendën e përcjellë për takimet në IAL.

Gjatë këtyre vizitave GVJ organizoi takime me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, grupin e vlerësimit të brendshëm, përfaqësues të NJBSC, stafin akademik dhe studentët, përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjatë takimit me GVB u paraqit modaliteti i punës së zhvilluar vështirësitë apo problematikat e hasura dhe zgjidhjet për kapërcimin e tyre. GBV pasqyroj në detaje punën e zhvilluar edhe gjatë takimit dhe saktësoi informacione të nevojshme për GVJ në lidhje me realizimin e hartimit të këtij raporti.

GVJ kreu gjithashtu vizitën e ambienteve në dispozicion të mësimdhënies dhe të nxëniet në këtë program studimi. Takimet me grupet e përmendura më lart, shërbyen për të qartësuar GVJ në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij.

Në vijim të takimeve që u zhvilluan pranë IAL, ku patëm disponibilitetin dhe gatishmërinë e duhur për t’ju përgjigjur çdo pyetje tonën, GVJ hartoi një listë dokumentacioni shtesë të nevojshëm për realizimin e GVJ e cila na u përcoll nga IAL sërish në sistemin e ASCAL. Kjo përkon dhe me fillimin e hartimit të raportit të vlerësimit të jashtëm nga GVJ.

Lidhur me dokumentacionin e përcjellë ai përbëhej nga 72 anekse/ shtojca/ dokumente. Këtij numri iu shtua edhe dokumentacioni plotësues i kërkuar nga GVJ i cili numëronte gjithsej 12 dokumente. Të gjitha këto dokumente janë në funksion të këtij programi studimi lidhur me kuadrin ligjor, menaxhimin institucional dhe administrimin e këtij programi, në lidhje me rregulloret dhe planet strategjike të zhvillimit, stafin akademik dhe studentët, objektivat e programet dhe rezultatet e të nxëniet, aktorët mbështetës, sigurimin e cilësisë dhe administrimin financiar dhe infrastrukturor në dispozicion të tij.

Gjatë gjithë fazës së shqyrtimit të materialeve, takimeve online dhe hartimit të raportit përfundimtar GVJ u asistua nga koordinator teknik i ASCAL përfaqësuar nga Z. Muhamed Prezja. Bazuar në të gjitha sa më sipër GVJ hartoi RVJ – në si në vijim.



Me datë 07.02.2025, GVJ dërgojë nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL draft raportin për programin e studimit Msc në "Përthim Profesional". Pasi KU Logos u njoh me përmbajtjen e draft raportit, me datë 14.02.2025, dërgojë komentet e saj në lidhje me draftin si dhe një sërë evidencash për të provuar gjetjet e saj. GVJ thekson se draft-raporti është hartuar duke u bazuar tek dokumentacioni i ngarkuar në sistem dhe tek ai i kërkuar nga ne si dhe tek përfundimet e nxjerra në bazë të takimeve të realizuara pranë Kolegjit Universitar "LOGOS".

Çdo dokumentacion i përcjellë i realizuar në kohën që nuk i përket periudhës për të cilën akreditohet programi nuk merret më në konsideratë:

1. **Për objeksionin Standardi I.2, Kriteri 5,** Propozimi për një qendër të mirëfilltë trajnimesh profesionale vjen pasi qendra ekzistuese përveç se të përmendur në rregullore gjë që e kemi përmendur në raport tek aktivitetet e zhvilluara, nuk e ka mbuluar formimin e vazhduar profesional të studenteve të diplomuar qoftë këta dhe në të ardhmen dhe pse jo dhe palëve të treta duke qenë që potencialisht mund ta ofrojë diçka të tillë. Vërtet ky program nuk ka akoma studentë të diplomuar, por IAL dhe DGJCG ka. Trajnimet e sjella vetëm 2 ndër vite, përveç se janë shumë të limituara, nuk kanë si objekt formimin e vazhduar të studimeve pasuniversitare për studentët të kësaj IAL, DGJCG. Gjithsesi besojmë që kjo qendër ekzistuese në vijim të punës së saj do të vijojë me aktivitete më domethënëse për studentët dhe stafin akademik. *Në këtë pikë raporti ndryshon duke saktësuar që qendra ekzistuese "Qendra për mësimdhënien dhe të nxëniet" duhet të impenjohet shumë më tepër dhe të ketë një fokus më të qartë për të shtuar aktivitetet në IAL, gjatë vitit akademik, në funksion të formimit të vazhduar me objekt të qartë lidhur me programin e studimit specifik dhe jo vetëm.*
2. **Për objeksionin Standardi I.3, Kriteri 4.** Rekomandimi për shtim të mobilitetit të stafit dhe të studentëve vjen pasi në dokumentacionin IRO i përcjellë, mobiliteti për stafin e brendshëm është i limituar vetëm në 2. Gjithashtu edhe pse të deklaruara në tab. për këtë program studimi, në Tab. 12.1; 12.2, si Aida Zoto PAK (staf i programit Bachelor), ashtu edhe Elena Zerik (staf i programit Bachelor), nuk rezultojnë si mësimdhënëse në këtë programi studimi të Ciklit të dytë pasi nuk kanë ngarkesë në të.
Kjo edhe për faktin që dhe nëse do ishin staf dot ishin në kundërshtim me ligjin pasi me titullin Msc. që ato zotërojnë nuk mund të ofrojnë mësim në një program të ciklit të dytë Master pa zotëruar titullin Dr. Ndër të tjera stafit PAK nuk i takon të marrë mobilitet para stafit PAK.
Për Vasiliki Apostolouda rezulton e njëjta gjë, përgjegjës departamenti dhe staf i DGJCG programit Bachelor, por që nuk zhvillon lëndë të këtij programi, pasi ngarkesa në këtë master për të është zero.
Ndaj gjykojmë që mobiliteti mbetet i limituar dhe i përsëritur vetëm në pak anëtarë stafi DGJI dhe veç një staf në programin në fjalë. GVJ shton që në çdo akreditim të ardhshëm të përcillet dokumentacioni i saktë shoqërues që vërteton këto modalitete pasi raporti IRO ka informacion të panevojshëm si korrespondenca elektronike etj. dhe sërish më pas ajo që përcillet është vetëm një listë emërore. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*

3. **Për Objeksionin Standardi II.1, Kriteri 1** lidhur me gjuhët e programit, bazuar dokumentacionit të paqartë pasi janë sjellë disa versione të tij. Nëse të gjitha rregullimet siç dhe qartësohen janë kryer atëherë IAL duhet të përcillte vetëm dokumentacionin e nevojshëm të saktësuar dhe jo disa versione të tij. Ndaj GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë ka bërë dhe gjykimin në RVJ. Përsëri tek shkresa e sjellë Objeksione ju qartësoni që “Aktualisht, gjuhët zyrtare të programit Master i Shkencave në Përkthim Profesional janë: anglisht, greqisht dhe shqip”, por tek formulari i aplikimit të dhënat e programit Aneksi 4, ju vijoni të deklaroni “Programi i studimit do të jepet në gjuhën angleze si edhe në gjuhën shqipe për lëndët përkatëse sipas kurrikulës, pjesërisht, në gjuhën e dytë të huaj që do të zgjedhin studentët në lëndët përkatëse”. Pra gjuha greke nuk cilësohet në asnjë rast, ndaj në këtë pikë për çdo rast akreditimi tjetër duhet të jeni të kujdesshëm në atë çfarë deklaroni dhe kjo gjithashtu lidhur me dokumentacionin që përcillni.

Pavarësisht shkresës D. 2 drejtuar MASR, datë 24.10 2022, ku ju qartësoni MASR, problematika e përcaktimit të gjuhëve mbetet me sa duket akoma e paqartë se cilat janë gjuhët për këtë program studimi, pasi duhej të ishte reflektuar qartë në kërkesën për këtë akreditim. Ajo çfarë GVJ ka konstatuar është përcjella e dokumentacioneve të paqarta, konfuzionale dhe të pasaktësuar edhe lidhur me kërkesën për këtë akreditim. Për këtë arsye:

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon madje shton që duhet të saktësohen dhe të rakordohet dokumentacioni që përcillet pasi krijon pasaktësira të panevojshme gjë që në një akreditim të ardhshëm duhet të merret detyrimisht në konsideratë.

4. **Për objeksionin Standardi II.1, Kriteri 2.** GVJ në këtë pikë nuk ndryshon mendimin dhe raportin e saj, pasi të mbështetës faktin që përkthimi është më afër tregut se interpretimi, bie në kundërshtim pikërisht me këtë gjë. Formimi i përgjysmuar vetëm në një sektor kaq të gjerë bie në kurriz të formimit dhe të punësimit të ardhshëm të studentëve të këtij programi gjë që është një nga prioritetet dhe objektivat e këtij programi. Formimi i përgjysmuar vetëm në një sektor të ngushtë të tij përgjysmon mundësitë e punësimit të studentëve, kur ju siç e keni përmendur dhe në Aneksin 4, një nga objektivat, objektivi 4 me bold fq.3, **është interpretimi gojor**. Domosdoshmëria është qartësuar më së miri në raport.

Gjithashtu në dok. D. 4 “Study Program” është përcjellë programi i studimit të Universiteti të Aristotelit ku siç dhe duket qartë ofrohen lëndë të interpretimit, ndaj duke qartësuar këtu edhe pikën lidhur me përafrimin e programeve këshillohet konsultimi dhe përafrimi me këtë program dhe me programe të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për një sukses më të madh në rekrutimin dhe punësimin e ardhshëm të studentëve.

Përgëzohet IAL për masat e marra lidhur me planet mësimore.

Lidhur me laboratorin Homodigitalis dhe vlerat që i ka nuk është diskutuar në asnjë rast nga GVJ, efikasiteti dhe multifunksionaliteti i tij, por është shprehur që për një program të tillë është i nevojshëm një laborator tipik përkthimi. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.




5. **Përsëri mbi objeksionin Standardi II.1.** GVJ saktëson që duhet të përcillen dokumentacioni i duhur për akreditimin si dhe dokumentacionet shoqëruese që vërtetojnë ndryshimet përkatëse që janë kryer. Gjithsesi i mbetet mendimit që lidhur me një gjuhë tjetër të huaj si lëndë me zgjedhje shtesë si në çdo program universitar për përkthimin dhe jo vetëm, në gjuhë të huaj, mbetet një sugjerim të cilin DGJCG duhet ta marrë në konsideratë në të mirë të një formimin shumëgjuhësor të studentëve. Kjo i mundëson programit të ofrojë një gamë më të gjerë gjuhësh si dhe studentëve një formim më të plotë si përkthyes dhe interpretues të së ardhmes. Gjithsesi lëndët me zgjedhje janë në mungesë, ndaj dhe lidhur me këtë, DGJCG duhet të marrë masat e nevojshme. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
6. **Për objeksionin Standardi II.1, Kriteri 7.** Lidhur me këtë standard, megjithëqë është përcjellë linku i guidës studentore të programit të Universiteti të Selanikut (qe nuk hapej) por e gjejmë të përcjellë në Dok D. 4, ku programi për akreditim rezulton shumë larg në përafrim me këtë program ku vihet re qartë një ofertë studimesh shumë më e organizuar dhe më efikase për një student të ardhshëm të këtij programi. Aty përfshihen interpretimi, lëndët me zgjedhje etj. Penalizimet që mbart mungesa e përafrimeve të programit është qartësuar më së miri në RVJ. *Raporti në këtë pikë ndryshon.*
7. **Për objeksionin Standardi II.3, Kriteri II.** Përgëzojmë IAL për masat e marra në lidhje me këtë objeksion. *Raporti në këtë pikë ndryshon.*
8. **Për objeksionin Standardi II.3, Kriteri III.**
Përgëzojmë IAL që ka marrë në konsideratë sugjerimin e ofruar lidhur me nivelin e gjuhës shqipe në zbatim të ligjit për arsimin e lartë.
Lidhur me gjuhët e programit tashmë GJV është shprehur disa herë. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
9. **Për objeksionin Standardi II. IV, Kriteri II.** Lidhur me shpërndarjen e orëve të praktikës mësimore. Bazuar në dokumentin e përcjellë D. 6 Vendimi i Departamentit 18/11/2024, rezulton një shpërndarje më e drejtë e tyre, por gjithsesi ju sugjerohet që mos të përfshihen leksione pasi kemi të bëjmë me praktikë tashmë dhe ciklin e formimit teorik studentit e ka përfunduar. *Raportohet mungesë e një manuali apo udhëzuesi të mirëfilltë të praktikës mësimore.*
Raporti në këtë pikë ndryshon, por gjithashtu RVJ sugjeron që për akreditimin e radhës të përcillet saktësimi i duhur në RVB dhe shoqërimi me dokumentacioni përkatës si dhe kryesorja hartimin e një manuali, rregulloreje apo udhëzuesi të praktikës mësimore si për stafin ashtu edhe për studentët.
10. **Për objeksionin Standardi II.3, Kriteri IV.** Përgëzojmë IAL për masat e marra në lidhje me këtë objeksion. *Raporti në këtë pikë ndryshon.*
11. **Për objeksionin Standardi II.4, Kriteri 6.** GVJ e ka shumë të qartë faktin që është një program fare i ri ndaj dhe nuk është shprehur për pjesëmarrje në një konferencë studentore të këtij programi apo DGJCG, por në RVJ thekson pjesëmarrjen e studenteve në konferenca studentore të organizuara në nivel IAL, kjo për të gjithë studentët DGJCG. I mbetemi të njëjtit mendim. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*



12. **Për objeksionin Standardi II.5, Kriteri 1.** IAL referon që nuk ka pasur ndryshime, kjo shumë e drejtë pasi është një program i ri, po kjo bie në kundërshtim me saktësimet dhe ndryshimet e përmendura në lidhje me gjuhët e programit dhe lëndët gjuhë e huaj e dytë që saktësohen nga ana e IAL-së që janë bërë. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
13. **Për objeksionin Standardi II.7, Kriteri I.** Lidhur me pozicionin që personeli i programit ka në projektet e DGJCG rezultojnë të saktësuar, por sërish të përsëritur të njëjtat emra si në mobilitete. Kërkohet përfshirje më e gjerë e stafit akademik të DGJCG dhe këtij programi studimi, si dhe sidomos e studentëve që nuk janë të përfshirë askund. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
14. **Për objeksionin Standardi II.7, Kriteri 5.** GVJ e ka mjaft të qartë që bëhet fjalë për program shumë të ri dhe e ka përmendur vazhdimisht këtë gjatë gjithë raportit pikërisht në mbështetje të këtij programi duke dashur t'i ofrojë atij mundësinë e përmirësimit në të ardhmen. Referuar analizës së tregut të punës GVJ është shprehur tashmë lidhur me të. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
15. **Për objeksionin Standardi II.7, Kriteri 2.** Në RVJ saktësohet lidhur me konferenca të DGJCG dhe jo konferenca studentore. GJV e ka të qartë që përveç që është një program shumë i ri edhe numri i studentëve nuk e justifikon realizimin e një konference studentore, por ata mund të marrin pjesë në konferenca të IAL. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
16. **Për objeksionin Standardi III 1, Kriteri 1.** Lidhur me saktësimin e minutazhit të orës mësimore sipas ligjit në fuqi, që sipas dokumenteve të përcjella paraprakisht rezultonte 60 minuta, përgëzojmë IAL për përcjelljen e dok. D. 8 të përditësimit të kryer lidhur me këtë çështje në rregulloren e përgjithshme ku rezulton që ora mësimore është 50 minuta. *Sugjerohet që i njëjti përditësim duhet të reflektohet edhe në rregulloret e tjera të përmendura lidhur me këtë objeksion. Raporti në këtë pikë ndryshon pas përcjelljes së Dok. D.8.*
17. **Për objeksionin Standardi III.3, Kriteri 2.** Në RVB fq. 36 ku i referohemi kriterit në fjalë thuhet, "Gjithashtu, studentet përdorin TEAMS ku marrin piket e provimeve" dhe nuk do të kishte asgjë të gabuara pasi ky kriter kërkon ekzaktësisht "Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.", për cilin RVJ shprehet që nuk ka dokumentacion vërtetues dhe kur në fakt sistemi Teams e mundëson më së miri realizimin e testeve dhe vlerësimeve elektronike.
Përgjigja juaj na dërgon në një kriter plotësisht tjetër që nuk ka të bëjë me këtë që kemi shprehur. *Raporti në këtë pikë ndryshon.*
18. **Për objeksionin Standardi III.3, Kriteri IV.** Lidhur me detyrat e kursit është vënë thjesht në dukje të saktësohen, por kjo nuk ka penalizuar asgjë në raport. Dokumenti D . 9 lidhur me qartësimin e këtij objeksioni është në mungesë, ndaj me gjithë sqarimin e sjellë me shkrim, *GVJ sugjeron që të përcillet dokumentacioni i saktësuar dhe i duhur në akreditimin e ardhshëm. Raporti në këtë pikë ndryshon*

19. **Për objeksionin Standardi III. 3, Kriteri 6.** Lidhur me afatet e vlerësimeve dhe hedhjes në notave në procesverbal, GVJ e ka fare të qartë se çfarë thotë rregullorja, por RVB është e pasaktë në deklarinimin që bën kur thotë që: “Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre”, kur rregullorja saktëson që për hedhjen e notave në procesverbal afati është brenda 5 ditëve. Është një konstatim për qartësim dhe jo penalizim. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
20. **Për objeksionin Standardi III. 4, Kriteri 1.** Referuar revistës shkencore GVJ saktëson që gjatë periudhës së hartimit të raportit nuk ishte i mundshëm konsultimi i saj online. Pas vënies në dukje të kësaj mungese nga GVJ, IAL mundësoi përcjelljen e linkut përkatës ku mund të kryhet konsultimi dhe verifikimi i revistës me numrat përkatës. <http://www.kulogos.edu.al/al/logos-journals.html>
Duke përgëzuar IAL për punën e kryer dhe publikimin në kohë rekord të tyre pas konstatimit, GVJ deklaroi ndryshimin e raportit të saj në këtë pikë.
21. **Për objeksionin Standardi III. 4, Kriteri IV.** Një seri konstatimesh të sjella nga GVJ, rezultojnë sërish të sjella justifikime që nuk përmbushin atë çfarë kërkohet. GVJ sugjeron edhe njëherë përditësimin e materialeve që përcillen si dhe saktësimin e tyre në vijim pasi krijojnë aludime, pasaktësira dhe konfuzion. Lista e aktivitetit kërkimor të përcjellë ka mangësi pasi mungesa: emrat e stafit që kanë përcjellë aktivitetin, departamenti ku i përkasin, referimi i plotë i botimit: titulli, viti, tipologjia e botimit, linqet apo nr, e volumeve, kodi ISBN, Kodi ISSN, DOI, fq etj. Siç e kemi theksuar në RVJ vetëm 2 staf akademik i DGJCG e ka përcjellë të plotë aktivitetin kërkimor.
Gjithashtu Lista e sjellë me aktivitetet e realizuara i referohet gjithë FSHHKGJ, kur GVJ shprehet vetëm për DGJCG dhe grupeve kërkimore mësimore të këtij departamenti ku dhe ofrohet ky program studimi për të cilin kërkohet akreditimi.
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
22. **Për objeksionin Standardi III. 5, Kriteri 6.**
GVJ i ka fare të qarta rregulloret dhe nuk i referohet atyre, por deklarimit në Aneksin 25 Kriteret dhe plani, ku deklarohet përkatësisht: “Prezantimi i Tezës së Diplomës Pasuniversitare/Master paraqitet dhe mbrohet para një Komisioni të përbërë nga tre anëtarë në një datë dhe vend të përcaktuar nga Komisioni i Mbrojtjes së Diplomës”. *Ndaj edhe GVJ sugjeron përditësim e rakordim të deklarimeve me rregulloret përkatëse.*
Gjithashtu në këtë pikë GVJ sugjeron që komisioni për mbrojtjen e tezës së Masterit me një numër të kufizuar studentësh nuk mund të ketë i barabartë me një komision doktore. Ndaj sugjerojmë rishikimin e këtij numri. Ky ka qenë vetëm një konstatim dhe nuk ka sjellë penalizim në raport. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
23. **Për objeksionin standardi IV.1, Kriteri 1.** GVJ sqaron se pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në Departamentin e Gjuhës dhe Civilizimit Grek për vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar 19 personel akademik, nga të cilët 8 me kohë të plotë dhe 10 me të pjesshme. Ndërsa, për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar gjithsej 22 personel akademik nga të cilët 10 me kohë të plotë dhe 12 me kohë të pjesshme. Megjithatë, nga dokumentet e vëna në dispozicion nuk është deklaruar



asnjë personel ndihmës akademik. Pasi GVI kërkoj plotësim dokumentacioni, u vunë në dispozicion Cv-të e dy personleve akademik të KU "LOGOS" por kjo nuk vërteton angazhimin e tyre si personel ndihmës akademik pasi në këto Cv-të e vënë në dispozicion nuk është specifikuar se këto individë janë të angazhuar edhe në këto detyra. Një angazhim i tillë minimalisht duhet të vendoset në Cv dhe të shoqërohet me një aneks kontrate ose të specifikohet në kontratë një detyrë e tillë në mënyrë që të vërtetohet angazhimi si edhe të bëhen deklaratimet. Për të gjitha më sipër, GVI i qëndron arsyetimit të bërë në RVJ. *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*

24. **Për objeksionin standardi IV.1, Kriteri 2.** GVI sqaron se pas përlllogaritjes së ngarkesës del në pah që IAL nuk e respekton kuadrin ligjor të realizimit të 70% të ngarkesës së programit me personel PAE. Sikurse është theksuar edhe në kriteret dhe standardet e tjera GVI ka marrë në konsideratë faktin që ky program studimi është i ri megjithatë kuadri ligjor duhet të respektohet në vitet në vijim. Për këtë arsye edhe sugjerimi i GVI-së lidhet me masat që duhet të marrë KUL në vazhdim. *Për sa më sipër, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
25. **Për objeksionin standardi IV.1, Kriteri 5** GVI sqaron se në RVB është përmendur fakti se për këtë program studimi vijnë në ndihmë disa ambiente të pajisura me mjetet teknologjike të nevojshme për të praktikuar përkthimin e materialeve specifike. Laboratorët konsistojnë në sallë kompjuteri, mjet ky i cili është shumë i domosdoshëm në profesionin e përkthyesit por edhe laboratorë të tjerë të tillë si Laboratori i Medias dhe Edukimit Digjital, të cilët janë në funksion të të gjithë njësisë kryesore dhe asaj bazë dhe nuk janë specifike vetëm për programin e përkthimit. Por, ajo çfarë u vu re ishte mangësia e një laboratorit **tipik përkthimi**, i cili do të ndihmonte studentët të përvetësonin aftësitë e tyre në përkthim dhe të përmbushnin detyrimet sipas planit mësimor. Gjithashtu, në RVB është specifikuar se "Ajo çfarë vlen të vlerësohet është fakti se përfaqësuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë ishin të vetëdijshëm për këtë mungesë dhe u shprehën se janë duke punuar për t'i garantuar studentëve një laborator të mirëfilltë përkthimi". GVI është besimplotë se diçka e tillë do të realizohet në vitet në vijim. *Për sa më sipër, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
26. **Për objeksionin standardi IV.4, Kriteri 2.** GVI sqaron se në Cv-të e personelit nuk mungon email por në disa raste është vendosur ai zyrtari dhe në disa të tjera ai personal. Edhe sipas formatit Europass vendosja njëkohësisht e email-it personal dhe atij zyrtar është i pranuar. Ky sugjerim lidhet me unifikimin e Cv-ve dhe jo me ndonjë mungesë. GVI vlerëson nismën e zyrës së Burimeve Njerëzore për të bërë formatimet e nevojshme. *Për sa më sipër, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
27. **Për objeksionin standardi IV.4, Kriteri 6.** GVI sqaron se mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe pas verifikimeve në faqen Ueb të KUL është evidentuar se Cv-të e personelit nuk janë të përditësuara dhe të unifikuara. Gjithashtu GVI vlerëson nismën e zyrës së Burimeve Njerëzore në këtë aspekt. *Për sa më sipër, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*



28. **Për objeksionin standardi IV.5, Kriteri 1.** GVJ sqaron se edhe në raport është shprehur se KUL ndjek një procedurë lidhur me planifikimin e përdorimit të burimeve financiare, një gjë kjo e cila është konfirmuar gjatë takimeve në KUL. Megjithatë, sikurse është sqaruar edhe në raport dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi buxhetin afatmesëm nuk përputhet me atë që është deklaruar. Nga dokumentacioni rezultojnë shkresat përcjellëse por nuk ka buxhet bashkëlidhur apo pasqyra financiare që verifikojnë zërat e deklaruar. Informacione të përgjithshme mbi zërat e buxhetit janë pasqyruar vetëm në raportin vjetor të KU “LOGOS” por nuk ka një raport financiar i cili shpjegon zërat buxhetor apo cdo aspekt tjetër financiar të institucionit. *Për sa më sipër, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*
29. **Për objeksionin standardi IV.5, Kriteri 3.** GVJ sqaron se edhe në raport është theksuar fakti se në KUL nuk ekziston një zyrë auditimi dhe se në dokumentacionin e ngarkuar në sistem nuk ka një raport auditimi, të brendshëm apo të jashtëm, përveç pasqyrimeve financiare të paraqitura në raportin vjetor të KUL. Edhe pse institucioni ka vënë në dispozicion së fundmi një raport auditimi të jashtëm sërish dokumentacioni mbetet i paplotë bazuar në atë që është shpjeguar në RVJ. *Për sa më sipër, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*

Ky raport, duke marrë në konsideratë dhe komentet e KUL në lidhje me draft raportin, pasqyron mendimet dhe gjetjet perfundimtare të grupit të vlerësimit të jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në “Përkthim Profesional”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë/ Kolegji Universitar “LOGOS”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit për ciklin e dytë “Master në Përkthim Profesional” është hartuar dhe ofrohet në përmbushje dhe në përputhje me misionin e arsimit të lartë, misionin dhe qëllimin e Kolegjit Universitar Logos, vizionin dhe misionin e Planin Strategjik të Zhvillimit të KU “LOGOS” 2018-2024, për zhvillimin e programeve të studimit, me misionin Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, me misionin dhe veprimtarinë e Njesisë Bazë që e ofron: Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek (DGJCG). Bazuar në Statutin e KU “LOGOS”, (neni 3, pika c), kjo IAL shpreh vullnetin e saj të ofrojë kontributin e tij në përkrahje të prioritetëve strategjike dhe zhvillimore të Shqipërisë. Kjo verifikohet në angazhimin që KU “LOGOS” ndërmerr në përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, e cila përfshin transformimin digjital të vendit, që përputhet me Strategjinë Ndërsektorale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2021 +”. Ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe i shërben qëllimeve dhe misionit të Kolegjit Universitar “Logos”, duke i ofruar shoqërisë shqiptare mësimdhënien, kërkimin dhe përgatitjen e përkthyesve të ardhshëm të cilët do t’i ofrojnë shoqërisë njohuritë e përfutuara në këtë program studimesh të nevojshme sipas nevojës dhe interesave të kësaj shoqërie. Programi i studimit për ciklin e dytë “Master në Përkthim Profesional”, në përmbushje me dokumentet bazë të sipërpërmendura, është gjithashtu në përputhje me interesat kombëtare e nuk bie ndesh me to. Dokumentacioni referues:



	[Aneksi 1. Statuti i KU “LOGOS”, miratuar me vendimin e SA, nr. 5, datë 02.02.2017]; [Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Neni 1, pikat b dhe d.]; [Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026: https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf (fq. 50-52, 63-64, 82-85, 101-102); [Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026: https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf (fq. 50-52, 63-64, 82-85, 101-102) [Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2021 +: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/414 (fq. 31)] [Aneksi 7. Plani Strategjik i Zhvillimit të KULOGOS, 2018-2024, Fq. 9]; [Aneksi 2. Relacion Homo Digitalis]; [Aneksi 3. Relacion DilanEdu]; [Aneksi 1. Statuti i KULOGOS, neni 3]; [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG, Kreu II, neni 4]; [Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ, Miratuar me vendim SA Nr. 7/3, date 7.11.2022, neni 4, fq. 2].
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit për ciklin e dytë “Master në Përkthim Profesional” është, gjithashtu, i hartuar në përputhje me synimet, misionin dhe qëllimet e Statutit KU “LOGOS”, dhe synon përgatitjen e specialistëve me formim gjuhësor e shkencor me drejtim human, me qëllimin që ata të jenë të aftë të ndjekin studime të mëtejshme apo kurse më të përparuara studimi apo të ndjekin një drejtim në ato fusha ku aftësia për të përdorur gjuhën e huaj me efikasitet dhe ndjeshmëri është thelbësore. Synimi kryesor është zhvillimi i njohurive dhe kërkimit shkencor në fushën e përkthimit profesional të gjuhëve bashkëkohore, përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si edhe të dijeve të avancuara mbi shkencën dhe praktikën e përkthimit, duke përgatitur ekspertë përkthyes, të cilët do të jenë të pajisur në teori dhe praktike profesionale me njohuri, aftësi, kompetenca dhe shkathtësi për t’ju përgjigjur kërkesave për cilësi të lartë në

	shërbimet e përkthimit në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Programi synon, gjithashtu, të rrisë sigurinë dhe aftësinë për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara, në fushën përkthimit, për të zhvilluar koncepte shkencore të studimeve gjuhësore si edhe për të krijuar baza për studime të thelluara në të ardhmen në ciklin e tretë të studimeve universitare me kahe të posaçme profesionale si: përkthyes, studiues gjuhësor, etj. Programi për ciklin e dytë “Master në Përkthim Profesional”, synon zhvillimin e njohurive dhe kërkimit shkencor në fushën e përkthimit profesional të gjuhëve bashkëkohore, përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si edhe të dijeve të avancuara mbi shkencën dhe praktikën e përkthimit, duke përgatitur ekspertë përkthyes, të cilët do të jenë të pajisur në teori dhe praktike, me aftësi e kompetenca dhe shkathtësi për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut. Programi synon formimin e të diplomuarve me njohuri dhe teknika të veçanta të përkthimit profesional, duke forcuar vetë-vetëdijen e tyre në lidhje me rolin e tyre vendimtar në shoqëri dhe aftësinë e tyre për t’u përshtatur me kushtet dhe sfidat bashkëkohore të cilat ndryshojnë me shpejtësi; formimin e shkencëtarëve dhe profesionistëve të cilët do të kenë një nivel të lartë të njohurive dhe aftësive të specializuara për të mbuluar nevojat e sektorit publik dhe privat, kombëtar dhe ndërkombëtar; promovimin dhe përf forcimin e gjuhës shqipe në nivel evropian dhe përgjithësisht në nivel ndërkombëtar, duke promovuar shumëgjuhësinë dhe diversitetin kulturor; promovimin dhe përdorimin e teknologjive të reja të përkthimit; bashkëpunimin me komunitetin akademik evropian dhe promovimi i kërkimit shkencor në fushën e Përkthimit të Aplikuar (degë e studimeve të përkthimit që i referohet hulumtimit dhe synon të zbatojë teorinë) si dhe në fushën e Përkthimit Profesional. Në këtë kontekst, mund të theksojmë, se programi i studimit “Master në Përkthim Profesional”, me ofertën e vet akademike plotëson profilin kulturor kombëtar. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i KU “LOGOS”, neni 3]; [Aneksi 5, Rregullore e Programit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, neni 4, objektivat pika 5, fq. 6].
--	---



	[Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ, neni 4, fq. 2]; [Aneksi 21. Analiza e tregut të punës, fq. 1, 3, 5]; [Aneksi 4. Të dhëna mbi Programin e studimit, Objektivat, Pika 1.9. fq. 2,]. [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG, Kreu II, neni 4]; [Aneksi 4. Të dhëna mbi Programin e Studimit, fq. 1-2];
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Programet e studimit të KU "LOGOS"- s, kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. KU "LOGOS"-s synon që, përmes programeve të studimit që ofron, t'i orientojë studentët drejt të menduarit kritik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës. Përmes programeve të larmishme të studimit KU "LOGOS"-s synon të formojë studentë me cilësi, vlera dhe kompetenca për të kontribuar në sektorë të ndryshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare. Ofrimi i këtij programi studimi "Master i Shkencave në Përkthim Profesional" lind si rrjedhojë e studimit të tregut, zhvillimeve strategjike politiko-sociale në Shqipëri, rëndësisë së profesionit të përkthyesit dhe perspektivave të punësimit që ai ofron, Në përputhje me misionin e Kolegjit Universitar "LOGOS", programi i studimit "Master i Shkencave në Përkthim Profesional" vjen si nevojë për të mbuluar kërkesën e tregut për profesioniste të aftë. Qëllimi i këtij programi është zhvillimi i thelluar njohurive dhe aftësive si përkthyes specialistë në gjuhë të ndryshme dhe kërkimit shkencor në fushën e përkthimit profesion. Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", duhet t'i pajisin studentët që zotërojnë një diplomë universitare "Bachelor", sipas kritereve të pranimit të përcaktuara për këtë Program të Ciklit të Dytë të Studimeve, me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i KU "LOGOS", Kreu I, neni 3]; [Aneksi 21. Analiza e tregut të punës, fq. 1, 3, 5];




	[Aneksi 7. Plani Strategjik i Zhvillimit të KU “LOGOS”, 2018-2024]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit “Master i Shkencave në Përkthim Profesional”, Kreu II, neni 6]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit “Master i Shkencave në Përkthim Profesional”, Kreu III, Neni 24], [Aneksi 1. Statuti KU “LOGOS”, Kreu IV, Neni 37, Veprimtaria kërkimore -shkencore].
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Statutin e Kolegjit Universitar "LOGOS". Ai mbështetet në objektiva të qarta profesionale, objektiva të cilat synojnë kualifikimin e nevojshëm për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar, në përputhje të plotë me vizionin afatgjatë të Kolegjit Universitar "LOGOS" dhe të vetë objektivave formuese të programit. Ky program është në përputhje me prirjet globale të zhvillimit, sipas objektivave strategjike të kornizës «Edukimi dhe Trajnimi 2020» për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit, me kuadrin e ri të BE-së për kompetencat kyçe për të nxënëit gjatë gjithë jetës si edhe me objektivin 4 të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Dokumentacioni referues: [Strategic framework – Education & Training 2020 https://web.archive.org/web/20160904152719/http://ec.europa.eu/education/policy/strategic-framework/index_en.htm]; [Aneksi 1. Statuti i KU “LOGOS”, Kreu IV, neni 20, neni 21, neni 22, neni 23/Kreu I, neni 6, f q 7]; [Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm: https://albania.un.org/sq/sdgs/4].
Konkluzione	<i>GVJ në shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë dhe në takimet fizike në Institucion, vëren:</i> <i>Evidentohet:</i> - Që KU “LOGOS” ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare; - Që programi ofrohet në përputhje me interesat dhe qëllimet e IAL; - Që programi ofrohet në përshtatje dhe zbatim të Statutit dhe Rregullores së IAL;

	- Që programi zhvillohet në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit. GVJ vërteton përmbushjen e plotë të këtij standardi, ku nuk ka vend për vërejtje apo sugjerime.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Kolegji Universitar "LOGOS" është produkt i një procesi zhvillimi dhe transformimi të vazhdueshëm. Në vitin 2000, për të mbështetur nevojën për aftësi profesionale në Shqipëri, u licencua Instituti i Formimit Profesional 'Frymë Dashurie' i cili ishte pararendës i zhvillimit të "LOGOS". Në vitin 2009, Instituti i Formimit Profesional 'Frymë Dashurie' u shndërrua në Shkollën e Lartë Private "LOGOS" (SHLP "LOGOS"). Kështu Kolegji Universitar "LOGOS" është licencuar fillimisht me emërtimin Shkollën e Lartë Private "LOGOS" me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 1055, datë 29.07.2009, e më pas ka marrë statusin Kolegji Universitar. Kolegji Universitar "LOGOS" është person juridik privat i njohur nga Legjislacioni Civil dhe Tregtar shqiptar, i regjistruar në regjistrin e organizatave joftimprurëse me Vendimin Nr. 284, datë 26.06.2008, dhe Vendimin Nr. 284/1, datë 22.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në emër të Fondacionit "LOGOS". KU "LOGOS" ka kryer akreditimin institucional dhe me vendim të Bordit të Akreditimit, ASCAL Nr. 58, datë 16.12.2021 dhe e ka përfutur atë për 4 vite, afati i së cilës përfundon më 15/12/2025. Akreditimi i parë institucional i IAL me VBA, Nr. 95, datë 20.10.2017 Sot, Kolegji Universitar "LOGOS" përbëhet nga 3 fakultete e 9 departamente dhe ka 17 programe në të dy ciklet e studimit me një staf akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit. Fakulteti i Shkencave të Humane humane dhe komunikimit gjuhësor hapur me Urdhërin e MASH, Nr. 408, datë 13.07.2018. ku bën pjesë dhe ky program është i përbërë nga 3 departamente:

	a. Departamenti "Gjuhë dhe Civilizim Grek"; b. Departamenti "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", sot Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë; c. Departamenti "Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze" sot Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës. Departamenti i GJCG që ofron këtë program Masteri është licencuar më Urdhër të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Nr. 433, datë 20.07.2018. DGJCG ofron 3 programe studimi: 1. Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek; 2. Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi; 3. Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Programi Masteri Shkencave në Përkthim Profesional është hapur me urdhër të MASH, Nr. 596, datë 04. 10. 2022. Me vendim Nr. 69 datë 10.09.2022, është kryer akreditimi nga Bordi i akreditimit i ASCAL për një periudhë prej 4 vitesh i programi Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek. Stafi i KU "LOGOS" është një staf i kualifikuar dhe i angazhuar në projekte ndërkombëtare për promovimin dhe rritjen e cilësisë së këtij fakulteti. Ndërkaq lidhur me promovimin KU "LOGOS", me vendimin Nr. 1, datë 19.01.2023, për vitin akademik 2023- 2024, ka ngritur gjithashtu edhe grupin qendror në nivel kolegji, për të drejtuar procesin e këshillimit të karrierës dhe rekrutimin e kandidatëve për në këtë Kolegj dhe gjithashtu kryen veprimtari si: 1. Ditët e Informimit dhe Këshillimit për Karrierën 2. Ditët e Karrierës 3. Open Day (ditët e hapura) 4. Si dhe përgatit materiale promocionale të dokumentuara në shtojcën 4 të Aneksit 24. KU "LOGOS" ka gjithashtu faqen e saj ueb si dhe përdor gjerësisht rrjetet sociale: Ueb: www.kulogos.edu.al Facebook: https://www.facebook.com/kulogos.edu.al Instagram: https://www.instagram.com/kulogos/ Stafi akademik dhe administrativ i KU"LOGOS" ka kryer <u>në mënyrë të kufizuar mobilitete</u>.
--	--

Lidhur me këtë kriter GVJ shprehet që është nevojshme një pjesëmarrje më e gjerë e stafit dhe e studentëve në këto mobilitete pasi verifikohen vetëm 2 pjesëtarë me mobilitete të përsëritura, kur mund t'i kryenin edhe të tjerë anëtarë të stafit akademik.

Ky staf ka marrë pjesë në trajnime në kuadër të Erasmus si dhe merr pjesë në hartimin e projekteve kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të përditësimit të njohurive dhe kompetencave të veta profesionale.

KU "LOGOS", tregon që zotëron kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike të përkthimit për ofrimin e programit të studimit "Master i Shkencave në Përkthim Profesional".

Aktualisht, personeli akademik i DGJCG i brendshëm dhe i jashtëm dhe prania e lektorëve të huaj, tregojnë që ky personel ka një përvojë të konsiderueshme në fushën e mësimdhënies, hartimit të fjalorëve të ndryshëm, përkthimin e teksteve të ndryshme, hartimit të projekteve etj.

DGJCG ka kryer gjithashtu një trajnim për stafin akademik lidhur edhe me kurrikulën e re.

KU "LOGOS", duke gërshtuar mësimdhënien nga stafi akademik i kualifikuar brenda dhe jashtë vendit me kërkimin shkencor, synon të përgatisë me këtë program studimi jo vetëm specialistë të fushës së përkthimit, por synon gjithashtu forcimin e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit së tyre në lidhje me rolin e tyre vendimtar në shoqëri dhe aftësinë e tyre për t'u përshtatur me kushtet dhe sfidat bashkëkohore të cilat ndryshojnë me shpejtësi.

Dokumentacioni referues:

[Aneksi 1, Statuti, Neni 1, Statusi i Institucionit, fq. 5];

[Aneksi 7. Plani Strategjik i Zhvillimit 2018- 2024, fq. 3];

[Aneksi 11. Baza ligjore];

[Aneksi 66. Dokumenti i Akreditimit të Programit Bachelor];

[Aneksi 54, Vendimi i Rektorit për organizimit të fushatës së informimit];

[Aneksi Plani strategjik fq.4)];

[Aneksi 53.1. Aktivitete informimi];

[Aneksi 23 Kritere Pranimi + aktivitete];

[Aneksi 2. Relacioni DilanEdu];

[<http://www.kulogos.edu.al/al/index.html#>];

	[Projekti Roaming- http://kulogos.edu.al/al/single-neës.html?id=672c94885438864d16dd1912]; [https://erasmus.kulogos.edu.al/]; [Fjalori i anasjelltë i gjuhës shqipe- http://www.kulogos.edu.al/al/reverse-dictionary.html]; [Aneksi 29. Filozofia dhe karakteristikat e kurrikulës së re bazuar mbi kompetenca]; [Aneksi 27. CV PAE, PAK, e plota të stafit akademik]; [Aneksi 19. Raporti vjetor, Pika 1.3 Veprimtari Krijuese & Inovacion]; [Aneksi 4. Të dhëna mbi Programin, Objektivat 1.9.1, fq. 2]; [Aneksi 19. Raporti vjetor i KU “LOGOS”. Veprimtari Krijuese & Inovacion].
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësishë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësishë kryesore të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në të cilin Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek bën pjesë, i cili është i organizuar në tre programe studimi si më lart përmendur të lidhur ngushtë me njëri tjetrin. Rregullorja e programit të studimit 'Master i Shkencave në Përkthim Profesional' mbështetet në ligjin nr. 80/2015, data 22.07, 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen me të; në Statutin e KU “LOGOS”; në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Programi i studimit “Master i Shkencave në Përkthim Profesional”, i referohet nivelit 7 të kornizës shqiptare (dhe evropiane) të kualifikimeve. Lidhur me kodifikimin e programeve KU “LOGOS”, me vendimin Nr. 2 date 04.02.2020 për “Miratimin e udhëzuesit për kodifikimin e lëndëve mësimore të programeve të studimit të ofruara nga Kolegji universitar “LOGOS”, në zbatim të VKM nr. 41, datë 24.1.2016, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Shtojca 2 e cila parashikon që për secilën lëndë mësimore të përcaktohet kodi i lëndës, bazuar në propozimin e paraqitur nga Komisioni i Kurrikulave, Senati Akademik.

	Bazuar në dokumentacioni përkatës GVJ, Aneksi 22. 1. Udhëzues për Kodifikimin e programeve, konstaton që Kodi i propozuar i këtij programi: 72MS 0239 S 72MS. Programi është Master Shkencor dyvjeçar, i cili korrespondon me 120 ECTS. Pra, sipas nivelit të tij, siç parashikohet nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve, është zgjedhur kodi konkret: 0239. Kjo pjesë e kodit përshkruan fushën e saktë shkencore të Programit të Studimit. Masteri Profesional i Shkencave në Përkthim i përket kategorisë më të përgjithshme Gjuhë të huaja, sepse Programi i Studimit është i strukturuar rreth tri gjuhëve: anglisht, greqisht dhe shqip, dhe konkretisht përkthimi i teksteve nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas, si dhe përkthimi nga greqishtja në shqip dhe anasjelltas. Si nënkategori është zgjedhur Gjuhë të huaja. Është përzgjedhur ky kod sepse Programi i Studimit sillet rreth tri gjuhëve, shqip, anglisht dhe greqisht. Qëllimi kryesor i Programit është përftimi i aftësive për të përkthyer nga greqishtja dhe anglishtja në shqip dhe anasjelltas. Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. Plani mësimor]; [Tabela 1- 24. Tabela 4]; [Aneksi 33. Rregullore FSHHKGJ, Kreu I, Baza Ligjore, Neni 2); [Aneksi 4. Të dhëna mbi programin e studimit]; [Aneksi 22. 1. Udhëzues për Kodifikimin e programeve]; [Aneksi 22.2. Kodifikimi i Programit]
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit "Master i Shkencave në Përkthim Profesional", është në përputhje me fushën akademike dhe punën kërkimore të DGJCG, i cili është përgjegjës për programin e studimit. Ky departament që ofron siç e kemi thënë më lart 3 programe bachelor ku dy prej tyre "Gjuhë dhe Civilizim Grek" edhe në "Gjuhë Angleze dhe Teknologji Përkthimi", <u>ky i fundit është joaktiv</u>, që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me Programin e ciklit të dytë të studimit "Master i Shkencave në Përkthim Profesional" me kohë të plotë. Në vazhdim të ciklit të dytë të studimeve, fusha e përgjithshme ndërthuret mjaftueshëm me fushën akademike të njesisë bazë. Ky program studimi në shkencat humane synon formimin e figurës profesionale të përkthyesit. Kjo figurë profesionale do të jetë e domosdoshme jo vetëm për realizimin e objektivit kombëtar në

	procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por edhe për lehtësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të vendit tonë në fusha të ndryshme të bashkëpunimit global. Evidenohet: - <i>Programi Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi” rezulton i paakvizuar, ndaj si program potencial për vijueshmërinë e studimeve për studentë të këtij Programi të Ciklit të dytë në këtë moment nuk mund të merret në konsideratë.</i> Sugjerohet: - <i>Promovimi dhe Rekrutimi i studentëve të programit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi, pasi ata janë realisht e ardhmja potenciale e këtij programi studimi në shqyrtim.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 4. Të dhëna mbi programin e studimit];
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	GVJ në dokumentacioni e përcjellë RVB konstaton që Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor/Kolegji Universitar “LOGOS”, nuk ofron programe studimore në drejtime specifike jashtë profilit të institucionit. Dokumentacioni referues: [Dok. 5. RVB]
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GJV konstaton bazuar në RVB dhe dokumentacionet e përcjella që Kolegji Universitar “LOGOS” nuk ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Sugjerohet: <i>Lidhur me këtë kriter që Institucioni në këtë drejtim të shohë mundësinë që “Qendra për Mësimdhënien dhe të Nxënërit” miratuar me vendim SA Nr. 20, date 15.10.2024, të ketë një aktivitet më gjerë dhe më efektiv e me fokus më të qartë dhe të ofrojë një formim më të vazhduar profesional stafit akademik, studentëve të diplomuar qoftë këta dhe në të ardhmen si dhe pse jo dhe palëve të treta duke qenë që potencialisht mund ta ofrojë diçka të tillë.</i>

	Dokumentacioni referues: [Dok. 5. RVB] [D1. Miratimi i rregullores së Qendrës për mësimdhënien dhe të nxënit]			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe takimet institucionale vëren që ky standard përmbushet kryesisht duke marrë në konsideratë që ka një mobilitet të limituar dhe mungesën e një aktiviteti më efektiv dhe me fokus të qartë të për fomimin e vazhduar të stafit dhe studentëve të diplomuar në të ardhmen si dhe nevojën për të mundësuar rekrutimin nga Qendra e Mësimdhënies ekzistuese.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ në shqyrtimin e dokumentacionit konstaton që me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, KU “LOGOS” për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive bazë e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. KU “LOGOS”, koordinon dhe mbikëqyr punën e secilës prej njësive me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tyre dhe komponentëve përbërës si: programe mësimore, stafi akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, studentë, mësimdhënie, shërbime të logjistikës dhe shërbime të tjera që ofrojnë. Analiza e vazhdueshme e kësaj pune pasqyrohet në raportin vjetor të KU “LOGOS”, të FSHHKGJ. Struktura si Komisioni i Përgjithshëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe një sërë dokumentesh mbështetëse të cilat mbështeten te ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë

	dhe Manuali i ASCAL për Vlerësimin Institucional dhe te programeve te studimit. DGJCG në bashkëpunim me NJSBC e institucionit vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të këtij programi studimi. Institucioni ka ngritur Zyrën e çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës e cila bashkëpunon me DGJCG për krijimin e bazës së të dhënave me sugjerimet përkatëse nga rrjeti i të diplomuarve dhe punëdhënësit e studentëve. Në përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij, njërive kryesore dhe njërive bazë të Kolegjit Universitar LOGOS u vijnë në ndihmë një sërë shërbimesh nga njësitë ndihmëse akademike dhe administrative te tilla si: Sekretaria Mësimore, Biblioteka, staf akademik dhe administrativ, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Protokollit dhe Arkivit, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës dhe ajo e shërbimeve. Këto struktura paraqiten në mënyrë transparente edhe në faqen zyrtare të institucionit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti]; [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme]; [Aneksi 18. Raporti vjetor KU “LOGOS”, 2022- 2033]; [Aneksi 19. Raporti vjetor i FSHHGJ]; [Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ]; [Aneksi 13. Politika për Sigurimin e Cilësisë]; [Aneksi 10. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore]; [Aneksi 65. Formular vlerësimi për ish- studentin]; [www.kulogos.edu.al]; [Aneksi 1. Statuti, Organigrama e KU “LOGOS”].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit,	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KU “LOGOS” dhe njësitë e saj përbërëse lidhin marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe për zhvillimin e veprimtarive mësimore e kërkimore të përbashkëta, me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Për të përmbushur vizionin e programit te studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, Kolegji Universitar “LOGOS”, synon dhe siguron bashkëpunime mes Institucioneve Arsimore

aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	brenda dhe jashtë vendit, partnerëve të bizneseve me qëllim përbushjen e objektivave të studimit. KU "LOGOS", për realizimin e objektivave të programit të studimit të ciklit të dytë ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si: Universiteti i Maqedonisë Perëndimore e Greqi, Universiteti Aristoteli i Selanikut. Gjithashtu KU "LOGOS" ka një sërë marrëveshjes bashkëpunimi edhe me Institucionet e Arsimit Parauniversitar si: Shkolla jopublike Shqiptaro-Greke "Frymë Dashurie" në Durrës dhe Gjirokastrë. KU "LOGOS" është pjesë e një konsorciumi me Universitetin e Pireut dhe një grup prej pesë universitetesh greke, gjë që është tregues i vullnetit të mirë dhe i synimit të KU "LOGOS", për të zgjeruar bashkëpunimin e saj ndërkombëtar në funksion të përbushjes së objektivave të saj institucionale. Dokumentacioni referues: [Aneksi 15. Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës]; [Aneksi 16. Iro, Raporte nga Zyra Erasmus +]; [Aneksi 17, Memorandume Bashkëpunimi. Marrëveshje bashkëpunimi KU "LOGOS" me IAL brenda dhe jashtë vendit]; [Tab. 1- 24. Tab. 5, fq. 5]; [Aneksi 21. Analiza e tregut të punës, Pika 6.]; [Aneksi 17. Memorandume Bashkëpunimi. Marrëveshje bashkëpunimi KU "LOGOS" me IAL brenda dhe jashtë vendit]; [Tab. 1- 24. Tab. 5, fq. 5]; [Aneksi 21. Analiza e tregut të punës, Pika 6].
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Praktika mësimore e studentëve të programit të studimit "Përkthim Profesional" është disiplinë e detyrueshme që zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Praktika profesionale synon thellimin e aftësimit të studentit dhe zbatimin e njohurive të karakterit praktik dhe profesional të fituara gjatë programit të studimit "Master i Shkencave në Përkthim Profesional", në fushën e përkthimit rrjedhimisht synon të krijojë kushte të nevojshme për njohjen dhe përshtatjen e studentëve në mjedisin profesional.

praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Për realizimin e programit të studimit, institucioni KU LOGOS, ka kryer marrëveshje të posaçme në funksion të programit të studimit “Master i Shkencave në Përkthim Profesional”, për t’u dhënë mundësinë studentëve të kryejnë praktikat profesionale dhe punësimin e tyre gjatë dhe pas studimeve. Për kryerjen e praktikave profesionale KU “LOGOS” dhe FSHHKGJ, kanë marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit të cilët në përfundim të praktikës sëbashku me pedagogun që ndjek praktikën vlerësojnë studentin në përputhje me programin e praktikës profesionale për ciklin e dytë të studimeve. KU “LOGOS” dhe FSHHKGJ ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale apo stazhit. KU LOGOS gjithashtu synon të ketë partneritete të tilla strategjike që i mundësojnë rrugën për zhvillimin e konsorciumeve të institucioneve me aktivitete të përbashkëta bashkëpunimi. Përparësi për KU LOGOS është hartimi dhe fillimi i projekteve kërkimore shkencore, në bashkëpunim me institucione të tjera me përvojë, ashtu siç përcaktohet në Planin Strategjik të Zhvillimit. KU LOGOS mbështet mobilitetin e stafit akademik dhe të studenteve duke marrë pjesë në. Dokumentacioni referues: [Aneksi 16. Iro, Raporte nga Zyra Erasmus +], [Aneksi 17. Memorandume Bashkëpunimi. Marrëveshje]; bashkëpunimi KU LOGO me IAL brenda dhe jashtë vendit]; [Aneksi 16. Iro, Raporte nga Zyra Erasmus +].
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Raportet analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit janë pjesë e integruar e analizës vjetore të KU “LOGOS” dhe “FSHHKGJ” dhe konsistojnë në vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimeve dhe aktiviteteve të mundësuar në kuadër të tyre, (sidomos të trajnimeve konferencave shkencore dhe botimeve) dhe të shkëmbimeve për mobilitete <i>in going</i> dhe <i>out going</i> të stafit dhe pedagogëve, në përcjelljen e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik, dhe nxitjen e mëtejshme të mobiliteteve të stafit dhe studentëve përmes rekomandimeve dhe detyrave për të ardhmen. Evidentohet: - <i>Në lidhje me mobilitetet e stafit akademik vihet re një mobilitet i limituar i stafit përkatës të këtij programi</i>

	<i>studimi, i kufizuar apo përsëritje i vetëm një apo dy anëtarë të stafit.</i> - <i>Vihet re një përsëritje e vazhdueshme e mobilitetit të personelit administrativ të KU "LOGOS", kur do të ishte i nevojshëm shtimi i mobiliteteve të të gjithë personelit akademik mësimdhënës të DGJI.</i> - <i>Mungesë e përcjelljes së dokumentacionit të saktë lidhur me mobilitetet. Raporti IRO jo i hartuar siç duhet. Në vijim u përcoll sërish vetëm një listë emrash pa shoqërim dokumentacioni të plotë.</i> - <i>Nuk paraqitet informacion për mobilitete të studentëve të këtij programi studimi.</i> Sugjerime: - <i>Të mundësohet mobiliteti i anëtarëve të ndryshëm të personelit akademik të këtij programi studimi si dhe i studentëve të tij në të ardhmen.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi I6. Iro, Raporte nga Zyra Erasmus +].			
Konkluzione	<i>GVJ në dokumentacioni e përcjellë dhe në takimet fizike të kryera në Institucion vëren që kçy standard përmbushet kryesisht duke konsideruar numrin shumë të limitura apo në mungesë të plotë të mobiliteteve të stafit të DGJCG, stafit të këtij programi dhe studentëve të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1				
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e	Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional i ofruar nga DGJCG, KU "LOGOS", bazuar në LAL nr.80/2015			

programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kreu VII, Neni 69, Pika 2 dhe Neni 70, Pika 1,2 dhe 4, është i organizuar në module, të vlerësuara në kredite në përputhje me Sistemin European të transferimit të krediteve (ECTS), parashikuar kjo në Statutin e Ku "LOGOS" Neni 28, 31 dhe në Rregulloren e programit Master, Kreu II, Neni 9, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 185, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018".

Referuar Nenit 75, Pika 1, ky program përkufizohet si Master i Shkencave, i klasifikuar në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, LIGJ Nr.10 247, datë 4.3.2010.

Pikës 1.b të Nenit 14 të Ligjit Nr. 82 / 2021, "Për ... profesionin e përkthyesit zyrtar", sipas së cilës, "Të drejtën për t'u certifikuar si përkthyes zyrtar në Republikën e Shqipërisë e ka çdo shtetas që plotëson kriteret e mëposhtme: ... të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë...".

Ky Program Studimi pajis studentët me njohuri të thella teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, bazuar në Nenin 3, Statuti i KU "LOGOS".

Programi ka si objektiv zhvillimin e njohurive dhe kërkimit shkencor në fushën e përkthimit profesional të gjuhëve bashkëkohore, përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si edhe të dijeve të avancuara mbi shkencën dhe praktikën e përkthimit, duke përgatitur ekspertë përkthyes, të cilët do të jenë të pajisur në teori dhe praktikë profesionale me njohuri, aftësi, kompetenca dhe shkathtësi për t'ju përgjigjur kërkesave për cilësi të lartë në shërbimet e përkthimit në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

GJV konstaton, që ngarkesa mësimore javore në auditor për leksione dhe seminare, forma e kontrollit të vazhdueshëm të zhvilluara në auditor për programin e studimit luhaten nga 20 – 25 orë mësimore dhe ora mësimore në Aneksin. 14. Rregulloren e DGJCG, Neni 32, është 50 minutëshe që përkon me VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 është deri në 20-25 orë mësimore 50 minutëshe) Pra, ngarkesa javore është në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi.

GVJ konstaton që në Aneksin 8. Rregullore e Përgjithshme neni 93. Orari i mësimi, ora mësimore është deklaruar 60 minutëshe, ndaj rekomandohet saktësimi edhe në këtë rregullore sipas VKM së lartpërmendur.



Programi është i organizuar në 120 kredite (ECTS), në vijim të ciklit të parë dhe kohëzgjatje normale dy vite akademike. Studimet e këtij programi përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë Master i Shkencave në Përkthim Profesional.

Referuar Rregullores së Programit të Studimit, Neni 13, Krediti dhe llogaritja e tij.

Krediti i formimit universitar i referohet Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) të formimit në arsimin e lartë dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore:

- a) b) 1 krediti i korrespondon 25 orë mësimore pune të studentit në auditor dhe jashtë auditorit si punë e pavarur e tij.
- b) Sasia e punës së kryer, gjatë një viti studimesh universitare, nga një student me kohë të plotë, në këtë program studimi është 60 kredite ose 1500 orë mësimore pune të studentit, që përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
- c) Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore.
- d) Referuar Rregullores së Programit dhe Planit mësimor, lëndët mësimore janë përzgjedhur nga disa fusha studimi të përkthimit, ku gjuha e programit deklarohet gjuha angleze dhe gjuha shqipe dhe pjesërisht në gjuhën e dytë të huaj që do të zgjedhin studentët në lëndët përkatëse gjë që e gjejmë edhe në Aneksin 4 Të dhëna për programin e studimit, *por nuk përmendet në këtë dokument përdorimi me të njëjtën barasvlerë përdorimi i gjuhës greke. Në këtë program gjithashtu nuk kemi të reflektuar një gjuhë të dytë me zgjedhje. Kjo bie në kundërshtim me Rregulloren e Programit ku tek Neni 7, Kreu II, Kriteret pranimit, Pika C, kërkohet qartësisht:*
 - *Zotërimi i gjuhës greke, të paktën në nivelin B2, me dëshmi një certifikatë prej një nga testuesit të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, ose përfundimi i një cikli studimi në nivel universitar në atë gjuhë.*

Dhe në kundërshtim me nenin 14 të kësaj Rregulloreje, Gjuha e studimeve në programin e Përkthim Profesional.



- **Programi i studimit “Master i Shkencave në Përkthim Profesional”, ofrohet në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze dhe gjuhën greke.**

Në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Përkthim Profesional”, disiplinat grupohen mbi bazën e objektivave të tyre formuese duke respektuar raportet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Numri i veprimtarive formuese përbëhet nga 19 lëndë të cilat të gjitha përmbajnë aktivitete përkthimore përgjatë semestrave, si edhe praktika profesionale dhe gjithashtu edhe tema e diplomës.

Lëndët janë ndarë në 5 grupe kryesore:

- (A) lëndë bazë - 2 lëndë;
- (B) lëndë karakterizuese të programit - 11 lëndë;
- (C) lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe me zgjedhje - 4 lëndë;
- (D) Praktika profesionale - 1 lëndë;
- (E) Detyrime përmbyllëse, dorëzimi dhe mbrojtja e Temës së Diplomës.

Evidentohet:

- Lidhur me gjuhën e Programit tek Aneksi 4 “Të dhëna për programin”, deklarohet gjuhë angleze dhe shqipe dhe një gjuhë e dytë me zgjedhje, kur kjo gjuhë me zgjedhje nuk përmendet dhe nuk reflektohet në planin mësimor si e tillë. Plani mësimor nuk ka një lëndë me zgjedhje, as gjuhë të dytë ku të përfshihet gjuha greke e cila zë një pjesë të rëndësishme të barabartë me gjuhën angleze të këtij Plani mësimor. Nga ky plan rezulton qartë që gjuha greke është gjuhë e detyrueshme përderisa është e pranishme në një pjesë të madhe të lëndëve formuese, ndaj saktësimi i gjuhës/ve të programit është i domosdoshëm.
- Vërejtja (2) vjen pasi vetë ky deklaram bie në kundërshtim me Rregulloren e vetë Programit, ku tek Neni 7, Kreu II, Kriteret pranimit, Pika C, kërkohet qartësisht: Zotërimi i gjuhës greke, të paktën në nivelin B2; dhe po e njëjta gjë saktësohet edhe tek Neni 14 i po kësaj rregulloreje.

Sugjerohet:

- **Saktësimi i gjuhëve të programit;**

	Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e Programit, Referenca e programit të studimit në Kornizën Shqiptare dhe Evropiane të Kualifikimeve Kreu, Neni 6]; [Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018- https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/]; [Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve - https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/ligj_10247-2010_04032010.pdf]; [Aneksi 1. Statuti Kreu V, Nenet 28, 31 të Statutit të KU “LOGOS”]; [Aneksi 5, Rregullore e Programit Msc., Elemente të Organizimit, Kreu II, Neni 9, fq. 6]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit, Misioni dhe Objektivat, Kreu I, Neni 4]; [Aneksi 1. Statuti, Programet e ciklit të dytë të studimeve, Kreu V, Neni 31]; [Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ, Neni 21]; [Aneksi 5. Rregullore se Programit të Studimit, Kreu II, Neni 13, Krediti dhe llogaritja e tij]; [Aneksi 4. Të dhëna për programin e studimit, Gjuha e programit]; [Aneksi 5, Rregullore e Programit të Studimit, Kreu II, Neni 7, Kriteret dhe Procedura e Pranimi të Studentëve, Neni 14, Gjuha e studimeve në programin e Përkthim Profesional]; [Aneksi 5, Rregullore se Programit të Studimit. Neni 11. Lëndët dhe veprimtaritë e tjera formuese]; [Aneksi 14. Rregullore e Departamentit, Neni 32].
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës,	Plani mësimor i këtij programi studimi dhe veprimtaritë formuese që e karakterizojnë, të cilat mbështeten në aktivizimin dhe përfitim të kompetencave të larta të përkthimit në dy gjuhë të huaja përpos gjuhës shqipe, të cilat do ta udhëheqin studentin drejt marrjes së kompetencave profesionale të vlefshme për ushtrimin e profesionit të tij. Programi i studimit u mundëson studentëve në nivelin Master të fitojnë njohuri të thella për proceset e përfshira në fushën e përkthimit <i>(por jo të interpretimin një aftësi kyçe dhe e</i>

zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

domosdoshme për përkthyesit dhe interpretët e rinj), gjë që bie ndesh me sa deklarohet më objektivat e këtij programi lidhur me nevojat për përkthyes për integrimin evropian që domosdoshmërisht kërkon dhe interpretë të aftë gjuhësorë pasi përkthimi siç dihet nuk është vetëm shkrimor por edhe ai gojor, ashtu siç dhe thuhet lidhur me objektivat e këtij programi në Aneksin 4. Të dhënat e programit duke kundërshtuar kështu vetveten dhe jo vetëm.

Evidentohet:

- *Lidhur me Programin dhe mungesën e lëndëve formuese të rëndësishme që lidhen posaçërisht me Interpretimin. Programi në fjalë nuk parashikon asnjë lëndë të këtij formimi, kaq të rëndësishëm për përkthyesit e së ardhmes të cilët nuk mund të formohen vetëm në tekstin e shkruar, kur nevoja e tregut cilëson një kërkesë gjithnjë e në rritje sidomos për këtë kategori përkthyes/interpret. Një formim vetëm në një sektor të atij të tekstit të shkruar, krijon mangësi formuese të plota që i nevojiten përkthyes/interpretit të ardhshëm. Mosformimi dhe mospërgatitja në këtë aspekt kaq themeltar dhe të domosdoshëm, penalizon punësimin në të ardhmen të studentëve të këtij. Gjithsesi kjo mbetet në varësi të departamentit që ofron këtë program studimi.*
- *Formimi vetëm në një sektor të ngushtë u heq studentëve një mundësi që realisht është nevojë e tregut, sidomos argumentimi që u vu në pah disa herë dhe gjatë vizitave lidhur me nevojën e tregut në kontekstin e integrimit evropian dhe sidomos në përputhje me çka deklarohet tek Aneksi 4 "Të dhënat e programit" lidhur me formimin e interpretëve gojorë, ku në këtë program kjo gjë as që përmendet fare.*

Gjithashtu lidhur me planet mësimore

Evidentohet:

- *Qw planet mësimore të sjella paraqiten të ndryshme në dokumente të ndryshme i vetmi dokument që e sjell atë me të gjitha elementet dhe saktësimet e nevojshme për një plan mësimor është Tabela 10. Në dokumentin 1- 24.*
- *Shpërndarje e mirë por deri diku jo e balancuar e krediteve të paktën për një lëndë që rezulton me 1 kredit kur pjesa më e madhe e tyre rezulton me 5- 6 ETC, gjë që*

çekuilibron harmoninë e brendshme të planit mësimor dhe të formimit të studentëve;

- *Lëndë si Nëntitullimi që janë të nevojshme, por që nuk mund të ketë të njëjtën baraspeshë kreditesh me lëndë bazë parësore për formimin profesional të një përkthyesi, vetëm nëse ai do të ndërthurej ashtu siç duhet të jetë realisht me titrimin dhe dublimin për mediat audiovizuale, por vallë ai zotëron softwarët apo laboratorët KU "LOGOS" kaq të nevojshëm për këtë proces shumë formues dhe mjaft i kërkuar më treg. GVJ nuk ka informacion lidhur me këtë aspekt.*
- *Mungesë të lëndëve me zgjedhje;*

Sugjerohet:

- *Rishikimi i i programit lidhur me zhvillimin e aftësive përkthimore për formimin jo vetëm të përkthyesve të teksteve me shkrim por dhe të interpretuesve por të mos kufizuar mundësitë tregut të punës në të ardhmen, gjë që u shpreh si dëshirë edhe nga ana e studentëve në takimet fizike*
- *Saktësimi dhe harmonizimi i planit mësimor sipas kriterëve e përlllogaritjeve e kërkesave të ligjeve në fuqi;*
- *Shpërndarje e ekuilibruar dhe e harmonizuar e krediteve brenda këtij Programi studimi duke i dhënë vlerën e duhur atyre lëndëve që ofrojnë formimin e duhur bazë, të rëndësishëm e parësor në formimin e studentëve, kjo duke mos lënë lëndë me 1 kredit kur të tjerat janë me 5-6 kredite;*
- *Shtimi i lëndëve që lidhen me Interpretimin dhe Shtimi i lëndëve të Praktikës së Interpretimit. (të konsultohen programe ekzistuese vendase dhe të huaja);*
- *Shtimi i lëndëve me zgjedhje;*
- *Shtimi i një gjuhe të tretë të huaj për një formim më të plotë të përkthyesit të ardhshëm, domosdoshmëri për kohët e sotme.*

Gjithsesi plani mësimor, ofrohen lëndë të specializuara në fusha shkencore si Menaxhimi i Terminologjisë, Nëntitullimi, Përkthimi i Teksteve Specifike dhe Dokumentimi Terminologjik (nga Anglishtja dhe Greqishtja ne Shqip)

	Një fokus i veçantë i kushtohet aplikimit të teknologjisë në aftësitë e përkthimit kjo ofruar nëpërmjet lëndëve si: - Teknologji Përkthimi (Mjetet teknologjike të përkthimit); - Teknologji Përkthimi II Përkthimit (Fjalorët - Mjetet Digjitale dhe Elektronike të Redaktimit). Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. 6,1 Plani mësimor dhe Syllabuset].
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë vëren që Programi i studimit, bazuar në VKM nr 41, datë 24.01.2018, ka të parashikuar 12 kredite ECTS për praktikën mësimore, në kategorinë D si dhe parashikon punën përgatitore të tezës së diplomës e parashikuar me 12 ECTS, në kategorinë E. Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. Plani mësimor]
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Programi i studimit Master Shkencor në Përkthim Profesional që ofrohet nga DGJCG, formon përkthyes në tekstin e shkruar dhe ka vijueshmëri me studimet e programeve të ciklit të parë Bachelor që ofron DGJCG, përkatësisht: 1. Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek; 2. Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi (joaktiv). Programet ekzistuese nuk përkojnë me asnjë nga programet që përmenden në këtë kriter, ndaj si përfundim ky kriter nuk mund të aplikohet këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Programi në fjalë nuk ofron Master Shkencor në fushën e Mësuesisë, por Master Shkencor në Përkthim Profesional, ndaj nuk ka asnjë detyrim t’i përgjigjet këtij kriteri. Programi i studimit Master Shkencor në Përkthim Profesional, nuk ka detyrimin ligjor që të ketë përmbajtje të përbashkët të rregulluar me programe të ngjashme studimi në nivel kombëtar. Studentët e diplomuar aplikojnë për licencim dhe punësim në mënyrë të pavarur, <u>por kjo nuk do të thotë që nuk duhet të shihet nevoja që lind për përafrime për arsye të ndryshme siç e kemi saktësuar edhe në kriterin 7 të këtij standardi.</u>

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Lidhur me këtë kriter dhe arsyetimet që janë sjellë më poshtë lidhur me përafrimin programeve RVJ vëren që Programi e Studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional: Evidentohet: - Në RVB, deklarohet për përmbajtje të ngjashme me Programin Bachelor ekzistues, në Gjuhë Angleze dhe Teknologji Përkthimi, <u>por duke qenë se bëhet fjalë për Program Master GVJ mendon që kjo ngjashmëri mos të konsiderohet, pasi duhet të saktësojmë që në kriter bëhet fjalë për programe të tjera të të njëjtit nivel Master: Masterë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë dhe jo programe Bachelor. Gjithsesi në RVB referohet që ky program ka ngjashmëri me atë të Universitetit "Aristoteli" Departamenti i Gjuhës Frënge në Selanik, por nuk kemi një program të departamentit në fjalë që të bëjmë krahasimet e mundshme</u> - GVJ gjatë takimeve <u>konstatoi konsultimin që DGJCG dhe stafi i tij kishte bërë me ekspertë të huaj lidhur me hartimin e këtij Programi studimesh (kjo u vërtetua gjatë takime fizike dhe mundësi i lidhjes online me profesorët e huaj grekë).</u> - GJV shprehet gjithsesi <u>që përafrimet e programeve sjellin lehtësira lidhur me mobilitetet e studentëve dhe hartimin e programeve për diploma të përbashkëta dhe të dyfishta ndaj kjo duhet parë si mundësi për të ardhmen.</u> Sugjerohet: - RVJ sugjeron të konsultohen, dhe të përafrohen programet jo vetëm për të marrë përvojë por edhe duke

	<i>qenë që është një program shumë i ri dhe ka nevojë të konsolidohet, por edhe me qëllim ndërkombëtarizimin, pasi një program që në pjesën më të madhe të tij nuk paraqet për afërsi penalizon mundësinë e hartimit të programeve për diploma të përbashkëta apo të diplomave dyfishta, si dhe njehsimin e krediteve të mobiliteteve, pasi i vetmi për afërsi është ajo me Universitetin Aristotelis por kjo me departamentin e gjuhës frënge e <u>në rast mobilitetesh</u> studentët nuk mund t'i referohen këtij programi duke qenë që gjuhët e huaj të programit janë: anglishtja dhe greqishtja. Ndaj siç e kemi thënë dhe më lart lind nevoja e rishikimi të këtij programim në këtë aspekt duke konsultuar programet kombëtare dhe ndërkombëtare</i> Dokumentacioni referues: [Dok. 5 RVB]
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	KU "LOGOS", ka hartuar një udhëzues të brendshëm për kodifikimin e lëndëve që ofron, përfshi këtu edhe Programin Master i Shkencave në Përkthim Profesional Ky udhëzues përcakton kodet përkatëse për secilën lëndë. Ky kodifikim bazohet në klasifikimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përcakton kornizën për kodifikimin e lëndëve të programit "Master i Shkencave në Përkthim Profesional". Kodet e lëndëve përbëhen nga: a. Dy shkronjat e para të lëndës mësimore; b. Tri shkronjat e para të fushës së lëndës; c. Kodi numerik sipas vitit të studimit të lëndës; d. Numri sipas renditjes së lëndës në planin mësimor; e. Shkronja që i përket kodit të programit të studimit sipas ciklit të studimit. Programi në fjalë është Master Shkencor dyvjeçar, i cili korrespondon me 120 ECTS. Pra, sipas nivelit të tij, siç parashikohet nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve, është zgjedhur kodi konkret: 0239. KU LOGOS ka propozuar kodin 72MS 0239 S 72MS. Dokumentacioni referues: [Aneksi 22, Udhëzues për Kodifikimin, miratuar me vendimin SA nr. 2 datë 04.02.2020, Pikat: A, B]


Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Master i Shkencave në Përkthim Profesional nuk është një program i përbashkët me një program tjetër, por është strukturuar siç deklarohet në RVB, mbi modelet më te mira në bashkëpunim me institucionet partnere te KU “LOGOS”, si Universiteti “Aristoteli” në Selanik, në mënyrë që studentet të aftësohen me njohuri bashkëkohore për të përballur kërkesat në rritje në fushën e studimeve përkthimore, <i>por për të cilin GVJ ka vërejtjet e saj. (shih kriterin 7 të këtij standardi)</i> Bashkëpunimi me stafin e Universitetit “Aristoteli” në Selanik vihet re qartë edhe në deklarin e personelit të këtij programi dhe jo vetëm por kjo qe qartësisht e verifikueshme edhe në komunikimin online që u krye gjatë takimeve fizike me përfaqësues të këtij Universiteti. <i>GVJ e gjen këtë fakt mjaft pozitiv për këtë program studimi që gjen një mbështetje të kualifikuar tek partnerët e huaj për t’u rritur dhe zhvilluar më tej në të gjitha aspektet e tij.</i> Dokumentacioni referues: [RVB, fq. 17]			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë dhe vizitave fizike në Institucion vëren që ky standard përmbushet pjesërisht për faktin e të gjitha problematikave të paraqitura si më lart në analizën e përshkruar duke vënë në dukje mangësi apo paqartësi lidhur me programin dhe planin mësimor të përcjellë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet fizike konstaton që Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional është Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Njësia kryesore ka në përbërjen e saj 3 departamente: 1. Departamenti i Teologjisë dhe Kulturës; 2. Departamenti i Gjuhës dhe Civilizim Grek;

akademike vlerësimin dhe akreditimin.	3. Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë. Kjo përbërje e FSHHGJHK është në përputhje të plote me detyrimet ligjore në fuqi. Njësia baze përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional është Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek. Në RVB dhe Rregulloret përkatëse, referohet që DGJCG bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor të programeve të studimit që ofron. Po në RVB Rregulloret përkatëse deklarohet që DGJCG është njësi bazë mësimore kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe përmbledh disiplinat mësimore respektive. DGJCG është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor në ciklin e dytë të studimeve “Master në Përkthim Profesional” (120 kredite). Për sa i përket strukturës akademike të njësisë bazë, Departamentit të Gjuhës dhe Civilizimit Grek, në vitin akademik 2023-2024, ajo përbëhet nga 8 PAE (1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 3 Dr., 3 Msc) dhe 10 PAK (4 Prof. As., 6 Dr.), duke respektuar aktet ligjore në fuqi mbi përbërjen e departamentit në institucionet e arsimit të lartë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1: Statuti i KU “LOGOS”]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit]; [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG]; [Dok. 5. RVB].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Mbështetja e proceseve të tilla si ndjekja e praktikave apo asistimi në kryerjen e temës së diplomës për studentet apo dhe orët e laboratorëve, realizohet kryesisht nga stafi akademik efektiv. Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional plotëson të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Stafi akademik i angazhuar në programin e sipërpërmendur të studimit është i larmishëm, dhe i përket kategorisë profesor i asociuar doktor, dhe doktor. Praktika profesionale zë një ngarkesë prej 12 kredite ECTS dhe ndiqet nga personel efektiv i DGJCG. Dokumentacioni referues:



	[Tabela I dhe 2.1].			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ në Aneksin 23. Koordinatori dhe Aneksin 24 Rregulloren e DGCG konstaton që Njësia bazë ka koordinatorin e programit të zgjedhur me vendim departamenti. Koordinatori mbulon problematikat e programit, grumbullimin dhe arkivimin e programeve mësimore si dhe dokumentacionin përkatës dhe raporton tek drejtuesi i departamentit për çdo zhvillim gjatë procesit mësimor dhe çdo aspekt lidhur me të. Detyrat e koordinatorit të Programit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e DGJCG. Evidentohet: - <i>Nuk verifikohet pasi nuk kemi informacion lidhur me faktin që nëse ka një koordinator në rang Njësie Kryesore për Programet Master të FSHHKGJ, rol që zakonisht mbulohet një nga zv. Dekanët.</i> Sugjerim: <i>Evidentimi në të ardhmen të dokumentuar të këtij koordinatori në nivel IAL.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 23. Koordinatori i Programit, miratuar me vendim DGJCG. Nr. Prot. 100, datë 20.12.2022] [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG, Neni 9. Koordinator i Programit të studimit]			
Konkluzione	<i>Përbërja e FSHHGJHK është në përputhje të plote me detyrimet ligjore në fuqi. DGJCG është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor në ciklin e dytë të studimeve "Master në Përkthim Profesional". DGCG konstaton që Njësia bazë ka koordinatorin e programit të zgjedhur me vendim departamenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Si njësi përgjegjëse (kryesore/bazë) për programin e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në Përkthim Profesional, KU "LOGOS" dhe DGJCG, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Elementët përbërës të këtij informacioni janë: - Rregullorja e programit të studimit; - Programi i studimit, i cili pasqyron disiplinat dhe veprimtaritë formuese të grupuara në kategori (bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese, detyrimet përmbyllëse) dhe të formuluarat qartë në planin mësimor, - Plani mësimor i cili përmban lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, kredite; të cilat paraqiten në rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në Përkthim Profesional, rregullore e cila jep në mënyrë të detajuar informacion mbi programin, objektivat, elementet e tij, planin mësimor, lëndë/modulet, kontrollin e dijeve, rregullat e diplomimit, e të etikës akademike, etj., si dhe përshkrimin e programit, i cili është një përmbledhje sintezë e programit që përfshin të dhëna mbi programin dhe institucionin, objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit (profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit të studimit, njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor, mundësitë për punësim), strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit të studimit, programin sipas kompetencave, personelin akademik për programin, planin, kriteret e pranimit. <i>GVJ konstaton që Syllabuset janë hartuar pjesërisht, (shih kriteri 2 i këtij standardi), sipas shtojcës nr. 2 në VKM nr.41, dt. 24.01.2018, VKM 185, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018", diplomën dhe suplementin. Informacioni për programin është i disponueshëm në faqen ueb të KU "LOGOS"</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullorja e Programit]; [Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018- https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-
--	---



	<u>per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/;</u> [Programi: http://www.kulogos.edu.al/al/science-perprof.html]; [Aneksi 6. /6.1. Plani mësimor & Syllabuset]; [Aneksi 5. Rregullore se Programit të Studimit. Neni 11. Lëndët dhe veprimtaritë e tjera formuese]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit, Misioni, objektivat]; [Aneksi 4. Të dhëna për programin e studimit]; [Aneksi 25. Kriteret e pranimit]; [Aneksi 51. Kriteret e pranimit + aktivitetet]; [Personeli Akademik Tabela 2.1]; [Aneksi 6.2. Diploma dhe Suplementi];
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Master Shkencor në Përkthim Profesional përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore ku përfshihet ngarkesën në orë në auditor, me të gjithë komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, format e kontrollit të vazhduar, etj. Komponentët mësimorë në planin mësimor të programit Master Shkencor në Përkthim Profesional, ndahen në leksione dhe seminare, por <i>Plani mësimor paraqet problematika pangjashmërie nga njëri dokument në tjetrin .</i> Evidentohet: - <i>Mospërputhje e planit mësimor të paraqitur në disa dokumente të ndryshme dhe në forma të ndryshme.</i> <i>Kështu në Aneksin 25: Kriteret dhe Plani, paraqiten informacione që nuk përputhen me ato në planin mësimor të paraqitur në:</i> a) <i>Aneksin 51: Krite Pranimi+ aktivitetet;</i> b) <i>Aneksi 6, 61.1: Plani dhe syllabuse;</i> c) <i>tabela 10 në Tabela. 1-24. (i vetmi i plotë dhe i saktë me të gjitha elementet e nevojshëm të një plani mësimor)</i> - <i>Informacionet e përcjella në planin mësimor të pranishme në Aneksin 25 ndryshe nga planet e tjera lidhur me lëndët e Kategorisë C, përkatësisht:</i> • <i>Përkthimi i teksteve të përgjithshme II (Nga frëngjisht në shqip; ose nga italisht në shqip; ose nga greqisht në shqip).</i>

• **Përkthimi i teksteve të përgjithshme IV. (Nga frëngjisht në shqip; ose nga italisht në shqip; ose nga greqisht në shqip.)**

• **Përkthimi i teksteve specifike dhe dokumentacioni terminologjik II. (Nga frëngjisht në shqip; ose nga italisht në shqip; ose nga greqisht në shqip).**

• **Përkthimi i teksteve specifike dhe dokumentacioni terminologjik II. (Nga frëngjisht në shqip; ose nga italisht në shqip; ose nga greqisht në shqip).**

Gjuhët e mësipërme të konsideruara në përkthimin e teksteve si frëngjisht dhe italisht nuk paraqiten në asnjë rast në dy planet e tjera mësimore të paraqitura Aneksin 51: Kriteret Pranimit+ aktivitete, & Aneksi 6, 61.1: Plani dhe syllabuset.

Aty rezulton vetëm gjuha greke e përdorur në këto lëndë dhe e njëjta gjë verifikohet edhe në syllabuset ku këto dy gjuhë nuk përmenden në asnjë rast. Kjo nuk verifikohet në asnjë rast as në kriteret e pranimit.

E gjejmë një përmendje të paqartë tek Aneksi 4 të Dhënat e Programit ku përmendet një gjuhë e dytë e përzgjedhur nga studenti gjë që nuk rezulton më pas e pasqyruar në dy nga 3 planet mësimore të përcjella, por duke mos qenë kriteret gjuhe për pranimin e studentëve këto dy gjuhë: frëngjisht dhe italisht apo gjuhë të dyta me zgjedhje që nuk figurojnë sërish as në plan dhe as në syllabuse, janë të pakonsiderueshme si të tilla.

Sugjerohet:


- **Rishikimi dhe qartësimi i gjuhëve dhe lëndëve specifike si më lart.**

Orët jashtë auditorit përfshijnë orët e studimit në auditor dhe ato individuale si dhe ato në funksion të praktikës profesionale të cilat së bashku me orët në auditor përbëjnë sasinë mesatare të punës së kryer nga një student gjatë një viti studime në këtë program **të cilat paraqiten të qarta e të plota vetëm në një plan mësimor të paraqitur tek Tab. 1-24, Tab. 10**

Për vlerësimin e dijeve të përvetësuara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë përfundimtar. Rregullat për frekuentimin /ndjekjen dhe aktivizimin në programin në fjalë, si dhe për vlerësimin e njohurive përcaktohen në rregulloren e programit, si dhe në syllabuset e lëndëve.

	Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit, Neni 18, Kontrolli i dijës dhe sistemi i vlerësimit; Neni 19, Provimi dhe riprovimi]. [Aneksi 6 & 6.1. Programi lëndor + syllabuset] [Tabela 1- 24, Tabela 10. Pani mësimor] [Aneksi 25. Kriteret dhe Plani]; [Aneksin 51. Kriteria Pranimit+ aktivitetet].
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional saktëson kriteret dhe procedurat e pranimit të studenteve në programin e studimit. Gjithashtu lidhur me kuotat e pranimit ato përcaktohen para fillimit të vitit akademik me vendim SA të KU "LOGOS". Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i periudhave të studimit në Kolegjin Universitar "LOGOS" ofron mundësi për njohjen e krediteve sipas kërkesave për vazhdimin e studimeve si dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda këtij kolegji apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Kriteret e pranimit në "Master i Shkencave në Përkthim Profesional" janë si në vijim: - Përfundimi i një programi studimi që lidhet me fushën e gjuhës shqipe, gjuhëve të huaja, ose fushave të tjera (p.sh. të Theologjisë Sociale, Shkencave Religjioze, Studimeve Juridike, Mësuesisë, Shkencave Natyrore, etj.) me interes për specializim në përkthim. Përfundimi dëshmohet me diplomën e ciklit të parë të studimeve "Bachelor", ose me lart, në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në vend ose jashtë vendit (për diplomat e përfituara nga jashtë vendit ndiqet kuadri ligjor dhe nënligjor për njohjen e tyre); - Njëkohësisht zotërimi i gjuhës angleze (të paktën Niveli B2) me dëshmi të një certifikate prej një nga testuesit të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, ose dëshmi përfundimi të një cikli studimi në nivel universitar në atë gjuhë; - Zotërimi edhe 1 një gjuhë tjetër të huaj (greqisht), të paktën në nivelin B1, me dëshmi një certifikate prej një nga testuesit të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, ose përfundimi i një cikli studimi në nivel universitar në atë gjuhë;

	d. Kandidatet duhet të kenë njohuri të mira të gjuhës shqipe, aftësi për t'u shprehur rrjedhshëm dhe saktësisht me shkrim. Për shtetasit e huaj kërkohen njohuri të shkëlqyera dhe të certifikuara të gjuhës shqipe Nivel C2. Kriteret e niveleve gjuhësore për pranim në ciklin e dytë të studimeve janë të përcaktuar në Udhëzimin e MASH, Nr. 52, datë 03.12.2015, <i>ndaj përcaktimi C2 i gjuhës shqipes për të huaj del jashtë këtij udhëzimi, pavarësisht që IAL mund të vendosin lirisht kriteret e tyre, por kjo penalizon programin .</i> Evidentohet: - <i>Në lidhje me kriterin 3 të Standardit II.3 - mbi kriteret e pranimit pika D, Gjuha shqipe kërkohet në nivel C2, kjo për të huaj, gjë që do të thotë që del jashtë kuadrit të nivelit gjuhësor të përcaktuar në Udhëzimin e MAS, Nr. 52, datë 3.12.2015, ku për ciklin e dytë të studimeve përcaktohet niveli gjuhësor nga B1- C1. Pavarësisht faktit që çdo IAL mund të përcaktojë në mënyrë të pavarur kriteret e saj të pranimit, përcaktimi si kriter në nivel C2, penalizon prurjet në këtë program studimi i kandidatëve të huaj apo diasporës.</i> Sugjerohet: - <i>Rishikimi i nivelit të gjuhës shqipe në kriteret e pranimit në të mirë të këtij programi studimesh nëse e konsiderojnë të arsyeshme, me qëllim përthithjen e studentëve të huaj dhe diasporës.</i> Lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve ato janë të saktësuara qartë në dokumentacionet përkatëse. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit, Kreu II, Neni 7 & 8]; [Aneksi 1. Statuti, Neni 34]; [Aneksi 26, Rregullore e Programit Master Kreu II, Neni 7, Kriteret dhe Procedurat e Pranimit të Studenteve.] [Aneksi 1. Statuti, Kreu V, Neni 34, Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i periudhave të studimit]; [UDHËZIM Nr. 52, datë 3.12.2015 - https://www.arsimi.gov.al/wp-
--	--



	content/uploads/2019/01/Udhezimi-nr.-52-dhe-ndryshimet-e-tij.pdf]; [Aneksi 26, Rregullore e Transferimeve. Miratuar me vendim Nr. 24, datë 11.09.2019, Kreu II, Neni 4, 5. & Kreu III, Neni 6]; [Aneksi 56. Kuotat e pranimit. Miratuar me vendim Nr. 7, datë 3.05.2023]
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<i>GVJ në shqyrtim të dokumentacionit të përcjellë konstaton që syllabuset përmbajnë pjesërisht informacion për lëndën:</i> Ofrohen të sakta emërtimet/kodi i saj, titullarin, pedagogu i lëndës, ngarkesa (numrin e krediteve, numrin e orëve mësimore në auditor, leksion dhe seminar, praktika, etj.), tipologjinë e lëndës, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, llojin e lëndës (e detyrueshme ose me zgjedhje), programin e studimit ku ofrohet, adresën elektronike të titullarit/e pedagogut të lëndës, <i>pjesërisht temat që përfshihen, mënyrën e kontrollit të dijeve (frekuentimin dhe format e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve), literaturën bazë të detyrueshme dhe të rekomanduar. (për më tepër shih II.4)</i> <i>Sugjerohet:</i> - <i>Saktësimin e syllabuseve sipas formatit të VKM nr 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 185, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018;</i> Lëndët e kurrikulës së programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional janë organizuar në mënyrë që studenti të ketë një ngarkesë pothuajse të përafërt gjatë dy semestrave. Kjo mund të verifikohet si në aspektin e ngarkesës mësimore ashtu edhe në lidhje me kreditet për çdo semestër, <i>por duhet parë ngarkesa e praktikës e ngjeshur 300 orë në 2 muaj.</i> <i>Sugjerohet:</i> - <i>Shpërndarje me ekuilibruar e orëve të praktikës pasi ka ngjeshje të tyre. (për më tepër shih II. 4)</i> Raporti i orëve në auditor është për të gjitha lëndët në masën 20 orë leksione, 20 orë seminare dhe 20 orë pune në laborator dhe <i>lëndët kanë sasi kreditesh pothuajse të barabarta prej 6 kreditesh ECTS, përveçse një lëndë me 1 kredit: Teori të aplikuara të përkthimit .</i> <i>Evidentohet:</i> - <i>Shpërndarje e mirë e krediteve, por ka vend për përmirësim lidhur me lëndën me 1 kredit: Teori të aplikuara të përkthimit që të jetë në harmoni formimi me lëndët e tjera</i>

	<i>që ofrohen në këtë program studimi, qoftë edhe ndarja e orës të kësaj lënde në 25 min. lex dhe 25 min. sem nuk është aspak efektive dhe në aspektin metodologjik dhe atë menaxhues të orës mësimore.</i> <i>Vërtet që lënda është më bazë teorike por përmban termin aplikim gjë që ndërthur praktikën ndaj mund të rishihet si rikonceptim lëndor me dy module për t'u zbatuar në praktikë dhe për t'u shtuar në kredite dhe orë mësimore.</i> - <i>Gjithashtu lëndë si: Nëntitullimi që nuk mund të ketë 6 kredite, pasi duke qenë një lëndë më shumë praktike: a) nuk ka nevojë për orë të tepërta në teori dhe b) kërkon ridimensionim të numrit të krediteve, veç nëse siç duhej të ishte realisht përkthimi audiovizual dhe dublimi por që kushtëzohen nga mungesa e softwarit apo laboratorët KU "LOGOS" kaq të nevojshëm për këtë proces shumë interesant dhe formues mjaft i kërkuar në treg. Deklarohet që ka një software për përkthimin: TRADOS, por nuk ka asnjë dokumentacion shoqërues për të vërtetuar praninë dhe përdorimin e tij në këtë program studimi dhe mënyrën e përdorimit të tij.</i> - <i>Në Dokumentacionin e përcjellë Objeksione në vijim lidhur me përdorimin e TRADOS referohet që nuk përdoret më pasi është vënë në përdorim një tjetër Program për të cilin sërish nuk kemi informacion. Kjo gjithsesi çon në mungesë qartësie dhe koherence dokumentacioni mbi atë çka referohet fillimisht dhe çfarë deklarohet në vijim.</i> Shpërndarja e ekuilibruar e ngarkesës mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Bazuar në syllabuset studenti për çdo lëndë merr informacion mbi 15 tema mësimore. Në çdo lëndë studenti i nënshtrohet provimeve të ndërmjetme që kryhen në javën VII ose VIII dhe provimit përfundimtar. Vlerësimi lidhet gjithashtu edhe me detyrimin për të realizuar një detyrë kursi / projekt në grup apo në mënyrë individuale. Detyrimet e studentit lidhur me frekuentimin janë të përcaktuar në masën 75% për leksionet dhe për seminarët. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Kreu II, Neni 16, Rregullore e Programit të Studimit];
--	--

	[Aneksi 6.1. Syllabus të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional]; [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit. Kreu II, Neni 16,]. [Aneksi 35. Relacion detyrë kursi] [Aneksi 34. Klasa të digjitalizuara. Relacion mbi Procesin e Provimit në KU "LOGOS"]
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Sipas RVB programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional përditësohet e rifreskohet çdo vit megjithëse është një program i ri studimi. DGJCG bën përshtatjen e syllabuseve duke përfshirë në to informacion të ri, duke i bërë sa me bashkëkohore si dhe duke iu referuar zhvillimeve më të fundit të shkencës. Po sipas RVB ndryshimet në syllabuse miratohen nga seksionet e ndarjeve sipas grup - lëndëve në departament ose bazuar në ligjin e ri të arsimit të lartë, miratohen nga Grupet Mësimore - Kërkimore Shkencore (GMKSH) dhe të gjitha syllabuset arkivohen në departament në kopje digjitale dhe hard-copy në shqip dhe anglisht. Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional ka bërë përmirësime duke futur lëndë të reja ose duke hequr lëndë të mëparshme të cilat nuk ishin aktuale me nevojat që kanë specialistët e përkthimit në tregun e punës por gjithmonë duke mos kapërcyer kufirin për 20% që parashikon ligji Arsimit të Lartë Neni 35, Pika 1, por nuk kemi dokumentacion që të vërtetojë modifikimet e kryera në këtë program studimi, pra një plan mësimor të mëparshëm dhe atë të modifikuar. Gjithsesi duhet të kemi parasysh që bëhet fjalë për një program fare të ri studimi, ndaj mund të mos ketë pësuar ndryshime. Kjo mungesë e ndryshimit verifikohet edhe në Tab. 11 të Dok Tab. 1-24. Kjo tabelë paraqitet bosh. <i>Megjithatë sipas sqarimeve të bëra në Objeksione dhe dokumentacionit shoqërues të tyre referohet për ndryshime të cilat nuk reflektohen.</i> Dokumentacioni referues: [Dok nr. 5. RVB]; [Shtojca 6. Syllabuset e programit]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit, Neni 12.]; [Dok shtesë. Pika 2. Vendimi për ngritjen e grupeve kërkimore mësimore miratuar me shkresë Nr. 149 Prot. Datë 31/10/2023].
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioni të përcjellë vëren që ky standard përmbushet pjesërisht lidhur me të gjitha vërejtjet e përmendura si më lart përshkruar. Ka vend për përmirësim në</i>

	<i>shpërndarjen e lëndëve, mospërputhje të planeve mësimore në dokumente të ndryshme, syllabuset janë hartuar pjesërisht si dhe shume detaje të tjera që janë trajtuar më sipër.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit Master Shkencor në Përkthim Profesional mundësojnë njohuri të thelluara gjuhësore, kulturore, si dhe formim profesional në përkthim përmes lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese dhe plotësuese. Programi në tërësi u përgjigjet një sërë kompetencave që synojnë zhvillimin dhe aftësimin e studentëve për të thelluar njohuritë dhe përvetësuar aftësitë në mënyrë që të përgatiten për t'u punësuar në sektorin e përkthimit si përkthyes. <i>Lëndët e programit mundësojnë pjesërisht njohuri dhe aftësi në fushat specifike të Përkthim Profesional të detajuara në syllabuset e lëndëve, kjo sepse një pjesë e syllabuseve ofrojnë vetëm titujt e temave pa qartësuar se çfarë do të trajtohen realisht në to (shih kriterin 5 të këtij standardi).</i> Komponentët mësimorë si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime në laborator, si dhe kontrolli i vazhdueshëm, detyrat e kursit/projekte) janë në funksion të ndërveprimit të studentëve me pedagogun e lëndës dhe në funksion të zhvillimit të aftësive të tyre në përkthim për t'ju përshtatur kështu me mirë tregut të punës dhe nevojave dinamike për punësim. Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. 6.1. Plani mësimor dhe syllabuset]
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në	Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet në 2 vite akademike, 4 semestra.

kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

Lëndët dhe modulet e zgjedhura mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Ngarkesat janë hartuar në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse për pedagogët dhe stafin akademik.

Raporti teori-praktikë është parë me përparësi si dhe vlerësimi me kredite dhe orë mësimore të ndryshme për disiplina të ndryshme. ***Lëndët e detyrueshme vlerësohen me 6 kredite duke ruajtur një ekuilibër të mirë mes teorisë dhe praktikës (20/20/20 orë leksion/seminare/laborator), përveç një lënde me 1 kredit e cila duhet të ridimensionohet.***

Këto lëndë janë të organizuara në module:

- Lëndët e vitit të parë janë kryesisht karakterizuese për t'i pajisur studentët me njohuri të thelluara për proceset e përfshira në fushën e përkthimit. Rëndësi në program i jepet edhe elementëve të gjuhës shqipe krahas konsolidimit të praktikës së përkthimit nga dhe drejt gjuhës së parë e të dytë të huaj.
- Lëndët e vitit të dytë kanë një karakter më tepër praktik për sa kohë që në semestrin e parë studentët merren në mënyrë më të thelluar me Përkthimin si dhe shtrojnë rrugën për zhvillimin e temës së diplomës, që i përket semestrit të dytë, duke u marrë specifikisht e paraprakisht me të përmes lëndës së Metoda Kërkimi në Studimet Përkthimore.
- Lënda e Praktikës Profesionale merr 12 javë/ 2 muaj të semestrit të dytë duke u dhënë studentëve mundësinë të shohin nga afër dhe vetë përkthimin, teknikat e rishikimit dhe kontrollit të cilësisë së teksteve të përkthyer, përditësimin e bazave të terminologjisë dhe memorieve të përkthimit, si dhe marrin udhëzime mbi etikën profesionale praktikisht tërë parimet e etikës profesionale dhe të punës së përkthyesit,

Evidentohet:

30. ***Lidhur me praktikën mësimore*** Lidhur me shpërndarjen e orëve të praktikës mësimore. Bazuar në dokumentin e përcjellë D. 6 Vendimi i Departamentit 18/11/2024, rezulton një shpërndarje e drejtë e tyre, por gjithsesi ju **sugjerohet që mos të përfshihen leksione pasi kemi të bëjmë me praktikë tashmë.**
31. ***Raportohet mungesë e një manuali apo udhëzuesi të mirëfilltë të praktikës mësimore.***

	32. <i>GVJ sugjeron që për akreditimin e radhës të përcillet saktësimi i duhur në RVB dhe shoqërimi me dokumentacioni përkatës si dhe kryesorja hartimin e një manuali, rregulloreje apo udhëzuesi të praktikës mësimore si për stafin ashtu edhe për studentët.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. Plani Mësimor dhe syllabuset]; [Aneksi 25. Krite dhe plani]; [Tab. 1-24, Tab 10, fq. 9- 10].
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit Master Shkencor në Përkthim Profesional është në përputhje me profilin e programit, formimin e specialistëve të përkthimit, në përputhje me kuadrin rregullator të nivelit 7 të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, realizohet me 120 kredite në dy vite akademike, përmban veprimtari formuese të ndara në kategori e të realizuara në komponentë mësimore, ka kontroll të vazhduar të dijeve që realizohet gjatë gjithë vitit përmes provimeve e detyrave. Në RVB deklarohet që struktura e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional është në përputhje me programe të ngjashme universitare kombëtare dhe ndërkombëtare (Universiteti "Aristoteli" i Selanikut, Fakulteti i Gjuhës dhe Filologjisë Frënge). Verifikuar kjo edhe me vizitat fizike dhe komunikimin online me profesorët e Universiteti "Aristoteli" i Selanikut. Lidhur me përafrimin e programeve është përcjellë linku i guidës studentore të programit të Universiteti të Selanikut (qe nuk hapej) por e gjejmë të përcjellë në Dok D. 4, <u>ku programi për akreditim rezulton shumë larg në përafrim me këtë program ku vihet re qartë një ofertë studimore shumë më e organizuar dhe më efikase për një student të ardhshëm të këtij programi. Aty përfshihen interpretimi, lëndët me zgjedhje etj. Penalizimet që mbart mungesa e përafrimeve të programit është qartësuar më së miri në RVJ.</u> Gjatë vizitave fizike na u referua që kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm konsultues lidhur me hartimin e këtij programi dhe kjo është mjaft pozitive për një program që është në hapat e tij të parë. Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Aneksi 6. Plani Mësimor];

	[Aneksi 27. CV PAE, PAK e profesorëve nga Universiteti "Aristoteli" i Selanikut].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese në program është në përputhje me përcaktimet në shtojcën nr. 1 të VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018 (7 kredite lëndët bazë, 65 kredite lëndët karakterizuese, 24 kredite lëndët ndërdisiplinore dhe/ose integruese, 12 kredite lënda plotësuese dhe 12 kredite detyrimi përmbyllës ku peshën më të madhe e kanë lëndët karakterizuese pasi ato i përgjigjen pjesës më të madhe të kompetencave që synon programi, në formimin e specialistëve në përkthim. Në programin e studimit Master i Shkencave në përkthim Profesional, të gjitha lëndët kanë raportin 1/2 : 1/2 që do të thotë 1/2 e orëve në auditor janë leksione dhe 1/2 e orëve janë seminare. Nëse shikojmë ndarjen e lëndëve (A, B, C, D, E) në kurrikul, identifikohen lëndët teorike dhe praktike, të cilat u referohen shkencave të përkthimit të tilla si: Parimet e Studimeve të Përkthimit, Teori të Aplikuara të Përkthimit, Nëntitullimi, Metoda Kërkimi në Studime Përkthimore dhe Teknologji Përkthimi. Kjo lloj ndarjeje mundëson edhe zhvillimin e kompetencave profesionale në metodologji, kërkim, të nevojshme në treg pune me kërkesa gjithnjë e më dinamike ndaj kompetencave për punësim. Praktika mësimore e studentëve të Programit të Studimit, realizohet mbi bazën e marrëveshjeve paraprake që KU "LOGOS" ka lidhur me institucione, organizata, kompani, etj. pritëse për zhvillimin e praktikës profesionale. Dokumentacioni i praktikës përmban: 1. Relacion i studentit për zhvillimin e praktikës profesionale; 2. Formular vlerësimi i studentit praktikant për aftësi të fituara/zhvilluara gjatë kësaj periudhe, që plotësohet pas përfundimit të praktikës nga mbikëqyrësi në institucionin ku është kryer praktika dhe i dorëzohet pedagogut mbikëqyrës; 3. Formular vlerësimi i pedagogut udhëheqës për studentin praktikant i cili vlerëson pozicionimin e studentit në vendin e praktikës në përputhje me programin e studimit "Përkthim Profesional", raportimin periodik të studentit, rolin e mbikëqyrësit gjatë kësaj periudhe, raportimin final të studentit sipas çështjeve të parashikuara mbi praktikën profesionale dhe bën vlerësimin final të tij. Evidentohet:



	<u>Mungesë e një Manuali/ Udhëzuesi apo rregullore për praktikën mësimore si për stafin ashtu edhe për studentët.</u> Sugjerohet: Hartimi i saj Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. Plani Mësimor]; [Aneksi 25. Kriteret dhe Plani]; [Dok. shtesë. Pika 1. Praktika Profesionale]; [Aneksi 64. Modeli për Praktikën e Studentëve]; [Aneksi 17. Memorandume Bashkëpunimi]; [Tabela 1 - 24. Tab 5. Fq. 5].
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<u>GVJ lidhur me këtë kriter i është bazuar referimeve në RVB, kjo pasi nuk ofrohet informacion mbështetës për ndryshimet apo përmirësimet që janë zhvilluar në këto syllabuse kur dhe si.</u> Bazuar po në RVB, programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme mbi bazë departamenti, ecurinë e programeve të studimit, duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin e lektoreve dhe studenteve lidhur e programin e çdo lënde të zhvilluar në këtë program studimi. <i>Nëse programet përditësohet sipas deklartimit në mënyrë të vazhdueshme duhet të përcillen ndryshimet e reflektuara.</i> Po në RVB thuhet që bazuar në opinionet dhe mendimet e marra, KU "LOGOS" dhe DGJCG programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit duke përfshirë këtu edhe ndryshime të mundshme të syllabusve sipas lëndëve. Këto politika përfshijnë edhe rritjen e cilësisë së këtyre programeve me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe efikas të tyre në përshtatje me tregun e punës. Kjo mundësohet në bazë të pyetësorëve që zhvillohen 2 herë në vit para sezonit të provimeve. <i>Nga pikëpamja e formës, syllabuset duhet të hartohen bazuar në shtojcën 2 të VKM-së nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe përmbajnë të gjithë elementet e parashikuar, por që kjo pjesërisht është respektuar kjo formë.</i> <i>Evidentohet:</i> <i>Një pjesë e syllabuseve, ofrojnë tek përmbajtja vetëm temat dhe literaturën, pa qartësuar se çfarë do të trajtohet në çdo temë.</i> <i>Të tilla lëndë janë sipas kodit në vijim sipas kodeve :</i> a) 401 A b) 404 C

- c) 405 B
- d) 408 C
- e) 409 B
- f) 504 B
- g) 505 B

Një pjesë e këtyre syllabuseve në përmbajtje sjellin përsëritje brendie temash të paspecifikuara, pa trajtim dhe pa literaturën përkatëse për çdo temë. Mund të përmendim këtu lëndën me kod: 409B;

- *Një pjesë e syllabuseve nuk vijnë të firmosura nga titullarë të kategorisë Profesor, pavarësisht se kush staf e zhvillon lëndën, në bazë të ligjit për Arsimin e Lartë (Ligji për Arsimin e Lartë 2015, Neni 59, Pika 3) ato duhet të firmosen nga titullarë të kategorisë Profesor dhe jo vetëm nga drejtuesi i departamentit.*
Lëndë të pafirmosura sipas kodit në vijim: 401 A; 402 B; 404C; 409 B; 410 C; 501B; 502 C; 504 B;
- *Mosrakordim i orëve të lëndës me shtrirjen e tyre në syllabus Lëndë si lënda me Kod 507A që ka vetëm 10 orë në total, 5 orë Lex, 5 orë sem, ndërsa syllabusi shtrihet me orë leksioni dhe seminari gjatë gjithë semestrit prej 15 javësh duke shkuar në total 15 lex dhe 24 sem;*
- *Lënda me Kod 508 D, Syllabusi Praktika profesionale ka gabime në përshkrimin e elementeve të lëndës. Lënda është 12 kredite dhe ka 240 orë + 60 në auditor, në total 300, aty shkruhet 120 orë.*
- *Disa Syllabuse kanë gabime të theksuara drejtshkrimore,*

Sugjerohet:

- *Saktësimi i syllabuseve sipas formatit dhe kërkesave të legjislacionit dhe akteve rregullatore në fuqi.*

Dokumentacioni referues:

[Dok nr. 5. RVB];

[Udhëzim për ngarkesën e dhe veprimtarinë mësimore të personelit akademik në IAL - <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-29-date-10-09-2018-per-veprimtarine-dhe-ngarkesen-mesimore-te-personelit-akademik-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte/>]

	[Aneksi 32. Paketa vlerësimi i cilësisë]; [Dok. Shtesë. Pika 7. Fokus grupet]; [Aneksi 13. Politikat për sigurimin e cilësisë. Kreu VII. Sigurimi i cilësisë. 2. Cilësia e programeve të studimit dhe e mësimdhënies dhe pikat vijuese]; [Aneksi 6& 6.1. Plani dhe syllabuset].
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Kurrikula e programit Master Shkencor në Përkthim Profesional është kurrikul e bazuar në kompetenca të cilave u përgjigjet përmbajtja e programit. Kurrikula synon të përgatisë formimin e një figure profesionale të aftë si përkthyes profesional, të aftë të përkthejë, tekste në shkallë të lartë. Çdo lëndë në program i përgjigjet një apo më shumë kompetencave të programit përmes dijeve, rezultateve të të nxëniet dhe aftësive që synon të garantojë përmes elementeve përbërës të vet. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e programit, Misioni, Objektivat]; [Aneksi 6. & 6.1 Programi lëndor syllabuset].
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit Master Shkencor në Përkthim Profesional mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë të studimeve pasi elementi i kërkimit shkencor dhe finalizimi me mbrojtjen e një teme diplome hedh bazat e thellimit të mëtejshëm të dijeve duke siguruar vijimin e kërkimit shkencor. Përmbajtja e programit dhe <i>KU "LOGOS" nxitin kërkimin shkencor si p.sh. me anë të organizimit të konferencës së përvitshme të studentëve, pavarësisht që nga takimet fizike rezultoi që studentët e këtij programi nuk kanë marrë pjesë në këto konferenca.</i> Për sa i përket punësimit, Ku "LOGOS" përpiqet të mundësojë ngritje e urave të bashkëpunimit me agjenci të ndryshme përkthimi dhe organizata të ndryshme që me zhvillimin e praktikës profesionale është një hap mjaft i rëndësishëm që vjen në përputhje me nevojat e tregut për përkthyes. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e Programit]; [Aneksi 6. Plani Mësimor& Syllabuset]; [Tabela 1- 24. Tab 5.]; [Aneksi 25. Kriteret dhe Plani].

Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioni të përcjellë dhe takimeve institucionale vëren që ky kriter përmbushet kryesisht për shkak të problematikave të vërejtura kryesisht lidhur me hartimin e syllabueseve, formatin brendinë dhe cilësinë e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Bazuar në RVB deklarohet që për përmirësimin e përmbajtjes së programit sugjerimet vijnë fillimisht nga lektorët e angazhuar në këtë program studimi, nga sugjerimet e studentëve dhe nga kërkesa e studentëve dhe nga burime të tjera si p.sh. biznese tek të cilat ka ndikim programi i studimit, <i>pavarësisht faktit që duhet të silleshin realisht opinionet apo sugjerimet e këtyre palëve, mbi të cilat janë bazuar për ndryshimet apo përmirësimet dhe përshtatjen me nevojat e tregut.</i> Sipas RVB Marrëdhëniet e bashkëpunimit, kontaktet periodike me ekspertë të bizneseve partnere ofrojnë mundësi reflektimi mbi përmirësimin dhe përditësimin e syllabuse. <i>Mbështetur në këtë pohim do kishte qenë me vend sjella e reflektimeve të kryera.</i> Evidentohen: - <i>Nuk janë përcjellë ndryshimet në përmirësimet lëndore e syllabuseve paraprake me ato ekzistuese, ndaj nuk mund të identifikojmë dhe sjellim opinionin tonë lidhur me këto ndryshime.</i> - <i>Në shqyrtimin e Raportit të NJSBC dhe në takimet fizike rezulton që studentët janë të kënaqur me çfarë ofron ky program lidhur me përmbajtjet lëndore dhe aspekte të tjera dhe ata janë të punësuar tashmë në sektorë të ndryshëm, pavarësisht se në këta sektorë vetëm 2 janë të lidhur drejtpërsëdrejti me programin e studimit, 3 të tjerë jo, kjo dhe për faktin që ky program studimi akoma nuk ka studentë të diplomuar në këtë program.</i>

	- <i>Mungesë gjithësesi në Raportin e KPGSC për ndonjë sugjerim të mundshëm lidhur me DGJCG në funksion të rritjes së cilësisë së këtij departamenti. Ka gjithmonë vend për përmirësime siç dhe verifikohet në planin mësimor, syllabuset, etj.</i> - <i>Aneksi 67. Raporti vjetor KPSGC, sjell informacione të pashoqëruara me dokumentacion përkatës bashkëngjitur që vërteton veprimet e ndërmarra.</i> - <i>Lidhur me Kriterin 2 të këtij Standardi, nuk kemi evidencë të këtyre përditësimeve të lidhura me tregun e punës dhe arsyetim të dokumentuar se përse e nga vijnë.</i> Sugjerime: - <i>Paraqitjen në të ardhmen e ndryshimeve të përcjella në program apo syllabuse.</i> Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Aneksi 6. Syllabuset e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim]; [Aneksi 67. Raporti vjetor i KPSGC 2023- 2024]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional]; [Aneksi 28. Raporti NJSBC].
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	KU "Logos" dhe DGJCG inkurajojnë dhe përfshijnë në diskutime studentët të cilët mund të shprehin sugjerimet e tyre në pyetësozin e vlerësimit të lëndës dhe lektorit, të shkruajnë komente dhe sugjerime shtesë. Studentët mund të depozitojnë gjithashtu kërkesën pranë departamentit ose duke iu përgjigjur pyetësorit lidhur me përmirësimet që duan të bëjnë në këtë program mësimor. Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Aneksi 28. Raporti vjetor për veprimtarinë e NJSBC se KU "LOGOS" për vitin akademik 2023-2024]; [Aneksi 67. Raporti vjetor i KPSGC 2023- 2024]; [Aneksi 32. Paketa e vlerësimit].

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Bazuar në RVB, DGJCG përditëson në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizon programe në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të përkthimit në Shqipëri, të ndërthurur me teknologjinë në veçanti. Këto rregullime kryhen në funksion dhe mbarëvajtje lidhur me nevojat e tregut të punës dhe me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit. Po në RVB thuhet që Stafi i departamentit angazhohet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare studimi apo kërkimi shkencor, të cilat sjellin risi dhe inovacion edhe në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, <i>por nuk kemi dokument referues të këtyre përditësimeve të lidhura me tregun e punës dhe arsyetimin se përse e nga vijnë.</i> Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Aneksi 7. Plani Strategjik i zhvillimit/Misioni strategjik i zhvillimit]; [Aneksi 21. Studimi i tregut].			
Konkluzione	<i>GVJ në shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë vëren që ky kriter përmbushet kryesisht për shkak të mungesës së informacioneve që dëshmojnë përmirësimet e vazhdueshme apo përshtatjen që ky program bën lidhur me sugjerimet e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional i cilin ofrohet në përputhje me kuadrin rregullator të nivelit 7 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve ka për qëllim ofrimin e studimeve të ciklit të dytë të një niveli të lartë akademik. Ky prioritet është i lidhur me objektivat e DGJCG pranë KU LOGOS. Të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në programet e studimit. Ku program vjen në përputhje me kuadrin rregullator të nivelit 7 të Kornizës



	Evropiane të Kualifikimeve. Ky program synon të formojë studentë me njohuri të thelluara në këtë fushë në mënyrë që të mbulojë nevojat ekzistuese dhe ato të parashikuara të shërbimit të përkthimit profesional në sektorin publik dhe privat. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti, Misioni dhe qëllimi. Pika 1]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit]; [Aneksi 4. Të dhënat e Programit, Pika 1.7. Misioni].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	DGJCG është njësia zhvillohet ky program studimi. Kjo njësi bashkë me Njësinë Kryesore janë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e aspekteve akademike dhe kërkimore - zhvillimore të programeve të saj të studimit. DGJCG është njësi përgjegjëse që merret me miratimin orëve mësimore, veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore. Njësia bazë është ajo që harton dhe miraton oraret mësimore, syllabuset dhe përmirësimet e tij, tezat e provimit dhe format e tjera të kontrollit të studentëve, propozimet për staf të ri dhe rekrutimin e tij. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e DGJCG]
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Sipas RVB programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional nxit studentët të marrim pjesë në konferencat studentore të organizuara nga KU “LOGOS”, në bashkëpunim me institucione të tjera, <i>por asnjë nga studentët e këtij programi nuk ka marrë pjesë në këto konferenca.</i> Evidentohet: - <i>Programi nxit studentët në pjesëmarrje studimesh, kërkime, por pjesëmarrja e tyre është e munguar në konferenca studentore, dhe projekte. <u>Ata janë përfshirë në hartimin e një fjalori të anasjelltë nga një personel Akademik i Universitetit Aristoteli dhe kjo është mjaft pozitive.</u></i> Bazuar në RVB KU “LOGOS” ka hapur edhe një qendër të rëndësishme që është ajo e Qendrës për Mësimdhënie dhe Mësimnxënie, e cila trajnon dhe asiston studentet në punën e tyre akademike dhe kërkimore, <i>por që çfarë veprimtarish ka kryer kjo</i>

	<i>qendër lidhur me këtë program studimi dhe studentët e saj nuk kemi informacion.</i> <i>Një projekt i rëndësishëm ku janë përfshirë studentët është ai i hartimit të fjalorit shqip të ndërsjellë. <u>Gjithsesi bazuar në dok. Tabela 1-24, tab.22, studentët nuk janë të përfshirë në projektet e DGJCG, por vetëm në kërkimet individuale të personelit të DGCG.</u></i> <i>Lidhur me mobilitetet studentore mbetet akoma sfidë siç theksohet dhe Raportin Vjetor të KU "LOGOS". Ata nuk kanë kryer mobilitete. Në takimet fizike u konstatua që janë ftuar për t'i kryer ato, por për arsye personale të tyre nuk kanë marrë pjesë. <u>Gjithsesi duhet të marrim në konsideratë faktin që ky është një program mjaft i ri dhe me një numër të kufizuar studentësh, ndaj deri diku janë të justifikuar në këtë aspekt.</u> Lidhur me aktivitetet e DGCG ato janë të pakta dhe pak me fokus me programet e studimit që ofron DGJCG dhe apo aspak me programit të studimit në fjalë. <u>Grupet kërkimore janë krejtësisht joaktive</u> (pasi nuk kemi informacion mbi veprimtarinë e tyre), duhet të zhvillojnë aktivitete kërkimore mësimore në funksion të programeve të DGJCG dhe të programit Master duke përfshirë studentët. Këto grupe duhet të jenë aktive dhe të parashikojnë veprimtari për çdo vit akademik, duke kërkuar në rast nevojë mbështetjen financiare të IAL.</i> Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Aneksi 19. Raporti vjetor i KU "LOGOS". Pika 5, 1. 2; Pika 2 informacion mbi bashkëpunime ndër-institucionale dhe projekte] [Fjalori i anasjelltë i gjuhës shqipe- http://www.kulogos.edu.al/al/reverse-dictionary.html]
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Kolegji Universitar LOGOS, në cilësinë e institucionit ku zhvillohet ky program studimi, ka në politikat e tij dhe financimin e departamenteve për arsye kërkimore, <i>pavarësisht faktit që kjo nuk verifikohet për sa i përket kërkimit shkencor. Gjatë takimeve fizike me stafin rezultoi që asnjë nga stafi të ketë kërkuar fonde për kërkimin shkencor, por në takimet fizike ata deklarojnë që ata janë të sigurtë që po ta kërkojnë do ju jepet.</i>

	Lidhur me aktivitetet e kryera nga DGJC që realisht janë 4 – 5 gjithsej për gjithë vitin akademik dhe <i>nuk kemi të dhëna lidhur me financimin e tyre.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 30.1. Aktivitetet e Departamentit] [Aneksi 30. Aktivitetet MSH]			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve institucionale vëren që ky kriter përmbushet kryesisht pasi për arsyet e përshkruar më lart lidhur me përfshirjen e studentëve në mobilitete, projekte, aktivitete kërkimore, mungesë të veprimtarive kërkimore të grupeve të punës që duhet të përfshijnë studentët e DGJCG dhe të këtij programi në veçanti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Statuti i KU “LOGOS”, Neni 17, pika 1 lidhur me detyrat e drejtuesit të njësive bazë saktëson që drejtuesi i departamentit është dhe drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore. Tek Pika 6 D, saktëson që është drejtuesi i njësive bazë ai që nxit dhe ndihmon punonjësit jo vetëm në realizimin e procesin mësimor ashtu edhe në atë kërkimor - shkencor. Për këtë DGJCG me vendim Nr. 149 Prot. Datë 31/10/2023 ka ngritur dy grupe kërkimore: 1. Grupi Mësimor-kërkimor në fushën e Gjuhësisë-Didaktikës; 2. Grupi Mësimor-kërkimor në fushën e Gjuhësisë-Përkthimit/Letërsisë. Kështu DGJCG ka mbështetur grupet në përgatitjen e fjalorit të anasjelltë, <i>por nuk na është përcjellë asnjë kalendar pune apo raport vjetor i këtyre grupeve lidhur me aktivitetet mësimore-kërkimore që ato kryejnë dhe se çfarë ato kanë kryer konkretisht.</i> Evidentohet: - <i>Krijimi i dy grupeve kërkimore – mësimore, por nuk përcillet asnjë kalendar pune apo raport vjetor i këtyre grupeve lidhur me aktivitetet mësimore- kërkimore që ata</i>

	<u>kryejnë. I vetmi aktivitet domethënës ku përfshihen edhe studentët është ai i hartimit të një fjalori shqip të ndërsjellë dhe që në takimet fizike e të kombinuara online me profesorët e huaj verifikojmë që është kryer nga një nga profesoret e Universitetit Aristoteli që bashkë me studentët e ka kryer me sukses këtë aktivitet.</u> Sipas RVB në kuadrin e përkthimit të teksteve specifike, departamenti ka mbështetur projektin e përkthimit të një kodiku nga famullia e Katedrales së Fjetjes së Shën Marisë në Kalanë e Beratit (sot Muzeu Onufri) dhe në bashkëpunim me këtë Muze ka marrë përsipër të identifikojë sendet e inventarit të paraqitur në Kodik që korrespondojnë me objektet aktuale të ekspozuara të Muzeut ku fakt pozitiv është përfshirja e studentëve të këtij programi. Po në bazë të RVB në bashkëpunim me Njësinë Mbështetëse për Kërkim, Inovacion dhe Zhvillim departamenti ka marrë pjesë në aplikimin e projektit ERASMUS+ CBHE DiLanEdu-WB (Digital Language Education in the West Balkans), projekt fitues. Anëtarët e departamentit kanë marrë pjesë edhe në punimet e projektit ERASMUS+ CBHE të titulluar Homo Digitalis. <u>Në informacionin e përcjellë lidhur me rolin që kanë apo kanë patur stafi i DGJCG në projektet e lartpërmendura, verifikojmë si dhe tek mobilitetet përsëritje personeli dhe një numër mjaft të kufizuar të personelit në to dhe sidomos të këtij programi studimi. Sugjerohet përfshirje me frymëmarrje më të gjerë e stafit DGJCG dhe sidomos i këtij programi në veçanti dhe e studentëve që nuk rezultojnë të përfshirë gjëkund, për të cilin po kryhet ky akreditim.</u> Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Aneksi 19. Raporti Vjetor. 1.3. Veprimtari Krijuese & Inovacion]; [Aneksi 31- 35. Detyra e Uranisë Evidenca Muzeale nga Muzeu Onufri].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'ju përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor	DGJCG angazhohet për t'ju përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.

shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar në RVB, stafi i saj akademik ka marrë pjesë në ka marre pjesë në aplikimin e projektit ERASMUS + CBHE DiLanEdu-WB (Digital Language Education in the West Balkans) si dhe në hartimin e një projekt-propozimi kërkimor me karakter aplikativ në kuadrin e projekteve ndërkufitare Shqipëri-Greqi të titulluar DIDYMUS, për të cilin pritet miratimi. <i>Në informacionin e përcjellë lidhur me rolin që kanë apo kanë pasur stafi i DGJCG në projektet e lartpërmendura, verifikojmë si dhe tek mobilitetet përsëritje personeli dhe një numër mjaft të kufizuar të personelit në to dhe sidomos të këtij programi studimi. Sugjerohet përfshirje me frymëmarrje më të gjerë e stafit DGJCG dhe sidomos i këtij programit në veçanti dhe e studentëve që nuk rezultojnë të përfshirë gjëkundi, për të cilin po kryhet ky akreditim</i> Nga dokumentacioni, Dok. Tab. 1- 14, tab. 22 vërtetohet që nuk ka asnjë student të përfshirë në projekte. Ata rezultojnë të përfshirë vetëm në punime shkencore individuale të pedagogëve. Në RVB thuhet që stafi akademik merr pjesë në ekspertime institucionale përkthimi dhe ikonografie dhe paleografie. DGJCG mbështet gjithashtu botimin e serisë kishtarë të KOASH në kuadrin e së cilës është Kodiku i Adrianopojës dhe Gjyrokastres, <i>por nuk kemi dokumentacion evidentues - identifikues lidhur me këto ekspertime të stafit e këtij programi.</i> - Gjithashtu lidhur me veprimtarinë kërkimore stafi akademik i këtij programi kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime, uebinare e kanë botuar artikuj shkencorë, kanë marrë pjesë në summer schools dhe workshops, <i>por kemi informacion individual dhe vetëm për 2 anëtarë stafi që kanë përcjellë aktivitetin e punës kërkimore shkencore individuale.</i> - <i>Në listën e përcjellë me shkresën “Objeksione”, Lista e aktivitetit kërkimor ka mangësi pasi paraqet mungesa: emrat e stafit që kanë përcjellë aktivitetin, departamenti ku i përkasin, referimi i plotë i botimit: titulli, viti, tipologjia e botimit, linqet apo nr, e volumeve, kodi ISBN, Kodi ISSN, DOI, fq etj.</i> - <i>DGJSG kryen veprimtari të natyrave të ndryshme, por që për një vit akademik janë të pakta dhe të kufizuara në tematika lidhura me këtë program studimi.</i> <u>Evidentohet:</u> - <i>Pavarësisht që janë zhvilluar 5 aktivitete, ato duhet të jenë më të shpeshta dhe ky në fakt duhet të jetë qëllimi i punës</i>
---	---

	së grupeve kërkimore- mësimore të cilat duhet të impenjohen në realizmin e tyre të cilat rezultojnë joaktive - <u>DGJCG nuk ka asnjë konferencë të organizuar.</u> <i>Në listën e përcjellë me shkresën "Objeksione", Lista e sjellë me aktivitetet e realizuara i referohet gjithë FSHHKGJ, kur GVJ shprehet vetëm për DGJCG dhe grupeve kërkimore mësimore të këtij departamenti ku dhe ofrohet ky program studimi për të cilin kërkohet akreditimi.</i> Sugjerohet: - <i>Stafi DGJCG çdo vit duhet të paraqesë punën kërkimore - shkencore dhe të jetë më aktiv në këtë aspekt.</i> - <i>Grupet kërkimore- mësimore DGJCG duhet të organizojnë çdo vit akademik një kalendar aktivitetesh dhe në fund të tij raportin e grupit përkatës mbi të gjitha aktivitetet e kryera me natyrë kërkimore shkencore dhe mësimore.</i> - <i>DGJCG të mundësojë organizimin e konferencave në rang departamenti.</i> Dokumentacioni referues: [Dok. Nr. 5. RVB]; [Dok. shtesë nr. 2. Vendimi për grupet. Kërkimi shkencor, fq. 5-8]; [Dok. Tab 1- 24, Tab 22. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit].
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	DGJCG organizon aktivitete të ndryshme, që ndikojnë në formimin e stafit apo në arritjen objektivave të studentëve të këtij programi. Aktivitetet variojnë në tipologji si: 1. Projektimi i një filmi grek me titra në gjuhën angleze, 2. Workshopit në ditën e gjuhës greke, 3. Leksionin e hapur "Imazhi i Shqiptarit Tjetër në prozën moderne greke: nga shekulli i 19-të në epokën moderne. 4. Leksioni i hapur "Aristoteli: filozofi universal i shkencave dhe vlera e tij sot". 5. Leksioni i hapur "Kafshët e Homeri: Qentë homerikë dhe Odiseu. <i>Por që këto aktivitete duhet të jenë më të shpeshta dhe ky është qëllimi i punës së grupeve kërkimore- mësimore të cilat duhet të impenjohen në realizmin e tyre. DGJCG nuk ka asnjë konferencë të organizuar.</i>



	Dokumentacioni referues: [Aneksi 30.1. Aktivitetet e Departamentit]; [Aneksi 30. Aktivitetet MSH].
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional formon përkthyes profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, sipas misioni, objektivave, <i>por që ka nevojë të saktësojë gjuhët e programit dhe jo vetëm (shih Standardi II. 1), planin mësimor, dhe mundësisht të ofrojë lëndë të interpretimit (Standardi II.1), siç është përmendet tek Aneksi 4 Të dhënat e Programit.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 9. Plani Mësimor, Tabela 9]; [Aneksi 4. Të dhëna për programin. Pika 4. Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes së programit].
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Në RVB referohet që ky program studimi merr në konsideratë zhvillimet aktuale në fushën e përkthimit dhe interpretimit. <i>Këtu kemi një kundërshti me veten sepse interpretimi në këtë program studimi nuk merret në konsideratë në asnjë lëndë.</i> Po në RVB referohet që lëndët janë të hartuara sipas kërkesave të tregut dhe konform ligjeve në fuqi. Kështu lëndë si Përkthim i Teksteve Specifike dhe Dokumentacioni Terminologjik, Teknologji Përkthimi 1 &2, <i>por nuk kemi asnjë informacion se cilat kanë qenë rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale dhe si janë zbatuar ato për të zhvillimin e kompetencave të nevojshme marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</i> Gjithsesi bazuar në analizën e tregut të punë GVJ shprehet që nevojat e tregut për profesionistë në fushën e përkthimit mund të përmbushen nga ky program studimi që përgatit dhe zhvillon kompetencat e nevojshme për përkthyes profesionistë, <i>por pjesërisht nëse do të konsiderojmë faktin që ky program nuk ofron formim në interpretim duke i hequr vetes dhe studentëve një mundësi të madhe punësimi në të ardhmen.</i> Dokumentacioni referues: [Tab. 1-24. Tab. 10 Plani Mësimor]; [Tab. 1- 24. Tab. 5]; [Aneksi . Analiza e tregut të punës]

Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë nuk e përfshin -përkthyesin- si profesion të rregulluar. Lidhur me Direktivën e BE 2005/36 për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale, kjo zbatohet vetëm për shtetasit e Vendeve Anëtare të BE-së që duan të ushtrojnë një profesion të rregulluar në një vend të BE-së. Më 15 Nëntor 2023, Komisioni i BE ka nxjerrë Rekomandimin “Për Njohjen e Kualifikimeve për Shtetasit e Vendeve të Treta”, duke ofruar kështu mundësi për njohjen e diplomave, kualifikimeve profesionale në BE. <i>Ndaj për këto arsye ky kriter mund të konsiderohet për momentin i paaplikueshëm për këtë program studimi.</i>			
	Dokumentacioni referues: [Profesionet e rregulluara - https://arsimi.gov.al/ligj-nr-10171-date-22-10-2009-per-profesionet-e-rregulluara-ne-republiken-e-shqiperise/]; [Direktiva BE 2005/36 - https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2005/36/oj]; [Rekomandimi BE - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/IT/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022H0554&from=IT].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave fizike në institucion që ky standard përmbushet pjesërisht për arsye të përshkruara më lart lidhur me kërkimin shkencor të pakët, aktivitetet të DGJCG të pakta, aktiviteti kërkimor- mësimor i munguar, përfshirje e pakët vetëm në një rast i studentëve në aktivitete kërkimore shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

65



Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë konstaton që format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë të përbëra nga leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. Bazuar në Rregulloren e FSHHKGJ, format e mësimdhënies janë: leksionet/ seminarët, praktikat/ detyra kursi/ provimet dhe mbrojtja e diplomës. Lëndët konceptohen në formë moduli dhe modulet janë semestrale. Një lëndë mund të ketë disa module. I njëjti modul mund të zhvillohet nga pedagogë të ndryshëm ashtu sikundër i njëjti pedagog mund të zhvillojë disa module. Në rregulloren e FSHHKGJ, Kreu VI, neni 19, saktësohet që lëndët karakterizohen nga kreditet: 1 kredit = 25 orë mësimore, 60 minutëshe. <i>Kjo konfirmohet edhe në rregulloren e DGJCG, Aneksi 12. 1, neni 8. Orari i mësimi që ora mësimore është 60 min.</i> <i>Gjithashtu edhe në rregulloren e Përgjithshme, Aneksi 8, Neni 93, ora mësimore deklarohet 60 minuta.</i> <i>Vetëm në Aneksin 14. Rregullore e DGJCG, ora mësimore përputhet me VKM- të si në vijim:</i> <i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 185, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, ora mësimore duhet të jetë 50 min.</i> Me dokumentacionin e përcjellë D. 8 rezultojnë të jetë kryer përditësimi lidhur me këtë çështje në rregulloren e përgjithshme ku rezultojnë që ora mësimore është 50 minuta. <i>Sugjerohet që i njëjti përditësim duhet të reflektohet edhe në rregulloret e tjera të përmendura lidhur me këtë objeksion si dhe rakordimi i ardhshëm i dokumenteve që përcillen</i> Në përlllogaritjen e orëve të kreditit përfshihet edhe koha për përgatitje dhe punë të pavarur të studentit duke konsideruar rreth 13-15 orë për studim individual. Mësimi zhvillohet në bazë kursi ose grupi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi mësimor. Programi është i organizuar në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur arritjen e rezultateve të të nxënës,

	me qëllim përgatitjen e studentëve për t'u punësuar sipas profilit të programit. Për të pasur një transmetim dhe përvetësim sa më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, ushtrime, detyrat e kursit, praktikat profesionale, esetë, punët laboratorike, provime të ndërmjetme, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës. Dokumentacioni referues: [Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ, KREU 6, Procesi mësimor]; Neni 19, Format e mësimdhënies]; [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimeve]; [Aneksi 6. Plani mësimor për programin e studimit]; [Tabelat 1-24]; [Tabela 1- 24. Tab. 10, Pasqyra analitike e kurrikulës dhe krediteve]; [Aneksi 35. Relacion detyrë kursit]; [Aneksi 69. Tezë provimi]; [Aneksi 38. Rregullat e diplomimit]; [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG, Neni 32].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Larmia konsiston në përdorimin e disa kanaleve të aksesimit për të qenë sa më afër nevojave dhe përfuturit të njohurive nga studentët. Në RVB referohet që personeli DGJCG i përgjigjet nevojave të studentëve me të gjitha format e mundshme të mësimdhënies duke përdorur edhe mundësitë alternative si platformën Microsoft Teams dhe Edupage si për komunikim, mësim, materiale e vlerësim. Dokumentacioni referues: [https://www.office.com/]; [http://kulogos.edu.al/al/student-portal.html].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe	KU "LOGOS" në strategjitë e tij të zhvillimit ka si objektiv dhe mbështetjen e vazhdueshme të personelit gjë të cilën e konsideron një nga parimet bazë të Planin Strategjik të tij ku ekzaktësisht thuhet që është vlerësimi i të gjithë personelit dhe mbështetja që ata të shkëlqejnë për zhvillimin dhe përmirësimin e kompetencave

në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	të tyre dhe këto mundësohen nëpërmjet trajnimeve, leksioneve të hapura nga lektorë të huaj, mobiliteteve, Workshopeve, summer class, pjesëmarrjeve në projekte etj, <i>por që duhet të jenë më të shpeshta dhe me natyrë më specifike lidhur me zhvillimin e kompetencave të mësimdhënies për rritjen e cilësisë dhe në përputhje me rezultatet e të nxënit të studentëve.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 30&31 Aktivitete]; [Aneksi 2 &3. Relacionet mbi projekte]; [Aneksi 7. Plani Strategjik 2018- 2024]; [Dok shtesë. Pika 2. Aktiviteti kërkimor].
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Gjatë vizitës në institucion si edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi, përmbush kriteret ligjore lidhur me kualifikimin e duhur për realizimin e orëve mësimore. Personeli akademik i angazhuar që angazhohet në këtë program studimi, përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, që janë specialistë të fushës së gjuhësisë, përkthimit, komunikimit, me tituj e grada shkencore dhe që kanë specializime të ndryshme. Për të garantuar që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Nga takimet fizike me studentët <u>GVJ konfirmon që marrëdhëniet pedagogë – studentë karakterizohen nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies,</u> gjë që padyshim ndikon në gjetjen e formave e rrugëve sa më efikase në edukimin e tyre me dije të specializuara, si dhe konsolidimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes pedagogut dhe studentit. Dokumentacioni referues:

	[Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar Logos] [Tabelat 1-24 tabela 2.1, tabela 6.2] [Dok shtesë. Pika 8&11 Personel ndihmës akademik]
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	KU "LOGOS" i kushton vëmendje te veçantë mendimit dhe kërkesave të studentëve me të cilët zhvillohen në mënyrë periodike pyetësorë lidhur me vlerësimin e lëndës dhe pedagogut si dhe NJSBC e KU "LOGOS" ka aplikuar edhe fokus grupe për të marrë informacione lidhur me aspektet e ndryshme të mësimdhënies. Bazuar në përgjigjet e marra DGJCG vlerëson dhe përmirëson format e mësimdhënies që rezultojnë që kanë nevojë. Sipas RVB në KU LOGOS, është ngritur gjithashtu Qendra për Mësimdhënie dhe Nxënie (QMN), e cila zhvillon në mënyrë periodike trajnime për të mbajtur stafin akademik të përditësuar me ndryshimet më të fundit në kurrikul dhe në metodat e mësimdhënies. Nga takimet fizike me studentët GVJ konstaton që ata rezultojnë mjaft të kënaqur nga metodat e mësimdhënies, etika e komunikimit, raportet pedagog- student dhe të gjitha elementet që përfshijn mësimdhënia dhe mësimnxënia në këtë Program Studimi. Bazuar në RVB referohet që Autoritetet drejtuese dhe përgjegjësi i departamentit, në rast problematikash, bëjnë verifikimet e nevojshme të shqetësimeve të ngritura. Pas verifikimit ata marrin masa konkrete me qëllim përmirësimin e situatës. Këto masa mund të lidhen me ndryshime si në programin e një lënde të caktuar ashtu edhe me ndryshime të personelit akademik që zhvillon një të caktuar, atëherë kur konstatohet që pedagogu nuk ka kompetencën dhe aftësitë e duhura për të vijuar angazhimin. Kjo sanksionohet edhe në Rregulloren e Programit të studimit por siç e përmendëm edhe më lart tek studentët nuk konstatuam asnjë rast të tillë. Në ndihmë këtij procesi vjen edhe Rregullorja për çështjet e studentëve ku në misionin e saj përcakton qartë që ajo synon të ofrojë shërbimet më të mira për studentët, stafin dhe grupet e tjerë të interesit me qëllim përmirësimin e cilësisë së edukimit. Po në këtë drejtim luan rol dhe Këshilli studentor i cili në një nga qëllimet e funksionit të tij është të trajtojë shqetësimet e studentëve dhe të veprojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu edhe Komisioni i përhershëm për Marrëdhëniet me studentët mbështet në misionin e tij pikërisht këtë frymë

	bashkëpunimi për të siguruar një nivel cilësor të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët. Dokumentacioni referues: [Aneksi 10. Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 7, Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi]; [Aneksi 15. Rregullore për çështjen e studentëve]; [Aneksi 32. Paketa e vlerësimit. Formular vlerësimi nga studenti për mësimdhënien e secilit pedagog]; [Aneksi 1. Statuti i KU Logos. Kreu VIII, neni 43]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit. Kreu V, neni 31. Sigurimi i Cilësisë së brendshme]; [Aneksi 59. Statuti i Këshillit Studentor. Neni 4]; [Rregullore e Komisionit të Përhershëm për Marrëdhëniet me studentët miratuar me vendim N. 20/1 datë 28.09. 2020, Neni 3].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	KU “LOGIS”, përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Një ndër këto struktura është dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ky Komision vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në kuadrin evropian të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. Kjo strukturë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe baze dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Një strukturë tjetër që përgjigjet për sigurimin e cilësisë është edhe NJSBC e KU “LOGOS” që kryen veprimtaritë e saj të bazuar në rregulloren përkatëse lidhur me funksionet e saj. Në RVB referohet që Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Dhe kjo mund të evidentohet në ngritjen e një qendre e cila në synimet e saj është edhe formimi i vazhduar i lidhur me përdorimin e këtyre metodave të reja. Dokumentacioni referues:

	[Aneksi 24. Rregullore komisionit te garantimit te standardeve te cilësisë se institucionit dhe programeve te studimit]; [Aneksi 1. Statuti i KU "LOGOS", Shtojca 3, Organigrama]; [Aneksi 10. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, neni 7, Veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi].			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe takimet fizike vëren që ky kriter përmbushet plotësisht duke pasur parasysh që personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi, përmbush plotësisht kriteret ligjore lidhur me kualifikimin e duhur për realizimin e orëve mësimore dhe që marrëdhëniet pedagogë – studentë karakterizohen nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ në shqyrtim të dokumentacionit lidhur me këtë kriter konstaton që kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, aftësive, dhe kompetencave profesionale të marra bazohen në rregullat dhe procedurat e vendosura në aktet rregullatore të KU "LOGOS" dhe në rregulloren e programit të studimit. Në këto rregullore janë parashikuar të gjitha elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, projekte, provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare, tema e diplomës. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e programit te studimit Master, Kreu II, Neni 18, 19, 20.]; [Aneksi 12.1. Rregullorja e DGJCG, nenet 11, 12. 13 14];

	[Aneksi 6. 6.1 Plano & Syllabuseve]; [Aneksi 32. Paketa e Vlerësimit te Pedagogëve].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, aftësive, dhe kompetencave profesionale të marra bazohen në rregullat dhe procedurat e vendosura në aktet rregullatore të KU “LOGOS” dhe në rregulloren e programit të studimit. Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, kontrollin e dijes dhe sistemin e vlerësimit janë të përcaktuara në kuadrin rregullator në syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të departamentit të institucionit dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të çdo lënde/moduli nga titullari lëndës /modulit. Në kuadër të çdo lënde lidhur me detyrat dhe provimet ato vendosen gjithashtu në platformën Teams dhe njoftimi realizohet nga koordinatori i departamentit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e programit te studimit Master, Kreu II, Neni 18, 19, 20.]; [Aneksi 12.1. Rregullorja e DGJCG, Nenet 11, 12. 13 14]; [Rregullore e FSHHKGJ , Kreu VI, Neni 23, Sistemi i Vlerësimit].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në këtë program kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Format e organizimit të kontrollit të vazhdueshëm përmes forma të ndryshme përcaktohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Këto forma janë nga më të ndryshmet që variojnë nga detyrat e kursit, projektet, kuizet, debatet, studimet e rastit, punës në grupet etj. Kjo i mundëson studentit të demonstrojë njohuritë e tij në mënyra të ndryshme. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i departamentit. Njësitë kryesore, në Rregulloret e tyre të brendshme, mund të parashikojnë krijimin e komisioneve për mbikëqyrjen e procesit të provimeve. Provimi i një lënde mund të bëhet nëpërmjet: A. Provimit me shkrim; B. Provimit me gojë; C. Provimit të kombinuar (me shkrim dhe me gojë).

Të gjitha këto forma testimi dhe vlerësimi janë të parashikuar në aktet rregullatore të KU "LOGOS", në të cilat specifikohet se kontrolli i dijeve realizohet në mënyrë të vazhduar.

Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin e integruar të vlerësimit:

Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin e integruar të vlerësimit:

1. Me pike nga 0 deri në 100 pike.
2. Me note: rezultati përfundimtar i pikëve sipas tabelës bashkëngjitur konvertohet në notë nga nota 4 (katër) në notën 10 (Dhjetë).

Pikët	Nota
1- 44	4
45- 54	5
55- 64	6
65- 74	7
75- 84	8
85- 94	9
95- 100	10

Kjo rregullore dhe të tjerat rregullore të DGJCG, saktësojnë qartë çdo element të testimit dhe të vlerësimit të studentit.

Dokumentacioni referues:

[Rregullore e FSHHKGJ, Kreu VI, Neni 23, Sistemi i Vlerësimit];

[Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit Master, Kreu II, Neni 18, 19, 20.];

[Aneksi 12.1. Rregullorja e DGJCG, Nenet 11, 12, 13, 14];

[Aneksi 69. Tezë Provimi];

[Aneksi 25. Krite dhe Plan].

Konkluzione

GVJ në shqyrtim të dokumentacionit vëren KU "LOGOS" përmbush plotësisht kriteret e këtij Standardi. Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, aftësive, dhe kompetencave profesionale të marra bazohen në rregullat dhe procedurat e vendosura në aktet rregullatore të KU "LOGOS" dhe në rregulloren e programit të studimit. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive dhe këto janë të përfshira në syllabuse në seksionet përkatëse.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ në shqyrtim të dokumentacionit të përcjellë konstaton që kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, aftësive, dhe kompetencave profesionale të marra bazohen në rregullat dhe procedurat e vendosura në aktet rregullatore të KU “LOGOS” dhe në rregulloren e programit të studimit. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Ato pasqyrohen në programin e çdo lënde, përkatësisht: 1. provimi i pjesshëm (20%), 2. provimi final (40%) dhe 3. pjesëmarrja aktive (aktivizim, detyra, kuize, projekte, etj. 40%) për pjesën më të madhe të syllabuseve. Çdo sullabus përfshin në formatin e tij dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Gjithashtu rregulloret parashikojnë edhe afatet e vlerësimit që duhet të bëhen me dije nga dita e kryerja e provimit, si dhe ankimin e rezultatit brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit. Dokumentacioni referues: [Tabela 1- 24, Tabela 15. Format e kontrollit të dijeve]; [Aneksi 6, 6.1. Plani dhe syllabuset]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit Master].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Bazuar në RVB, KU “LOGOS” ofron klasa të digjitalizuara që përdoren për kryerjen e procesit mësimor. Lidhur me procesin e provimit saktësohet që përdoret platforma Teams dhe Edupage për vlerësimin e detyrave të kursit dhe për të hedhur pikët e provimeve dhe njoftimin e studentëve, <i>por nuk kemi informacion lidhur me testime të realizuara në platformën TEAMS kur dihet</i>

	<i>që kjo platformë e mundëson më së miri këtë proces, apo ndonjë sistem tjetër që e mundëson një gjë të tillë.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 34 & 34.1, Relacion mbi klasat sistemi i provimeve të digjitalizuara]; [Aneksi 2. Relacion iu Homo Digitalis]; [Aneksi 3. Relacion DilanEdu].																
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Sipas rregulloreve të FSHHKGJ, DGJCG, Programit të studimi siç kemi nënvizuar edhe më lart vlerësimi përfundimtar për çdo lëndë Ato pasqyrohen në programin e çdo lënde, përkatësisht: 1. provimi i pjesshëm (20%), 2. provimi final (40%) dhe 3. pjesëmarrja aktive (aktivizim, detyra, kuize, projekte, etj. 40%) për pjesën më të madhe të syllabuseve. Çdo syllabus përfshin në formatin e tij dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Sipas rregulloreve përcaktohet që vlerësimi përfundimtar përbëhet nga disa elemente si pjesëmarrja në diskutime, detyra e kursit, provimi i ndërmjetëm, dhe provimi përfundimtar. Si pas rregullores, konvertimi i pikëve në nota bëhet sipas një skeme të përcaktuar. Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin e integruar të vlerësimit: 1. Me pike nga 0 deri ne 100 pike. 2. Me notë: rezultati përfundimtar i pikëve sipas tabelës bashkëngjitur konvertohet ne note nga nota 4 (katër) në notën 10 (Dhjetë). <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pikët</th><th>Nota</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1- 44</td><td>4</td></tr> <tr> <td>45- 54</td><td>5</td></tr> <tr> <td>55- 64</td><td>6</td></tr> <tr> <td>65- 74</td><td>7</td></tr> <tr> <td>75- 84</td><td>8</td></tr> <tr> <td>85- 94</td><td>9</td></tr> <tr> <td>95- 100</td><td>10</td></tr> </tbody> </table>	Pikët	Nota	1- 44	4	45- 54	5	55- 64	6	65- 74	7	75- 84	8	85- 94	9	95- 100	10
Pikët	Nota																
1- 44	4																
45- 54	5																
55- 64	6																
65- 74	7																
75- 84	8																
85- 94	9																
95- 100	10																



	Çdo syllabus ka të përcaktuar në seksionin përkatës, vlerësimin specifik të lëndës gjë që i komunikohet studentit në fillim të asaj lënde. Dokumentacioni referues: [Rregullore e FSHHKGJ , Kreu VI, Neni 23, Sistemi i Vlerësimit]; [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit Master, Kreu II, Neni 18, 19, 20]; [Aneksi 12.1. Rregullorja e DGJCG, Nenet 11, 12. 13 14]; [Aneksi 69. Tezë Provimi]; [Dok. 5 RVB].
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në RVB, vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohet me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen. Po në RVB referohet që në fund të pyetjeve të çdo eseje, ka një seksion të emërtuar "vlerësimi i pedagogut" ku pedagogu jep feedback mbi esenë e studentit, <i>por nuk kemi si ta vërtetojmë këtë në momentin që nuk na është sjellë asnjë ese të dokumentuar.</i> Në funksion të sqarimit të studentit janë edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje sugjerimet e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë nga ai/ajo komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre, të cilat jepen në formën e shënimeve në çdo provim të pjesshëm dhe përfundimtar. Në dokumentacionin e përcjellë kemi një portofol punimesh të një studenti, <i>por nuk shihet të ketë komente të pedagogut drejtues lidhur me të. Gjithashtu tek koka e këtij Portofoli punimesh emërtimi i departamentit ku është kryer nuk përkon me departamentin DGJCG që ofron Programin e studimit Master në Përkthim Profesional.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 35. Relacion mbi Procesin e Vlerësimit të Detyrave të Kursit në Kolegjin Universitar LOGOS]; [Dok nr. 5 RVB].
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra duke e demonstruar këtë në Rregulloren e Programit ku paraqitet qartësisht qëndrimi i KU "LOGOS" në rast shkeljesh të kësaj natyre. Në Rregullore thuhet ekzaktësisht që shkeljet e Kodit të Etikës së Kolegjit Universitar "LOGOS" që cenojnë ndershmërinë

	akademike, si: cenimi i dinjitetit të mësimdhënësit, të studentit dhe të çdo punonjësi të Kolegjit Universitar "LOGOS" duke keqpërdorur pasurinë e tij shpirtërore-intelektuale, kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve, aktet e vjedhjes të së drejtës së autorit, shkrimi i detyrave të kursit, temës së diplomës dhe çdo shkrimi tjetër gjatë studimeve, duke kryer plagjiaturë, mosrespektimi i rregullave të citimit që sanksionojnë pronësinë intelektuale, janë të dënueshme dhe në mospërputhje me kultivimin e aftësive dhe stilin e këtij programi. Nëse evidentohen shkelje të kësaj natyre rregullorja qartëson dhe llojin e masave që merren në raste të tilla. Në RVB referohet gjithashtu mbi tipologjinë e rregullave që ndiqen gjatë zhvillimit të provimeve ndër të cilat nënvizohet gjithashtu prania për çdo provim i dy anëtarëve të personelit akademik për të siguruar e shmangur kështu kopjimin gjatë provimeve. Në Aneksin 8. Rregullorja e Përgjithshme, neni 99, saktësohet gjithashtu procesi i kontrollit të dijeve, mënyra e realizimit të tyre dhe të gjitha rregullat në lidhje me to. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit Master, Kreu IV Neni 30, fq. 14.]; [Aneksi 34. Klasat e digjitalizuara. Relacion mbi Procesin e Provimit në Kolegjin Universitar "LOGOS"]; [Aneksi 36. Procesverbal Provimi]; [Aneksi 8. Rregullore e përgjithshme e KU" LOGOS", neni 99]
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të KU "LOGOS", rezultatet e provimit, për provimet me shkrim u bëhen të njohura studentëve brenda (5) pesë ditë pune nga data e provimit nëpërmjet afishimit të rezultateve të provimit në procesverbalin me kode. Në këtë rast, rezultatet e provimit afishohen për çdo grup. Në rregulloren e FSHHKGJ, Neni 99, thuhet që, Rezultatet e provimit, për provimet me shkrim u bëhen të njohura studentëve brenda (5) pesë ditë pune nga data e provimit nëpërmjet afishimit

	të rezultateve të provimit në procesverbalin me kode. Në këtë rast, rezultatet e provimit afishohen për çdo grup. E njëjta gjë konfirmohet edhe në rregulloren e DGHJCG, Neni 40, ku thuhet që rezultatet e provimit, për provimet me shkrim u bëhen të njohura studentëve brenda 5 ditëve nga data e provimit nëpërmjet afishimit të rezultateve të provimit në procesverbalin me kode. Në këtë rast, rezultatet e provimit afishohen për çdo grup. Po në këtë rregullore Neni 43, thuhet që me përfundimin e provimit, brenda 5 ditë pune, kryetari i komisionit ose pedagogu i lëndës e dorëzon procesverbalin e provimit të plotësuar në sekretari. Procesverbali i provimit duhet nënshkruar nga pedagogu i lëndës dhe pedagogu mbikëqyrës. Lidhur me afatet e vlerësimeve dhe hedhjes në notave në procesverbal, rregullorja është e qartë, por RVB është e pasaktë në deklarinë që bën kur thotë që: “Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, kur rregullorja saktëson që për hedhjen e notave në procesverbal afati është brenda 5 ditëve. <i>Ajo çfarë nuk përkon janë afatet që paraqet RVB me ato që janë në rregulloret përkatëse si dhe me çfarë vetë RVB deklaron.</i> <i>Ka paqartësi në afatet e hedhjes së notës në procesverbal dhe në afatet e ankimimit. Duhet qartësuar në rregulloret përkatëse që duhet të ketë diferencë afati kohor ndërmjet tyre.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU “LOGOS”, neni 99, Kontrolli i dijeve, fq. 50]; [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG, neni 43]; [Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ, Neni 23]; [Dok. 5. RVB].
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	KU “LOGOS” me aktet e saj rregullatore, garanton qartësisht të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit. Në këto akte paraqiten nene specifike që garantojnë më së miri këto të drejta dhe i konsiderojnë ato të domosdoshme për një arsim cilësor dhe efikas që ruan ekuilibrat dhe respekton të drejtat palëve duke i sanksionuar ato në aktet e saj rregullatore. Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU “LOGOS”]; [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG];

	[Aneksi 33. Rregullore e FSHHKGJ]; [Dok. 5. RVB].			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në aktet rregullatore të KU "LOGOS", çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur është transparente për palët e përfshira dhe pasi dokumentohet, arkivohet. Në këto akte rregullatore saktësohen qartësisht të drejtat e studentit për ankimim, procedurat, afatet, tipologjia e komisionit, vlerësimi i shqyrtimit, vendimi dhe komunikimi. Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU "LOGOS", Neni 101, Ankimi për rezultatin e provimit]; [Aneksi 14. Rregullore e DGJCG, Neni 42, Ankimi për rezultatin e provimit].			
Konkluzione	GVJ në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit vëren KU "LOGOS" përmbush plotësisht kriteret e këtij Standardi. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar të çdo syllabusi. IAL garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin e kërkesën për rishikim të vlerësimit. Procedura për çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm është transparente.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që programi ka si objektiv zhvillimin e njohurive dhe kërkimit shkencor në fushën e përkthimit profesional të gjuhëve bashkëkohore, përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si edhe të dijeve të avancuara mbi shkencën dhe praktikën e përkthimit, duke përgatitur ekspertë përkthyes, të cilët do të jenë të pajisur në teori dhe praktikë profesionale me njohuri, aftësi,

	kompetenca dhe shkathtësi për t'ju përgjigjur kërkesave për cilësi të lartë në shërbimet e përkthimit në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë, dhe këtë përpiket ta realizojë nëpërmjet thellimit të njohurive për të zhvilluar aftësitë e duhura për një formim efikas, <i>por kjo realizohet sipas GVJ deri diku. (shih Standardin II. 1).</i> Gjithsesi duke theksuar që bëhet fjalë për një program shumë të ri, <i>GVJ beson që në të ardhmen DGJCG do të mundësojë një organizim më të mirë dhe futjen e lëndëve të nevojshme për një formim të plotë si dhe mundësimin e laboratorëve specifike për të përmbushur këtë qëllim.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 5, Rregullore e Programit, Misioni dhe Objektivat, Kreu I, Neni 4]; [Aneksi 6, 6.1, Plani mësimor dhe syllabuset].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit pasi ai ofron lëndë që e mbështesin dhe e mundësojnë atë si: 1. Teknologji e Përkthimit I (Mjetet e përkthimit Elektronik); 2. Teknologji Përkthimi II (Fjalorët digjitalë dhe redaktimi i përkthimit me makinë) që përmbushin më së miri këtë nevojë. Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, garanton plotësisht pajisjen e studentëve me kompetencë të lartë përdorimi të dy gjuhëve të huaja anglisht dhe greqisht e të përkthimit në gjuhën shqipe, <i>por jo ndërmjet këtyre dy gjuhëve të huaja por dhe vetëm në një lëndë nga gjuha mëmë në gjuhën e huaj angleze.</i> Në sullabuse kemi përkatësisht lëndë: 1. Përkthimi i Teksteve të përgjithshme I (nga anglisht në shqip); 2. Përkthimi i Teksteve të përgjithshme II (nga greqisht në shqip); 3. Përkthimi i Teksteve të përgjithshme III (nga anglisht në shqip); 4. Përkthimi i Teksteve të përgjithshme IV (nga greqisht në shqip); 5. Përkthimi i teksteve specifike dhe dokumentacioni terminologjik I (nga anglisht në shqip);

	6. Përkthimi i teksteve specifike dhe dokumentacioni terminologjik II (nga greqisht në shqip); 7. Përkthimi i teksteve specifike dhe dokumentacioni terminologjik III. (Nga anglisht në shqip); 8. Përkthimi i teksteve specifike dhe dokumentacioni terminologjik IV (nga greqisht në shqip); 9. Përkthimi anasjelltas i teksteve të përgjithshme (nga shqip në anglisht). Këto lëndë garantojnë formimin e studentin me përkthimin nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe, <i>por pjesërisht në përkthimin anasjelltas pasi ofrohet vetëm nga një lëndë e vetme në gjithë programin dhe vetëm nga gjuha angleze jo në atë greke, si dhe jo ndërmjet dy gjuhëve të juaja anglisht - greqisht. (shih konkluzionet).</i> Programi garanton përgatitjen e specialistëve me njohuri të thelluara të parimeve dhe të teknikave të përkthimit në tekstet e shkruar, <i>por aspak në pajisjen me aftësi interpretuese lidhur me gjuhët e këtij programi.</i> Lidhur me formimin dhe zhvillimin e aftësive formuese komunikuese dhe ndërvepruese dhe kulturore <u>kjo realizohet pjesërisht</u> në tekstet e shkruara, pasi është e lidhur ngushtë me formimin specifik që ka të bëjë me interpretimin shumë më tepër se sa më tekstin e shkruar. Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. 61. Plani dhe syllabuset].,
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Çdo lëndë parashikon kontrollin e kompetencave dhe njohurive që fiton studenti si gjatë zhvillimit ashtu edhe në fund të tij. Performanca e studentit vlerësohet nëpërmjet provimeve përfundimtare ose paraqitjes së një portofoli tekstesh të përkthyer, të cilat ofrojnë një reflektim gjithëpërfshirës mbi përparimin e studentit. Këto vlerësime ndihmojnë në matjen e aftësisë së tyre për të aplikuar njohuritë teorike në praktikë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. 61. Plani dhe syllabuset]; [Aneksi 35. Relacion Detyre Kursi. Portofol Punimesh]; [dok. 5 RVB].
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë	GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe vizitat institucionale konstaton që mësimdhënia realizohet mbi bazë

kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	kompetencash që ju ofrojnë studentëve mundësi të zhvillojnë në praktikë njohuritë e marra. Mësimdhënia në Programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profresional kombinon formimin teorik me përvojën praktike, duke qenë se një pjesë e mirë e lëndëve kanë karakter praktik, të cilat synojnë përkthimin e vazhduar të teksteve si nga gjuha angleze ashtu edhe ajo greke Studentët inkurajohen për të punuar në grup për zgjidhjen e detyrave ose studimeve të rastit që ju propozohen nga pedagogje orë pas ore në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të dijeve si dhe në funksion të vlerësimit të studentëve. Një nga format më të përdorura nga pedagogët janë detyrat e kursit apo Portofolat e punimeve. Gjithashtu zhvillimi i praktikës mësimore i mundëson atyre më tej të zbatojnë formimin e përfutur në këtë Program studimi direkt në terren, gjë që i ofron atyre përgatitjen e duhur për të ardhmen si përkthyes profesionalë. Marrëveshjet e hartuara me Institucionet e ndryshme vendase dhe të huaja i mundësojnë këtij programi zgjerimin e rrjeteve profesionale të studentëve dhe i përgatit ata për mundësitë që ofrojnë për një karrierë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e përkthimit. Gjithashtu Kulogos vë në funksion të kërkimit dhe botime shkencore si për stafin ashtu edhe për studentët Revistën Shkencore, LOGOS, ku në uebsite zyrtar rezultojnë 5 numra të saj. <i>Por ajo që GVJ konstaton është mungesa e një Qendre Kërkimore shkencore apo Zyre Kërkimore Shkencore. Gjithashtu në takimet fizike kishim të programuar takimin me zyrën e kërkimit shkencor, por në terren konstatuam që kjo zyrë nuk ekziston dhe takimi me të nuk u mundësua.</i> <i>Evidentohet:</i> - <i>Në Aneksin 7. Plani Strategjik, flitet për një Qendër Kërkimore për të cilën nuk kemi informacion të mëtijshëm.</i> - <i>Po në Aneksin 7. fq. 12, flitet gjithashtu për krijimin e 11 qendrave kërkimore pranë kësaj IAL. Nuk ka informacion nëse janë ngritur, cilat janë, çfarë funksioni kanë dhe sa e si vihen në shërbim të këtij programi studimi.</i>
---	---

	- <i>Duke vijuar në po këtë Aneks fq. 21 Flitet për prioritetet ndër të cilat kërkimi është Prioriteti nr. 3, në të cilin përshkruhen të gjitha veprimet që do të kryheshin në afatin kohor 2018- 2024 duke supozuar që janë realizuar tashmë. Ndër to përmendet: krijimi i zyrës së projekteve, krijimi i një bazë të dhënash për hulumtimin, përgatitja e portofolit të kërkimit. Nuk kemi informacion lidhur me realizimin e këtyre objektivave të këtij Plani Strategjik.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 6. 61. Plani dhe syllabuset]; [Aneksi 35. Relacion Detyre Kursi. Portofol Punimesh]; [dok. 5 RVB]; [Revista LOGOS: http://kulogos.edu.al/al/logos-journals.html] [Aneksi 17. Memorandume bashkëpunimi]; [Tabela. 1- 24, Tab 5.].			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon <i>deri diku</i> orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit. Gjithashtu DGJCG organizon dhe merr pjesë në leksione të hapura me lektorë të huaj. Gjithashtu personeli akademik merr pjesë në trajnime të ndryshme dhe summer school, <i>por nuk kemi raportime apo aktivitete të zhvilluara në rang grupi kërkimor – mësimor, ato janë vetëm në rang individual.</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në statutin e KU “LOGOS”, në një nga qëllimet kryesore të këtij institucioni është dhe nxitja e inovacioni dhe mbështetja ndaj tij. <i>Por nxitja dhe zhvillimi i ideve inovative dhe studimeve të përparuara kërkimore nga studentët si dhe mbështetja ndaj tyre kërkon hapa konkretë.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në vizitat në Institucion vëren,që ky standard përmbushet pjesërisht kjo për arsyet e përshkruara më sipër si: mungesa e Zyrës Kërkimore në funksion të zhvillimi dhe monitorimit të kërkimit shkencor në nivel IAL. Mungesë informacioni në realizimin apo jo të objektivave të deklaruara të planit strategjik; Aktivizimin e Grupeve kërkimore – mësimore ekzistuese si dhe zhvillimin e aktiviteteve të këtyre grupeve në rang DGJCG.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

		X		
--	--	---	--	--

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	KU "LOGOS" ka hartuar procedurë të posaçme për zhvillimin e detyrimeve përmbyllëse nga studentët. Kështu në Rregulloren e Programit të Studimit Master, parashikohet që për të kryer Detyrimet Përmbyllëse në programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Përkthim Profesional", studenti duhet të ketë fituar kreditet e nevojshme (120 kredite ECTS) pra të ketë përmbyllur të gjitha provimet. Vetëm kështu ai fiton të drejtën për provimin e diplomës. Detyrimet përmbyllëse organizohet në dy forma: - Provim Diplome apo - Temë Diplome Studenti që kalojnë prapë e mesatares të vendosur nga Departamenti kryejnë temë Diplome. Në rastin e Provimit Përfundimtar hartohet një fond pyetjesh. Mbrojtja e punimit të diplomës bëhet në dy sezone: në verë dhe në vjeshtë. Në rast se studenti nuk kalon në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. DGJCG bën shpalljen e studentëve të diplomuar me vendim të brendshëm. Dokumenti për punimin e diplomës ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për studentin lidhur me procedurën që ndiqet. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional", Kreu III Diplomimi, Neni 24, Procedura e diplomimit]; [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU "LOGOS". Kreu XIV - Diplomimi Nenet 107, 109, 110, 111, 112]; [Aneksi 38. Rregulla për Diplomimin].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	DGJCG vë në dispozicion të gjithë personelin e duhur, informacionet, rregulloret, udhëzuesit e nevojshëm dhe çdo

duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	material në funksion të përmbushjes së detyrimeve përmbyllëse nga ana e studentit. DGJCG në rast provimi përfundimtar harton fondin e pyetjeve që përmban pyetje nga të gjitha disiplinat: - 6% lëndë nga Kategoria A, - 54% lëndë nga Kategoria B, - 20% lëndë nga Kategoria C, - 10% nga Kategoria D dhe - 10% nga Kategoria E. Fondi i pyetjeve hartohet nga Departamenti dhe shpallet për studentët në fillim të vitit akademik. Ndërsa lidhur me Temën e Diplomës kriteret janë të njëjta si në kriterin II të po këtij Standardi. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5, Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional", Kreu III Diplomimi, Neni 24 Procedura e diplomimit]; [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU "LOGOS". Kreu XIV - Diplomimi Nenet 107, 109, 110, 111, 112]; [Aneksi 38. Rregulla për Diplomimin].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	RVB lidhur me këtë kriter referon që nuk aplikohet për këtë program studimi kështu <i>që GVJ del në përfundimin që në këtë program studimi detyrimet përmbyllëse kryhen me temë diplome dhe jo me provim final. Gjithsesi duhet të nënvizojmë faktin që ky program nuk ka akoma studentë të diplomuar. Studenti i vetëm i vitit të dytë, viti akademik 23 - 24, nuk është diplomuar.</i> Dokumentacioni referues: [Dok. 5 RVB].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar.	Programi Master i Shkencave në Përkthim Profesional nuk ka studentë të diplomuar gjithsesi për studentët e vitit të II, viti akademik 2024 – 25 DGJCG ka filluar punën për grumbullin e fondit të pyetjeve dhe temave për punim diplome për këtë brez të parë të diplomimit. Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, dekanati i bën me dije studentëve që kanë zgjedhur të mbrojnë diplomën, programin e temave. Në takimet lidhur me temat studentëve studentët ju qartësohen të gjitha detajet e hartimit, strukturimit dhe

Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

zhvillimit të temës si dhe procedura në zbatim të rregulloreve lidhur me Diplomimin.

Lidhur me gjuhën e hartimit të temës duhet rishikuar për vetë specifikat që ka ky program studimi. Aty thuhet që gjuha e temës së diplomës mund të bëhet edhe në gjuhën shqipe, por Programi është për Përkthim Profesional në gjuhë të huaj dhe arsyetimi që anëtarë të komisionit mund të mos njohin njërën nga gjuhët e programit nuk është aspak e justifikueshme dhe bie në kundërshti me faktin që personeli akademik i atij programi e ka detyrim lëndor dhe ligjor njohjen e gjuhës së huaj në këtë rast të programit ku jep mësim që në këtë rast në planin mësimor janë të paraqitura 2: anglisht, greqisht.

Sugjerohet:

- *Saktësimi i gjuhës pasi duke qenë Master në Përkthim Profesional dhe duke marrë në konsideratë faktin që bëhet fjalë që për Master Shkencor në Përkthim Profesional, logjikshëm duhet menduar që tema si në çdo IAL tjetër që ofron këtë lloj programi studimi duhet të jetë kryesisht në gjuhë të huaj, në këtë rast në Anglisht apo Greqisht. Gjithsesi është njësia është ajo që vendos kriteret e hartimit të temës, ndaj GVJ në këtë rast thjesht sugjeron.*
- *Pavarësisht faktit që specifika e Programit përfshin padyshim përdorimin e gjuhës shqipe pasi është gjuha drejt apo nga kryhet përkthimi, ajo shërben në temën finale në formën e sjelljes së shembujve krahasimorë, analizë përfaqëse ndërmjet aspekteve përkthimore ndërmjet gjuhëve, apo teksteve që vijnë nga një gjuhë e huaj të përkthyer në shqip, duke qenë që lëndët e këtij programi fokusohet kryesisht në këtë format përkthimi, por nuk mund të jetë gjuha kryesore e saj.*

Një qartësim nevojitet në këtë pikë edhe lidhur me gjuhët e tjera që përmendet si gjuhë me zgjedhje kur këtë e kemi saktësuar edhe më lart (shih Standardi II. 1., që ky program studimi nuk ofron lëndë me zgjedhje dhe aq më tepër gjuhë të tjera të huaja. Përmenden frëngjisht dhe italisht që realisht do të ishin të domosdoshme për këtë program studimi, pasi do t'i ofronte mundësi studentëve një formim më të plotë dhe një mundësi më shumë në tregun e punës.

	Dokumentacioni referues: [Aneksi 5, Rregullorja e programit te studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional", KREU III Diplomimi, Neni 24 Procedura e diplomimit]; [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU "LOGOS". Kreu XIV - Diplomimi Nenet 107, 109, 110, 111, 112]; [Aneksi 38. Rregulla për Diplomimin].
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GJV bazuar në RVB e këtij programi studimi konstaton siç dhe deklarohet aty që KU "LOGOS" dhe DGJCG vë në dispozicion të studentëve teknologjinë që disponon dhe pajisjet laboratorike të tyre (Laboratori Homo Digital 3D dhe Laboratori "Qendra e Sipërmarrjes dhe Inovacionit") dhe teknologjitë e nevojshme për kryerjen e matjeve dhe analizave specifike, si p.sh. pajisje për analize statistikore, softuerë për përpunim të dhënash. Çdo studenti sipas tipologjisë dhe llojit të temës i afrohet: 1. Asistencë ne Terren 2. Mbikëqyrje dhe Konsulencë të vazhdueshme për çdo nevojë të studentit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 39. Leja e Aprovuar për Përdorim Laboratori, Qendra e Sipërmarrjes dhe Inovacionit]; [Aneksi 6. Tabela 16. Leja e Aprovuar për Përdorim Laboratori Homo Digital 3D].
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi përfundimtar i diplomës përmbledh një proces të detajuar dhe të strukturuar. Vlerësimi përfshin: shqyrtimin e diplomës nga një komision i përbërë nga ekspertë dhe pedagogë të fushës përkatëse. Nota finale është mesatarja e vlerësimeve individuale të secilit anëtar të komisionit, i cili shqyrton përmbajtjen, metodologjinë, origjinalitetin dhe kapacitetin analitik të studentit. <i>Në RVB referohet që ky komision përbëhet nga 5 - 7 anëtarë të cilët propozohen dhe vendosen me vendim departamenti, ndërsa në dok Kriteret dhe Plani ky numër anëtarësh është 3.</i> Pas përfundimit të procesit të mbrojtjes së temës së Diplomës rezultatet hidhen në Procesverbalin përkatës. Në fund të procesit të mbrojtjes rezultatet u bëhen me dije studentëve në prani të Komisionit dhe Diplomantëve të tjerë për

	të qenë sa më transparent dhe të drejtë me këtë proces në zbatim të rregulloreve që e sanksionojnë atë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional]; [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme e KU "LOGOS", Kreu XIV, neni 112, fq. 55]; [Aneksi 6, 61. Plani & Syllabuset. Teza].
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të këtij program studimi, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Diploma me të cilën pajiset studenti është dokument zyrtar. Studenti mbas përfundimit të studimeve gëzon të drejtën të kërkojë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar. Kjo i shërben atyre për të vërtetuar njohuritë dhe aftësitë e fituara për studime e për qëllime të mëtejshme akademike o profesionale. Lidhur me diplomën dhe suplementin ngarkohet me kompetencë Sekretaria Mësimore e cila harton, saktëson dhe plotëson dhe pajis çdo student me dokumentacionin përkatës. Dokumentacioni referues: [Aneksi 6.2, Diploma dhe Suplementi i Diplomës]; [Aneksi 5. Rregullore Master i Shkencave në Përkthim Profesional].
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Legjislacionin në fuqi përcakton cili është dokumentacioni bazë për studentin. Kështu ai përmbledhet në: - Regjistrin themeltar të studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matricullimi deri në marrjen e diplomës apo certifikatës. - Regjistrin e arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik. - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emërtimin e certifikatave dhe diplomave përkatëse për çdo student.

	KU "LOGOS" e zotëron këtë dokumentacion përveç pikës C më lart sepse nuk akoma të diplomuar nga ky program. Databaza e të dhënave të studenteve, përfshin informacione të detajuara mbi regjistrimin, notat, kreditet dhe çdo dokument tjetër akademik të lidhur me studentët. Në RVB deklarohet që kjo databaze është e sigurtë dhe e menaxhuar në përputhje me standardet e privatësisë dhe sigurisë të të dhënave ka <i>një kundërshti pasi, në Aneksin 7. Plani strategjik 2018- 2024 fq 6. ku deklarohet ekzaktësisht "Bazat e të dhënave në lidhje me personelin dhe studentin nuk digjitalizohen", gjë që kufizon mundësinë e të gjitha departamenteve dhe njësive për qasje dhe vlerësim të lehtë.</i> Shtojmë që për këtë IAL ka gjithashtu një rregullore lidhur me grumbullimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, si dhe rregulloren për arkivimin ku dokumentacioni lidhur me studentët ka një afat ruajtje kohore të përhershëm. Në këto rregullore saktësohet që arkivimi dhe ruajtja përfshijnë: a) regjistrat e amzës/NIM, librat themeltar të studenteve; b) librat e arritjeve akademike; c) librat e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Në takimet fizike me Sekretarinë mësimore GVJ konstaton që dokumentacioni është i saktë dhe i rregullt. Ndër të tjera përveç dokumentacioneve të mësipërme u panë dhe regjistrat mësimorë të studentëve që i takojnë vitit akademik 2024- 2025 si dhe procesverbalet e provimeve të realizuara në vitin akademik 2023-2024, duke bërë kështu përjasjen e përmbajtjeve ndërmjet të gjithë dokumentacionit të paraqitur dhe <i>në përfundim del me rezultatin që dokumentacioni është koherent i rregullt dhe respekton legjislacionin në fuqi.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 40. Regjistri Themeltar]; [Aneksi 44. Rregullore për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave]; [Aneksi 44.1. Regjistri i arritjeve akademike]; [Aneksi 45.1. Rregullore Arkiv – Protokolli, Neni 15, Afatet]; [Aneksi 36. Procesverbal provimi 2023- 2024. Viti i I Master. Sezoni i verës].
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë dhe takimeve fizike në institucion vëren që ky standard përmbushet kryesisht

	duke patur parasysh disa vërejtje që lidhen me gjuhën e temës dhe gjuhët e tjera të programit si dhe deklarimin për mungesë digjitalizimi në Aneksin 7. Plani strategjik 2018- 2024 fq 6. ku deklarohet ekzaktësisht “Bazat e të dhënave në lidhje me personelin dhe studentin nuk digjitalizohen”, gjë që kufizon mundësinë e të gjitha departamenteve dhe njësive për qasje dhe vlerësim të lehtë.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në RVB referohet që ky kriter nuk aplikohet për këtë Program studimi. GVJ saktëson që praktika profesionale e studentëve të këtij Programi Master zhvillohet në bazë të marrëveshjeve që KU “LOGOS” ka lidhur për këtë qëllim specifik, me institucione të tjera jashtë këtij institucioni dhe janë pikërisht ato që garantojnë mjediset e nevojshme të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët e këtij Programi Studimi Master. Praktika profesionale përbëhet nga 12 kredite dhe zhvillohet në 12 javë mësimore në semestrin e II të vitit të dytë, <i>por që ka një ngjeshje orësh që ngarkon studentin dhe pedagogun e praktikës.</i> Pedagogu i praktikës monitoron mbarëvajtjen e këtij procesi, <i>por duhet të saktësojmë që akoma nuk ka studentë në këtë Program Studimi Master që të ketë kryer Praktikën Profesionale. Viti akademik 2024- 2025 do të jetë edhe viti i parë i studentëve që do ta kryejnë atë.</i> <u>Nevojitet një shpërndarje më e mirë e orëve të praktikës në semestrin e dytë (shih standardin II.4).</u> Dokumentacioni referues: [Dok 5. RVB]; [Aneksi 6.1 Syllabuset]; [Tab. 1-24, Tabela 5, fq.5]; [Dok shtesë. Pika 1. Praktika Profesionale].


Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Në RVB referohet që ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi. GVJ saktëson që në këtë kriter përmenden praktika klinike dhe stazhet që nuk janë pjesë e po këtij programi studimi Master, por mund të themi që praktika profesionale e studentëve të këtij Programi Master zhvillohet në bazë të marrëveshjeve me partnerë që KU "LOGOS" ka lidhur për këtë qëllim specifik. Dokumentacioni referues: [Tabela 1-24, Tab 5. Fq.5]			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në RVB referohet që ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi. GVJ saktëson që <i>Praktika Profesionale që parashikon ky program studimi bazuar në VKM 41, hyn në kategorinë lëndore: Kategoria D që përbën 10% të 120 krediteve të këtij Programi, ndaj dhe si e tillë kjo lëndë është 12 kredite.</i> Gjithashtu zhvillimi i kësaj lënde zhvillohet dhe mbështetet me dokumente shoqëruese që përcaktohen nga aktet rregullatore të kësaj IAL.			
Konkluzione	GVJ në shqyrtim të dokumentacionit të përcjellë vëren që ky standard përmbushet kryesisht për shkak të mungesës së informacioneve të përcjella në RVB, por që ishin ekzistuese në dokumentacionin e përcjellë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Gjatë vizitës në institucion si edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi, përmbush kriteret ligjore lidhur me kualifikimin e duhur për realizimin e orëve mësimore. Në takimet mes personelit akademik, zyrës së burimeve njerëzore të universitetit si edhe takimeve me dekanin dhe përgjegjës të departamentit, u deklarua se për punësimin e personelit është ndjekur procedura standarde ku përgjegjësi i departamentit ka bërë kërkesën lidhur me nevojat, ka hartuar kriteret e përgjithshme ia ka dërguar dekanit për miratim, ky i fundit rektorit dhe më pas njoftimi është bërë publik në faqen zyrtare të Logos. Aplikimet janë dërguar nëpërmjet adresës së email ose edhe nëpërmjet postës Shqiptare në zyrën e burimeve njerëzore. Vlen të theksohet fakti se, duke qenë se kjo fushë është shumë specifike dhe kërkon ekspertë të mirëfilltë dhe njohës të mirë të përkthimeve specifike, ndonjëherë profesorët janë ftuar për t'u angazhuar në mësimdhënie por procedura e punësimit është ndjekur njëllëj. Kontratat e punës dhe dosjet e personelit akademik janë të plota dhe të ruajtura në zyrën e burimeve njerëzore. Në total, në Departamentin e Gjuhës dhe Civilizimit Grek për vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar 19 personel akademik, nga të cilët 8 me kohë të plotë dhe 10 me të pjesshme. Ndërsa, për vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar gjithsej 22 personel akademik nga të cilët 10 me kohë të plotë dhe 12 me kohë të pjesshme. <table><tr><th rowspan="2">Tituj/Grada</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td></td></tr><tr><td>Prof. Asoc. Dr</td><td>2</td><td>4</td><td>2</td><td>5</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>3</td><td>6</td><td>4</td><td>5</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Total</td><td>9</td><td>10</td><td>10</td><td>12</td></tr></table> Personeli akademik plotëson kriteret ligjore lidhur me gradat dhe titujt shkencorë të nevojshëm për organizimin e departamentit. Megjithatë, ajo që u vu re ishte një mungesë e stafit ndihmës akademik/administrativ. <i>Nga dokumentet e vëna në dispozicion</i>	Tituj/Grada	2023-2024		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	1		Prof. Asoc. Dr	2	4	2	5	Dr./PhD	3	6	4	5	Msc.	3	-	3	2	Total	9	10	10	12
Tituj/Grada	2023-2024		2022-2023																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof. Dr	1	-	1																																
Prof. Asoc. Dr	2	4	2	5																															
Dr./PhD	3	6	4	5																															
Msc.	3	-	3	2																															
Total	9	10	10	12																															



	<i>nuk është deklaruar asnjë personel ndihmës akademik. Pasi GVJ kërkoj plotësim dokumentacioni, u vunë në dispozicion Cv-të e dy personeleve akademik të KU "LOGOS" por kjo nuk vërteton angazhimin e tyre si personel ndihmës akademik. GVJ vlerëson se prezenca e personelit ndihmës akademik është i domosdoshëm për këtë program studimi ndaj edhe sugjeron që njësia bazë të marrë masa në këtë aspekt.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar Logos]; [Tabelat 1-24, tabela 2.1, tabela 6.2]; [Dok shtesë. Pika 8&11, Personel ndihmës akademik].
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Lidhur me ngarkesën mësimore për programin e studimit, GVJ konstatoi se në fillim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit bën shpërndarjen për secilin personel akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ajo që u theksua edhe në takimet e zhvilluara është se ngarkesa realizohet në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe departamentet e saj, për të mbuluar 70% të saj. Mbështetur gjithashtu në Dokumentacioni referues, rezultojnë se: - PAE ka 540 (52.94 %) ngarkesë mësimore dhe PAK ka 480 (47,05 %) orë mësimore, pra gjithsej 1020 (100%) orë. Ndërsa, për vitin akademik 2022-2023 ku: - PAE ka 360 (66.6 %) orë ngarkesë mësimore dhe PAK 180 (33.4 %) orë ngarkesë mësimore, pra gjithsej 540 (100%) orë. <i>Në këtë përlllogaritje ngarkese del në pah që IAL nuk e respekton kuadrin ligjor të realizimit të 70% të ngarkesës së programit me personel PAE, ndaj GVJ sugjeron plotësimin edhe respektimin e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me këtë pikë.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar Logos]; [Tabelat. 1-24].
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e	Në takimet e zhvilluara në Kolegjin Universitar Logos GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i qëndrueshëm, kontratat e të cilëve janë rinovuar sipas kategorive respektive, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Kjo gjë u confirmua nga përgjegjësi i departamentit dhe përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore. Gjatë dy viteve të fundit, personeli akademik i angazhuar nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme.

punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Kjo verifikon qëndrueshmërinë e tij. Megjithatë, ka një mospërputhje mes personelit akademik të deklaruar në dokumentacion e vënë në dispozicion nga KU “LOGOS” dhe atij të deklaruar në organet tatim pagues. Dokumentacioni referues: [Aneksi 18. Raporti Vjetor i KU “LOGOS”]; [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar “LOGOS”].
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme rekrutohet në bazë të një procedure të rregullt ligjore. Përgjegjësi i Departamentit përcakton nevojat dhe kriteret specifike që duhet të përmbushë personeli akademik dhe më pas kërkesën e drejton në Dekanat, ku dekani e miraton dhe më pas ia përcjell rektorit për miratim. Në këtë moment, zyra e burimeve njerëzore përcakton kriteret e përgjithshme dhe bën njoftimin në faqen zyrtare të internetit, duke përcaktuar edhe afatet e aplikimit. Sipas përfaqësuesve të zyrës së burimeve njerëzore gjatë takimeve të zhvilluara në Kolegjin Universitar Logos, bashkëpunimi me IT ka qenë i kënaqshëm, ku ky i fundit ka bërë menjëherë publikimin e njoftimit në faqen zyrtare. Gjithashtu, lidhur me kontratat e punës rezultoi se, kontratat për personelin akademik me kohë të plotë janë me afat të pacaktuar ndërsa ato për personelin akademik me kohë të pjesshme më afat 1 vjeçar, si edhe janë të pajisura me të gjithë elementët ligjorë si firma, data e fillimit dhe përfundimit, vula. Ajo çfarë u theksua gjatë takimeve ishte fakti se duke qene se profili i përkthimit profesional është shumë specifik, përgjegjësi i departamentit ka kërkuar ndihmë në profesorë të huaj për t’iu bashkuar ekipit, pra njoftimi është bërë nëpërmjet postës elektronike por procedura e rekrutimit është realizuar sipas akteve ligjore në fuqi. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar “LOGOS”]; [Aneksi 41. Kontrata tip-PAE/PAK]; [Aneksi 42. Paketa rekrutimi].
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e	Gjatë takimeve të zhvilluara në Kolegjin Universitar Logos, si edhe mbështetur në dokumentet e vendosura në dispozicion, GVJ konstatoi se për këtë program studimi vijnë në ndihmë disa ambiente të pajisura me mjetet teknologjike të nevojshme për të praktikuar përkthimin e materialeve specifike. Laboratorët




orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	konsistojnë në sallë kompjuteri, mjet ky i cili është shumë i domosdoshëm në profesionin e përkthyesit por edhe laboratorë të tjerë të tillë si Laboratori i Medias dhe Edukimit Digjital, të cilët janë në funksion të të gjithë njësisë kryesore dhe asaj bazë dhe nuk janë specifike vetëm për programin e përkthimit. <i>Ajo çfarë u vu re ishte mangësia e një laboratorit tipik përkthimi, i cili do të ndihmonte studentët të përvetësonin aftësitë e tyre në përkthim dhe të përmbushnin detyrimet sipas planit mësimor, duke qenë se janë deklaruar orë laboratorike.</i> Megjithatë, duke marrë në konsideratë faktin që ky program studimi është hapur vetëm prej 2 vitesh dhe me një numër shumë të vogël studentësh, mundësitë për të investuar në këtë laborator, që ka një kosto të konsiderueshme, në një periudhë kaq të shkurtër kanë qenë shumë të pakta. <i>Ajo çfarë vlen të vlerësohet është fakti se përfaqësuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë ishin të vetëdijshëm për këtë mungesë dhe u shprehën se janë duke punuar për t'i garantuar studentëve një laborator të mirëfilltë përkthimi.</i> <i>Gjithashtu lidhur me atë çfarë kemi trajtuar në Standardin II (shih konkluzione të Standardit II, 1, 3,) është e rëndësishme që ky plan mësimor të marrë në konsideratë formimin edhe si interpretues siç deklarohet tek Ankesi 4. Të dhëna për programin. Gjithsesi kjo mbetet në varësi të departamenti se në çfarë aspektesh do të formojë studentët e këtij programi. (shih standardin</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar “LOGOS”]; [Aneksi 2. Relacion Homo Digitalis]; [Aneksi 41. Kontrata tip-PAE/PAK].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të	GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “LOGOS”, nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore, mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik. Kjo realizohet nëpërmjet përditësimit të kontratave të punësimit për personelin me kohë të pjesshme, kontrata e të cilëve është me kohëzgjatje 1 vjeçare. Zyra e burimeve njerëzore dhe zyra e arkiv protokollit deklaruan se dosjet e personelit ruhen dhe përditësohen edhe për personelin akademik me kohë të plotë. Të dhënat e përditësuara lidhen me pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, kualifikime, apo angazhimin në aktivitete të tjera në funksion të pozicionit të punës. Gjithashtu,

studimit, angazhimin e çdo anëtarin në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	zyra e burimeve njerëzore vuri në dispozicion një dosje të përditësuar të personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme. Në dosjet e tyre gjendeshin të gjithë dokumentet e nevojshme që vërtetojnë ligjshmërinë (të noterizuara) e ushtrimit të profesionit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 45. Rregullore e Zyra e Burimeve Njerëzore]; [Aneksi 45.1. Zyra e Arkiv-Protokollit, Formulari i aplikimit nga ueb]; [Aneksi 43. Përmbledhëse e dokumentacionit në dosjen e personelit akademik dhe formularë].
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë takimeve në Kolegjin Universitar Logos, GVJ konstatoi se janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, me institucione të ndryshme, në kuadër të ofrimit të praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Marrëveshjet janë nënshkruar mes universiteteve, bashkive, shtëpive botuese, qendrave muzeore apo instituteve të përkthimit. Mënyra e organizimit dhe mbikëqyrjes së praktikës profesionale është parashikuar me një rregullore të veçantë. Megjithatë, praktika profesionale ushtrohet në vitin e dytë të studimeve në këtë program. Fatkeqësisht, vitin e dytë të studimeve nuk kanë mundur ta ndjekin asnjë nga studentët e regjistruar në vitin akademik paraardhës. Në vitin akademik 2024-2025 janë regjistruar për herë të parë studentët e vitit të dytë në këtë program studimi, prandaj edhe kjo praktikë nuk është e dokumentuar nga ana e institucionit dhe as e deklaruar nga ana e studentëve. Marrë në konsideratë faktin se ky është një program i ri studimi i cili nuk ka më shumë sesa dy vjet që ofrohet, procedura për ndjekjen e praktikës profesionale është e parashikuar në rregullore edhe pse nuk është aplikuar ende, <i>por duhet të shihet ngarkesa javore e studentit gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, pasi rezulton 7.5 orë ditore duke qenë që ka një ngjeshje brenda 2 muajve mësimorë në semestrin e II.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullorja e përgjithshme e KU “LOGOS”]; [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit MSHPP]; [Aneksi 17. Marrëveshjet e bashkëpunimit]; [Aneksi 64. Modeli për praktikën e studentit]; [Dok Shtesë. Pika 1. Praktika Profesionale].

Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar përmbushjes së detyrimeve sipas marrëveshjeve të lidhura me Kolegjit Universitar Logos dhe institucioneve të tjera, për ofrimin e praktikave profesionale, GVJ konstatoi se institucionet pritëse kanë detyrimin për t'u angazhuar në mënyrë specifike për të ndihmuar studentët të përmbushin detyrimet e praktikës profesionale. Edhe në rregulloren e programit të studimit, specifikohet angazhimi i personelit akademik në mbikëqyrjen e studentëve gjatë orëve të praktikës për një realizim sa më rigoroz të saj. Megjithatë, studentët ende nuk kanë kryer praktikën profesionale ndaj dhe kjo gjë nuk mund të dokumentohet.			
	Dokumentacioni referues: [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit MSHPP]; [Aneksi 64. Modeli për praktikën e studentit]; [Dok Shtesë. Pika 1. Praktika Profesionale].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion si edhe pas vizitës të kryer në institucion, vëren që ky standard përmbushet kryesisht kjo pasi sipas vërejtjeve të përshkruar më sipër është i nevojshëm respektimi i kuadrit ligjor lidhur me ngarkesën e personelit PAE që duhet të mbulojë jo më pak se 70% të programit. Për shkak të numrit të vogël të studentëve të regjistruar në këtë program studimi, si edhe mos regjistrimit të studentëve në vitin e dytë, praktikat profesionale nuk janë zhvilluar e për pasojë nuk ka një procedurë të dokumentuar mbi realizimin e saj përveç rregullores dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga KU “LOGOS”. GVJ mori në konsideratë periudhën e shkurtër për të cilën është ofruar ky program studimi duke mos e konstatuar këtë si mangësi. GVJ konstatoi se KU “LOGOS” vë në dispozicion hapësira për zhvillimin e orëve laboratorike në laboratorët të cilët janë në dispozicion të njësisë kryesore dhe asaj bazë, por nuk janë laboratorë specifikë të përkthimit. Gjithashtu, GVJ konstatoi mungesë të angazhimit të personelit ndihmës akademik. Ndaj Për sa më sipër, GVJ sugjeron që Kolegji Universitar “LOGOS” të ofrojë laboratorë specifikë të përkthimit për këtë program studimi për të garantuar cilësinë e programit dhe të profesionistëve të ardhshëm si edhe të angazhojë personel ndihmës akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Pas vizitës në institucion por edhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se Kolegji Universitar Logos garanton mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Godina ndodhet në një zonë lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe ka një sipërfaqe prej 5931 m². Mjediset në dispozicion janë të mjaftueshme për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Mjediset janë të pajisura me sistem ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën. Objekti plotëson kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe për personelin akademik e administrativ duke shmangur elementët e rrezikshmërisë. Objekti përmbush detyrimet për sistemin e mbrojtës kundër zjarrit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 46 dhe 47. Kontratë huapërdorje]; [Aneksi 47.2 Certifikatë për sigurinë nga zjarri]; [Aneksi 47.1 Akt-miratimi higjieno sanitar]; [Aneksi 46.5 Relacion Teknik për gjendjen e objekteve të KU “LOGOS” pas tërmetit]; [Aneksi 46.1 Tabela e godinave të kampuseve].
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore të vëna në dispozicion për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, janë të pajisura me mjete elektrike dhe teknologjike si: kompjuter, video-projektor, kamera, tabelë smart, të domosdoshme për të mundur një proces mësimor bashkëkohor. Kolegji Universitar Logos ofron ambiente të posaçme për bibliotekën dhe mundësinë për të aksesuar materiale online. Për të lehtësuar lëvizjen nga njëri kat në tjetrin, godina disponon edhe një ashensor funksional i cili mund të përdoret si nga studentët ashtu edhe nga personeli akademik dhe administrativ. Dokumentacioni referues:

	[Aneksi 48. Vendim i Bordit Administrativ/ Administratori për alokim fondesh për blerje te Pajisjeve te Laboratorët e KU “LOGOS”]; [Aneksi 47. Kontratë huapërdorje]; [Aneksi 46. Kontratë huapërdorje]; [Aneksi 46.1. Tabela e godinave të kampuseve].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë takimeve të zhvilluara në Kolegjin Universitar Logos, GVJ konstatoi se ambientet e dedikuara për procesin mësimor, plotësojnë kushtet për mësimdhënie. Ato janë të pajisura me infrastrukturën e përshtatshme teknologjike, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e një procesi mësimdhënës dhe nxënës bashkëkohor dhe interaktiv. Laboratorët e deklaruar në anekset përkatëse, por edhe të verifikuara gjatë takimeve u vijnë në ndihmë studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Edhe pse këto laboratorë nuk janë specifik për këtë program studimi, shpeshherë ata përdoren nga studentët nëse lënda ia lejon. Dokumentacioni referues: [Aneksi 48. Vendim i Bordit Administrativ/ Administratori për alokim fondesh për blerje te Pajisjeve te Laboratorët e KU “LOGOS”]; [Aneksi 46 & 47. Kontratë huapërdorje]; [Aneksi 46.1. Tabela e godinave të kampuseve].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>GVJ gjatë takimeve në kolegjin universitar Logos konstatoi se mungon një laborator i mirëfilltë përkthimi për të ndihmuar studentët të aftësohen në përkthime specifike.</i> Gjithsesi, kjo mangësi nuk do të jetë për shumë kohë pasi vetë përgjegjësi i njësive kryesore dhe asaj bazë shprehën gatishmërinë për të marrë masat e nevojshme për t’i garantuar studentëve një laborator përkthimi. Vlen të theksohet fakti si duke qenë një program i miratuar rishtazi, edhe koha në dispozicion për të bërë investime të konsiderueshme ka qenë e pamjaftueshme. Megjithatë, në mënyrë që procesi i mësimdhënies dhe nxënies të zhvillohet në mënyrë sa më profesionale, edhe në mungesë të një laboratorit specifik <i>njësia kryesore ka gjetur mënyra alternative si huapërdorja e laboratorëve që KU “LOGOS” ka në dispozicion, qoftë edhe nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 39. Leje për përdorim të laboratorit];

	[Aneksi 46.1. Tabela e godinave të kampuseve]; [Aneksi 48. Vendim i Bordit Administrativ/ Administratori për alokim fondesh për blerje të Pajisjeve të Laboratorëve të KU "LOGOS"].			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe gjatë takimeve të zhvilluara në mjediset e Kolegjit Universitar Logos, GVJ konstatoi se duke qenë një program i miratuar rishtazi dhe duke pasur një numër shumë të vogël të studentëve të regjistruar në vitin e parë, në vitin e dytë të vitit akademik paraardhës nuk ka pasur studentë të regjistruar. Duke qenë se praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë të programit master i shkencave, kjo gjë nuk është realizuar praktikisht. Megjithatë, kolegji universitar ka miratuar një rregullore të praktikave profesionale si edhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet të ndryshme për të ndihmuar studentët të praktikohen në fushën e tyre të studimit. [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit MSHPP]; [Aneksi 64. Modeli për praktikën e studentit]; [Aneksi 65. Modeli formulari i vlerësimit nga punëdhënësi].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion vëren që ky standard përmbushet kryesisht pasi megjithëqë Kolegji Universitar Logos u vë studentëve në dispozicion ambiente dhe mjedise të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies, godina është e pajisur me mjete të nevojshme të ngrohjes dhe ftohjes, një ashensor për të lëvizur lehtësisht nga njëri kat në tjetrin, mjet ky i cili është në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik dhe administrativ, mjediset mësimore plotësojnë normativat e ndriçimit natyral, ajrosjes, njësia kryesore dhe njësia bazë ofrojnë laboratorë për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, por këto laboratorë nuk janë specifike të fushës së përkthimit ndaj duhet që të mundësohen laboratorë të përkthimit specifik për këtë program studimi që të mund t'i ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar këto orë mësimore në mënyrë sa më profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Logos, por mbështetur gjithashtu në takimet e zhvilluara në mjediset e këtij kolegji, GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ofron një bibliotekë të pasur me tekste universitare, libra, revista shkencore por mbi të gjitha fjalorë dhe dorëshkrime të vjetra, të cilat përdoren nga studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Kjo bibliotekë, përveç studentëve, është në dispozicion edhe të personelit akademik. Biblioteka ofron shërbimin online dhe fizikisht. Personeli akademik është një pasurues i bibliotekës, duke depozituar publikimet e tyre. Kryesisht titujt janë në gjuhën shqipe, angleze dhe greke. Në bibliotekë ofrohen gjithsej 40 poste studimi si edhe 18 poste të bibliotekës online. Orari gjatë të cilit studentët dhe personeli akademik mund ti drejtohet bibliotekës është 09:00-16:30. Megjithatë, nëse është nevoja personi përgjegjës mund të qëndrojë edhe jashtë këtij orari. Personeli akademik apo studenti që dëshiron të tërheqë një tekst, duhet ta regjistrojë marrjen e tekstit apo botimit nëpërmjet kartelës dhe duhet ta dorëzojë atë brenda një afati të caktuar. Dokumentacioni referues: [Tabela 1-24. Tabela 17]; [Aneksi 49.2. Lista e Titujve të Librave]; [Aneksi 49.1. Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49. Rregullore Bibliotekës së KU “LOGOS”]. [Dok. Shtesë. Pika 12. Fondi i librave]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstatoi se literatura e vënë në dispozicion të këtij program studimi i përket periudhave të ndryshme kohore, pasi përkthimi profesional i referohet materialeve specifike. <i>Kjo nuk e përjashton ekzistencën e titujve të rinj, edhe pse shumë të vegjël në numër për këtë program studimi.</i> Vetë KU “LOGOS” ka një procedurë të pasurimit të bibliotekës, e cila inicohet nga përgjegjësi i njësise bazë, në fillim të çdo viti akademik.

	Dokumentacioni referues: [Tabela 1-24. Tabela 17]; [Aneksi 49.2. Lista e Titujve të Librave]; [Aneksi 49.1. Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49. Rregullore Bibliotekës së KU “LOGOS”]. [Dok shtesë. Pika 12. Totali i fondit të librave]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kolegji Universitar Logos vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, si bibliotekën fizike edhe atë online. Studentët mund të zgjedhin të punojnë në bibliotekë duke shfrytëzuar postet e leximit ose të kërkimit të pajisura me kompjuter për të kërkuar çfarëdo informacioni të nevojshëm. Studentët gjithashtu mund të huazojnë literaturën e nevojshme dhe ta përdorin atë jashtë ambienteve të KU “LOGOS”. Kjo e drejtë u lind me anëtarësimin në këtë bibliotekë. Literatura e ofruar është kryesisht në tre gjuhë, shqip, anglisht dhe greqisht. Megjithatë, kjo nuk përjashton edhe tituj në gjuhë të tjera si ajo sllave, gjermane, italiane apo frënge. Dokumentacioni referues: [Aneksi 49.3. Kartela e bibliotekës]; [Aneksi 49.2. Lista e Titujve të Librave]; [Aneksi 49.1. Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49. Rregullore Bibliotekës së KU “LOGOS”].
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Biblioteka e KU “LOGOS”, është në dispozicion të gjithë programeve të studimit që ofrohen nga njësia kryesore dhe ajo bazë. GVJ konfirmon se biblioteka është e pajisur me fond fizik si tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kryesisht në gjuhën shqipe, angleze dhe greke. Konkretisht, gjatë viteve akademike 2022-2024 programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional është përditësuar me 265 libra (96 greqisht, 13 anglisht, 3 frëngjisht) dhe 257 tituj (146 shqip, 95 greqisht, 13 anglisht, 3 frëngjisht). Aksesit në artikuj e revista shkencore, realizohet përmes bibliotekës elektronike, sipas adresave të dedikuara institucionale. Dokumentacioni referues: [Aneksi 49.2. Lista e Titujve të Librave]; [Aneksi 49.1. Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49. Rregullore Bibliotekës së KU “LOGOS”].

Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	KU "LOGOS" deklaroi se ka krijuar kushte e përshtatshme për studentët, për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online, përkatësisht JSTOR, EBSCO. Sipas KU "LOGOS", nëpërmjet platformës elektronike më poshtë, studentët mund të shkarkojnë çdo material të nevojshëm lidhur me studimet e tyre, realizimin e ndonjë projekti ose detyre. Kjo gjë u konfirmua edhe në takimet me studentët të cilët u shprehën se e përdorin këtë platformë gjatë vitit akademik. Dokumentacioni referues: [https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26]; [Aneksi 49.1 Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49 Rregullore Bibliotekës së KU "LOGOS"].
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me poste studimi por edhe kompjutera ku studentët mund të përdorin bibliotekën online ose të shkarkojnë dhe konsultohen me materiale të ndryshme. Kompjuterat janë të pajisur me lidhje interneti, dhe në to janë instaluar programe të tilla si Google Chrome, JSTOR, EBSCO, Microsoft Office, Excel, etj. Fondi i Bibliotekës paraqitet në bazën e të dhënave elektronike përmes regjistrimeve në programin e katalogimit të përbashkët elektronik PLEIADES bazuar në standardin MARC 21. Ky katalog ndihmon studentët por edhe personelin akademik në gjetjen e informacionit. Dokumentacioni referues: [http://lib-orthodoxalbania.org] [Aneksi 49.1 Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49 Rregullore Bibliotekës së KU "LOGOS"];
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë takimeve me studentët si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve, sipas orareve të koordinuara të zhvillimit të procesit mësimor dhe këto orare janë të afishuara. Përkatësisht nga ora 09:00 e mëngjesit deri në orën 16:30 të pasdites, përgjatë gjithë ditëve të vitit, përveç ditëve të festave zyrtare. Dokumentacioni referues: [Aneksi 49.1 Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49 Rregullore Bibliotekës së KU "LOGOS"].

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ konstatoi se biblioteka përmban një plan strategjik, i cili ka për qëllim përditësimin e fondit ekzistues. Përditësimi realizohet nëpërmjet blerjes, dhurimit ose shkëmbimit të teksteve ose botimeve. Në fillim të vitit akademik, personeli akademik paraqet një kërkesë në drejtim të përgjegjësit të njësisë bazë lidhur me përditësimet e nevojshme të fondit të bibliotekës për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Përgjegjësi i njësisë bazë ia përcjell këtë listë koordinatorit të bibliotekës dhe sipas mundësive bëhet e mundur përditësimi i fondit të bibliotekës. Dokumentacioni referues: [Aneksi 49.1 Strategjia e Bibliotekës 2024-2029]; [Aneksi 49 Rregullore Bibliotekës së KU “LOGOS”].
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit vëren që standardi përmbushet plotësisht pasi KU “LOGOS” ofron një bibliotekë të pasur me tekste, libra, revista shkencore, fjalorë dhe dorëshkrime të vjetra, të cilat përdoren nga studentët dhe personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Biblioteka është e aksesueshme si për studentët ashtu edhe për personelin akademik, duke ofruar shërbime online dhe fizike çdo ditë të javës, nga ora 09:00-16:30. Personeli akademik kontribuon në pasurimin e bibliotekës duke depozituar publikimet e tyre. Për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, titujt kryesisht janë në gjuhën shqipe, angleze dhe greke. Sistemi i katalogimit të informacionit në bibliotekë mbështetet në standard të njohura si MARC 21, duke lehtësuar gjetjen e informacionit për përdoruesit. Gjithashtu në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik janë vendosur edhe platformat online JSTOR dhe EBSCO, nga të cilat mund të shkarkohen materiale të ndryshme akademike. Gjithsesi GVJ rekomandon përditësimin dhe kontrollin e vazhdueshëm teknik si dhe përditësimin e faqeve të internetit apo platformave online.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare të KU "LOGOS" ka seksione të veçanta që shërbejnë për të aksesuar informacione të ndryshme lidhur me aktivitetin mësimor si orari, lajmërimi, të dhëna mbi KU "LOGOS", departamentin, programin e studimit, rregulloren e institucionit etj. Përveç faqes së internetit, informacioni publikohet në forma të tjera si nëpërmjet fletëpalosjeve, shpalljeve publike në xham, sekretaria mësimore ose dërgimit me email. Gjithashtu, KU "LOGOS" ofron edhe platformën TEAMS për studentët dhe personelin akademik nëpërmjet të cilës mund të shkëmbehen materiale mësimore, informacione, orari apo çdo detaj tjetër që ndikon në performancën e studentëve. Në RVB referohet që Sistemi EduPage është një LMS me shumë funksionalitete që KU "LOGOS" ofron në shërbim të personelit akademik dhe studentëve, për shërbime të ndryshme si komunikim me studentin, regjistër digjital për regjistrimin e temave dhe prezencën, regjistër digjital për notat, planin mësimor dhe materialet, publikimin e orarit mësimor, kontrolli i mungesave & notave nga sekretaria, gjenerimin e raporteve të nevojshme nga sekretaria, gjenerim statistika në lidhje me notat, prezence, etj. Kjo gjë u shpjegua gjatë takimeve në KU "LOGOS". Dokumentacioni referues: [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html]; https://www.office.com/]; [Aneksi 44. Rregullore për grumbullimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale]; [Dok. N. 5 RVB].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin,	Mbështetur në vizitën e kryer në KU "LOGOS", GVJ konstatoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit dhe administrimit të informacionit, realizohet nëpërmjet strukturave të përcaktuara në

dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	aktet e brendshme të institucionit. KU "LOGOS" ka një koordinim të mirë mes strukturave në ndarjen e informacionit, të dhënave, ruajtën dhe përditësimin e dosjes së personelit. Koordinimi i brendshëm realizohet edhe nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara, specifike për departamentin ose të përbashkëta me njësinë kryesore. Një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e brendshëm luan edhe sekretaria mësimore. Ajo bashkëpunon me personelin akademik, studentët apo çdo njësi tjetër, duke ofruar ndihmën për çdo informacion të nevojshëm nga ana e saj. Për më tepër, aplikacioni Outlook është një tjetër aplikacion që përdoret në KU "LOGOS" për të shkëmbyer informacion por edhe për tu identifikuar si punonjës apo student të këtij kolegji. Emaili zyrtar është në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve dhe nëpërmjet tij ata mund të bashkëpunojnë nëpërmjet grupeve për të shkëmbyer informacione, lajmërimi apo materiale mësimore. <i>Megjithatë, ajo që u vu re gjatë verifikimit të dokumentacionit ishte se në CV jo i gjithë personeli akademik deklaroi E-Mail zyrtar. Në syllabuse një pjesë e mirë e personelit akademik deklaroi E-Mail personal.</i> Dokumentacioni referues: [https://www.office.com/]; [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Mbështetur në takimet e zhvilluara në KU "LOGOS", GVJ konstatoi se ky kolegji përdor sisteme informimi. Informacioni mund të jetë i brendshëm ose publik. Në të dyja rastet, mënyra e shpërndarjes së informacionit ndryshon, duke respektuar të dhënat personale dhe informacionin diskret. Sistemi Edupage përdoret edhe nga studentët edhe nga personeli akademik por edhe nga sekretaria mësimore. Kryesisht ky sistem ka për funksion krijimin e një regjistri elektronik, edhe pse në sekretarinë mësimore ka edhe regjistra fizikë, krijimin e klasave mësimore, kontrollin e notave, hedhjen e notave, gjenerimin e raporteve apo informacione të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Dokumentacioni referues: [[http://www.kulogos.edu.al/al/index.html]; [Aneksi 44. Rregullore për grumbullimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale]; [Aneksi 36. Procesverbal].

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstatoi se sistemi Teams, Outlook dhe EduPage janë në shërbim të personelit akademik dhe studentëve për të shkëmbyer informacione, emaile, materiale didaktike. Këto sisteme janë gjithashtu të aksesueshme nga sekretaria mësimore, e cila bën të mundur njoftimin e secilit student mbi vlerësimin, orarin apo çdo të dhënë tjetër që mund të kërkohet. Nëpërmjet këtyre sistemeve edhe njësitë brenda kolegjit e kanë më të lehtë komunikimin apo gjenerimin e të dhënave të nevojshme, në një kohë shumë të shkurtër. Dokumentacioni referues: [Aneksi 52. Mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm]; [Aneksi 44. Rregullore për grumbullimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale]; [Aneksi 6.2. Diploma dhe suplementi]; [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html].
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjatë takimeve në KU “LOGOS” konstatoi se, sistemet e deklaruara të tilla si Teams, Outlook dhe EduPage janë funksionale dhe e kanë lehtësuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm si edhe lehtësojnë mënyrën e raportimit apo realizimit të procesit mësimor. Në faqen zyrtare të internetit, që shërben si një sistem ku jepen informacione të jashtme, gjenden informacione mbi njësitë kryesore, njësitë bazë, programet e studimit, personelin akademik të angazhuar, apo njoftime lidhur me praktika mësimore, Erasmus, konferenca. Ky sistem menaxhimi i ngritur garanton edhe raportimin në organet drejtuese. Faqja zyrtare e internetit ofrohet në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. Megjithatë, faqja zyrtare e internetit duhet të përditësohet për disa informacione në momentin që ka pasur ndryshime. Dokumentacioni referues: [https://kulogos.edupage.org/]; [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html]; [Aneksi 52. Mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm]; [Aneksi 19. Raport vjetor FSHHKGJ].
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin	GVJ konstatoi se në faqen e internetit të KU “LOGOS” jepen informacione mbi programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, jepen informacione lidhur me kreditet,

akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	ndarjen vjetore të lëndëve, kontaktet institucionale, Cv e personelit, lajmërimi. Faqja ofrohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe angleze. <i>Ajo çfarë u vu re ishte se Cv e personelit akademik në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional nuk janë të përditësuara dhe të unifikuara. GVJ sugjeron se Cv duhet të përditësohen dhe të ofrohen në gjuhën shqipe dhe angleze në mënyrë të unifikuar.</i> Dokumentacioni referues: [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html].			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara në mjediset e KU "LOGOS" vëren që standardi përmbushet plotësisht. Ky kolegji ka krijuar një sistem të brendshëm funksional të menaxhimit, administrimit dhe publikimit të informacionit, e realizuar përmes akteve të brendshme. KU "LOGOS" ka arritur një koordinim të mirë ndërmjet strukturave lidhur me ndarjen e informacionit, ruajtjen dhe përditësimin e dosjes së personelit. Koordinimi i brendshëm realizohet përmes mbledhjeve të zhvilluara, të cilat janë specifike për departamentet ose të përbashkëta me njësinë kryesore. Emaili zyrtar është në dispozicion të gjithë personelit akademik dhe studentëve, dhe nëpërmjet tij ata mund të bashkëpunojnë në grupe për të shkëmbyer informacione, njoftime, apo materiale mësimore, por sugjerohet që Cv-të e personelit akademik të publikuara në faqen zyrtare të KU "LOGOS" duhet të përditësohen dhe të unifikohen, si edhe të ofrohen në gjuhën shqipe dhe angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe	Pas takimeve të zhvilluara në KU "LOGOS", GVJ konstatoi se KU "LOGOS" ka një procedurë të përcaktuar të planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare, duke përcaktuar nevojat financiare për realizimin e programit të studimit Master i

planin për mbështetjen
financiare të nevojshme për
mbarëvajtjen e programeve të
studimit për të paktën një
cikël të plotë studimi.

Shkencave në Përkthim Profesional. Pasi njësia bazë planifikon mënyrën e shpërndarjes së burimeve financiare, ia dërgon njësisë kryesore dhe kjo e fundit e dërgon për miratim fillimisht në Senatin Akademik dhe më pas në Bordin e Administrimit, duke siguruar një transparencë të burimeve financiare. Administratori për çdo vit harton projektbuxhetin në përputhje me politikat e zhvillimit të kolegjit dhe të akteve nënligjore në fuqi. Sipas asaj që u deklarua gjatë vizitave në KU "LOGOS", qëndrueshmëria financiare e KU "LOGOS" garantohej nëpërmjet tarifave të studimit që paguajnë studentët por edhe nga donacionet e Fondacionit "LOGOS", duke mbuluar shpenzimet e nevojshme dhe bursat e studimit. Megjithatë, *GVJ konstatoi se dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi buxhetin afatmesëm nuk përputhet me atë që është deklaruar. Nga dokumentacioni rezultojnë shkresat përcjellëse por nuk ka buxhet bashkëlidhur apo pasqyra financiare që verifikojnë zërat e deklaruar. Informacione të përgjithshme mbi zërat e buxhetit janë pasqyruar vetëm në raportin vjetor të KU "LOGOS".*

Dokumentacioni referues:

[Aneksi 50-50.4. Projektbuxheti afatmesëm];

[Tabelat 1-24. Tabela 18];

[Aneksi 20. Bursat 2024];

[Aneksi 18. Raporti Vjetor KU "LOGOS" 2022-2023].



Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Pas takimeve të zhvilluara në KU “LOGOS”, GVJ konstatoi se njësitë kryesore pasi mbledhin kërkesat e njësive bazë ia dërgojnë ato administratorit të KU “LOGOS”, i cili bën edhe shpërndarjen e kërkesave sipas zërave. Duke qenë një kolegji relativisht i vogël, administratori mbulon të gjitha njësitë. Projekt buxheti që harton administratori përcakton përparësitë dhe nevojat për investime në përputhje me nevojat infrastrukture dhe logjistike. Kjo gjë u pranua gjatë takimeve të zhvilluara në KU “LOGOS”, por <i>GVJ vlerëson se dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me buxhetin dhe parashikimin financiar është shumë i vakët. Thënë kjo, janë bashkëlidhur shkresat përcjellëse por jo buxheti apo pasqyrat financiare. Informacione të përgjithshme mbi zërat e buxhetit janë pasqyruar vetëm në raportin vjetor të KU “LOGOS”.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 50-50.4. Projektbuxheti afatmesëm]; [Tabelat 1-24. Tabela 18]; [Aneksi 18. Raporti Vjetor KU “LOGOS” 2022-2023].
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në zbatim të politikës së transparencës së përdorimit të burimeve financiare, KU “LOGOS” deklaroi gjatë takimeve të zhvilluara në institucion se ka ngritur një strukturë të posaçme dedikuar auditimit. Kjo strukturë është përgjegjëse për kontrollin dhe auditimin e brendshëm të kolegjit. Përveç auditimit të brendshëm, KU “LOGOS” në zbatim edhe të akteve nënligjore në fuqi, realizon një auditim të jashtëm të pavarur si edhe bën të mundur kontrollin e pasqyra financiare, shprehet KU “LOGOS” në RVB. <i>Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se në strukturat e KU “LOGOS” nuk rezulton një zyrë auditimi dhe se në dokumentacionin e ngarkuar në sistem nuk ka një raport auditimi, qoftë ky i brendshëm apo i jashtëm. Informacionet financiare janë pasqyruar në raportin vjetor të KU “LOGOS”.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar “LOGOS”]; [Aneksi 50-50.4. Projektbuxheti afatmesëm]; [Tabelat 1-24 tabela 18]; [Aneksi 18 Raporti Vjetor KU “LOGOS” 2022-2023].

Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” bën një raportim të aktivitetit financiar nëpërmjet raportit analitik të institucionit mbi veprimtarinë financiare të KU “LOGOS”. Sikurse konfirmohet edhe nga takimet e zhvilluara në ambientet e KU “LOGOS”, personeli akademik është i përfshirë në këtë procedurë duke forcuar transparencën financiare brenda institucionit. Raportimi mbi aktivitetin financiar është i përvitshëm dhe pasqyrohet me një seksion të veçantë. Dokumentacioni referues: [Tabelat 1-24. Tabela 18]; [Aneksi 18. Raporti Vjetor KU “LOGOS” 2022-2023].
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Gjatë takimeve në mjediset e KU “LOGOS”, GVJ konstatoi se ky kolegji garanton një qëndrueshmëri financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. KU “LOGOS” garanton kapacitete infrastrukturore dhe burime njerëzore të mjaftueshme për realizimin e tij. Gjithashtu, KU “LOGOS” garanton një qëndrueshmëri financiare nëpërmjet fondeve të siguruar nga fondacioni “Logos” i cili e mbështet këtë kolegji në aktivitetin kërkimor shkencor apo akademik apo financime të tjera të domosdoshme. Gjithashtu, kur është e nevojshme KU “LOGOS” bën diversifikim të burimeve njerëzore duke siguruar që programet e studimit të mbetën të financuara vazhdimisht. Gjatë takimeve me personelin akademik, GVJ konstatoi se KU “LOGOS” i garanton atyre mbështetje financiare nëse ato dëshirojnë të kryejnë aktivitete kërkimor shkencorë, të marrin pjesë në konferenca, të sigurojnë fonde të teksteve të nevojshme, edhe pse realisht një praktikë të mirëfilltë nuk ka pasur pasi aktivitetet ose kanë qenë pa pagesë ose kanë qenë të mbuluara nga institucionet pritëse. Dokumentacioni referues: [Aneksi 18. Raporti Vjetor KU “LOGOS” 2022-2023]; [Aneksi 19. Raporti vjetor FSHHKGJ].
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të takimeve në mjediset e KU “LOGOS”, GVJ vëren që ky kriter përmbushet kryesisht:</i> - <i>Kolegji realizon planifikimin financiar të njësisë kryesore, përgjegjëse për ofrimin e programit Master i Shkencave në Përkthim Profesional.</i>

	- Në takimet e zhvilluara në KU "LOGOS", përfaqësuesit deklaruan se ky identifikim fillimisht realizohet nga personeli akademik i cili ia përcjell kërkesat përgjegjësit të njësisë bazë dhe ky i fundit përgjegjësit të njësisë kryesore. Më pas, struktura të tjera të përfshira në miratimin e projekt buxhetit mbështetur në nevojat infrastrukturore, akademike apo kërkimore shkencore janë administrator, senati akademik dhe bordi i administrimit. Megjithatë, edhe pse në RVB deklarohet se KU "LOGOS" ka një strukturë të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si edhe harton pasqyra financiare të cilat reflektojnë gjendjen financiare të institucionit dhe qëndrueshmërinë e tij, - GVJ konsistoi se një raport auditimi në dokumentacionin e ngarkuar në sistem mungon. Janë ngarkuar vetëm shkresat përcjellëse dhe raporti vjetor i KU "LOGOS" por jo një raport auditimi. Sugjerohet: - Paraqitje në të ardhmen e një raporti auditimi të përpiluar me të gjitha zërat sqarues e transparent.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve	GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat e miratuara për çdo program studimi lidhur me pranimin e studentëve e deri në përfundim të studimeve, janë të përcaktuara në statutin e KU "LOGOS", ku specifikohen edhe kriteret e pranimin, mbështetur

nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	në numrin e kuotave të miratuara për çdo program studimi sipas akteve ligjore në fuqi. Koordinimi i procedurave të pranimit bëhet nga Zyra e Çështjeve Studentore, ndërsa vendimet për kriteret e pranimit merren nga Senati mbështetur në rekomandimet e njësive bazë. Gjithashtu, këto procedura janë të rregulluara dhe të parashikuara jo vetëm në statutin e KU "LOGOS" por edhe në rregullore specifike të njësive kryesore, njësive bazë dhe programit të studimit. Për më tepër, KU "LOGOS" mban komunikim me struktura të tilla si MAS, QSHA dhe RASH për çdo përmbushje të procedurës. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar "LOGOS"]; [Aneksi 8. Rregullore e përgjithshme e Kolegjit Universitar "LOGOS" Aneksi 5 Rregullore e programit Msc. Në Përkthim Profesional]; [Aneksi 51. Kriteret e pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023].
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se të gjithë studentët të cilët duan të studiojnë në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, trajtohen në mënyrë të barabartë, informohen mbi politikat e Kolegjit, të drejtat dhe detyrimet e tyre si student. Për ata studentë të cilët nuk kanë mundësi të paraqiten fizikisht në ambientet e KU "LOGOS", mund të informohen mbi kriteret e pranimit apo specifika të tjera të programit të studimit, në faqen zyrtare të internetit. Të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë nga personeli akademik dhe ai administrativ në KU "LOGOS", gjë e cila është e pasqyruar edhe në rregulloren e institucionit. Dokumentacioni referues: [www.kulogos.edu.al]; [Aneksi 8 Rregullore e përgjithshme e Kolegjit Universitar "LOGOS"]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me	GVJ konstatoi se kriteret e pranimit për studentët të cilët duan të studiojnë në programin Master i Shkencave në Përkthim Profesional, bëhet publik në faqen zyrtare të KU "LOGOS". Përpara publikimit, KU "LOGOS" ndjek të gjitha procedurat ligjore në fuqi të tilla si, propozimi nga njësia bazë, miratimi i tyre në Senatin Akademik dhe më pas miratimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Procedura dhe kriteret janë gjithashtu të qartësuara në



strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	statutin e KU “LOGOS”. Zyra përgjegjëse për koordinimin e punës në këtë aspekt me strukturat e tjera në institucion është ajo e Çështjeve Studentore. Dokumentacioni referues: [www.kulogos.edu.al]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës për Çështjet Studentore]; [Aneksi 51. Kriteret e pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023].
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstatoi se të gjithë studentët që ndjekin studimet në programin Master i Shkencave në Përkthim Profesional kanë të drejtë të transferohen. Fillimisht ata njihen me procedurën dhe kushtet e transferimit si edhe afatet. Studentët mund të transferohen vetëm përpara fillimit të vitit të ri akademik. Kriteret e pranimit nga ana tjetër janë publike, në faqen zyrtare të institucionit. Ato propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga rektori. Publikimi i tyre në faqen zyrtare bëhet vetëm pas miratimit nga Rektori. Fletëpalosjet, broshurat informuese, ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës janë disa forma të tjera të shpërndarjes së informacionit lidhur me kriteret e pranimit në këtë program studimi. Dokumentacioni referues: [www.kulogos.edu.al]; [Aneksi 53. Aktivitete të realizuara]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit Përkthim profesional].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ndjek procedura të rregullta dhe të përvitshme mbi informimin lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Një mënyrë informimi është publikimi i kriterëve dhe procedurës në faqen zyrtare të internetit, nëpërmjet broshurave apo fletëpalosjeve si edhe gjatë ditëve të informimit dhe këshillimit të karrierës. Për më tepër, nëse studentët drejtohen në institucion, ato mund të marrin informacionin e nevojshëm, qartë dhe në detaje. Media sociale si facebook dhe instagram luajnë një rol po aq të rëndësishëm në distribuimin e informacioneve lidhur me kriteret e pranimit në programin Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Dokumentacioni referues:

	[www.kulogos.edu.al] ; [Aneksi 53.1. Informimi përmes mediave]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit Përkthim profesional].
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" ndjek një procedurë të veçantë dedikuar përzgjedhjes dhe regjistrimit të studentëve me aftësi ndryshe dhe asaj kategorie që vjen nga shtresat në nevojë. Personeli akademik dhe administrativ është i gatshëm të ndihmojë këdo student për të dhënë ndihmën dhe kujdesin e nevojshëm për këtë kategori të studentëve. Gjithashtu KU "LOGOS" parashikon kuota të veçanta për këtë kategori studentësh. Fondacioni "Logos" duke qenë donatori kryesor i gjenerimit të të ardhurave financiare, ofron gjithashtu mbështetje për këtë kategori të studentëve. Ndihma ofrohet edhe në plotësimin e dosjes, formularit, kontratës, duke i lexuar dokumentet me zë të lartë, duke i sqaruar çdo paqartësi si edhe duke i dhënë detaje të cilat nuk janë publikuar. Evidentohet: - <i>Lidhur me draft udhëzuesin për AK (dok shtesë pika 10), nuk jepen informacione nëse KU "LOGOS" i disponon sistemet alternative që siç deklarohet në draft-udhëzuesin për AK (dok shtesë pika 10), do të përdoren për studentët me aftësi ndryshe.</i> - <i>Nuk ka informacione nga KU "LOGOS" nëse janë kryer trajnimet e përmendura lidhur me softuerin si thuhet në draft udhëzuesin për AK (dok. shtesë pika 10), gjatë gjithë semestrit, të leximit dhe shkrimit Gold, Inspiration, Mind Genius dhe Dragon.</i> - <i><u>Draft udhëzues-i për AK, nuk ka një format institucional dhe të saktësuar.</u></i> Sugjerohet: - <i>Hartimi, përpilimi dhe institucionalizmi i këtij udhëzuesi</i> - <i>Realizimin e trajnimeve të parashikuara në të</i> - <i>Informacion i dokumentuar lidhur me përdorimin e softwaret të përmendur në të.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 10. Shtesë Shërbimet Mbështetëse për Studentët me Aftësi të Kufizuar];

	[Aneksi 53.1. Informimi përmes mediave]; [Aneksi 51. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj].
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstatoi se institucioni shpall kriteret specifike të pranimit në programin e studimit, studentët nga shtetet e tjera shqipfolëse, të cilët zotërojnë të paktën diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Kriter pranimi është njohja nga kandidati i gjuhës angleze dhe shqipe, kjo pasi literatura që përdoret në mësim është në gjuhën angleze dhe shqipe. <i>Por ajo që GVJ evidenton është fakti që plani mësimor ka në numër shumë të madh lëndësh që zhvillohen në gjuhën greke duke mundësuar formimin në përkthim nga gjuha greke në atë shqipe. Ndaj saktësimi i gjuhëve të programit është domosdoshmëri. Gjuha e huaj me zgjedhje që deklarohet tek Aneksi 4 Te dhëna e Programit, nuk gjendet në Planin mësimor pasi ky plan nuk parashikon lëndë me zgjedhje dhe nuk parashikon një gjuhë tjetër të huaj me zgjedhje.</i> Të gjitha lëndët e këtij programi janë të detyrueshme. Detajet mbi kriteret e pranimit dhe kuotat e përditësuara për këtë kategori të studentëve janë gjithashtu të disponueshme në faqen zyrtare të internetit të kolegjit. Njësia bazë ngre një komision <i>ad hoc</i> i cili është përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve dhe garantimin e transparencës dhe barazisë mes studentëve, <i>por GVJ specifikon që këto kritere pranimi duhet të qartësohen dhe të jenë të njëjta në çdo dokument të deklaruar pasi ka mospërputhje (shih konkluzione Standardi II.1, 3)</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 55. Renditja e studentëve fitues për vitet akademike 2023-2024]; [Aneksi 56. Kuotat dhe kriteret e pranimit 2023-2024]; [Aneksi 51. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj]; [www.kulogos.edu.al]
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ pas takimeve të zhvilluara në KU “LOGOS” konstatoi se kolegji ofron mundësi të pajisjes së studentëve me bursa apo reduktim të tarifave. Detajet e përfitimit, kategoritë dhe masat e përfitimit parashikohen në akte të posaçme si edhe në dokumentet e institucionit. Llojet e bursave që ofrohen janë lidhur me ekselencën, bursa sociale dhe bursa të ofruar nga partnerët. Dokumentacioni referues: draft

	[Aneksi 20. Miratimi i programit të bursave]; [Aneksi 56. Kuotat dhe kriteret e pranimi 2023-2024]; [Dok shtesë. Pika 9. Bursat].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit vëren:</i> <i>Evidentohet:</i> - <i>Politikat dhe procedurat për pranimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional janë të përcaktuara qartë në aktet e brendshme dhe gjithashtu janë publike, në faqen zyrtare të internetit, por ato bëhen publike edhe në mënyra të tjera, si broshurat dhe fletëpalosjet, të cilat shërbejnë si mjete për shpërndarjen e informacionit.</i> - <i>Kriteret për pranimet në këtë program studimi përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga rektori dhe bordi i administrimit. Lidhur me problematikat e pangjashmërive (shih Konkluzionet Standardin II, 1.3).</i> - <i>Zyra e Çështjeve Studentore koordinon proceset e pranimi. GVJ konstatoi gjithashtu se studentët që aplikojnë për programin e Masterit në Shkenca të Përkthimit Profesional trajtohen në mënyrë të barabartë dhe janë të informuar për politikat e KU "LOGOS", si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre.</i> - <i>Studentët që nuk kanë mundësi të paraqiten fizikisht në institucion mund të informohen për kriteret e pranimi dhe detaje të tjera përmes faqes zyrtare të internetit të KU "LOGOS". Trajtimi i barabartë i studentëve evidentohet edhe në rregulloren e institucionit.</i> - <i>KU "LOGOS" ndjek procedura të rregullta ligjore mbi transferimin, mbështetjen e studentëve me aftësi ndryshe, studentët e diasporës duke siguruar kuota të veçanta dhe gjithashtu ofron mundësi për bursë dhe reduktim të tarifave për studentët e këtij program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Pas vizitave në KU “LOGOS” dhe shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ofron një informacion të qartë mbi procedurat e përparimit në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik përcaktohen përpara fillimit të vitit akademik. Studentët duhet të ndjekin këtë program studimi përgjatë dy viteve akademike dhe për tu diplomuar duhet të kenë 120 kredite. Studenti ka të drejtë të kalojë në vitin e dytë, vetëm kur ai ka fituar të paktën 30 ETCS në vitin e parë. Mënyra e ndjekjes së këtij program studimi është me kohë të plotë dhe orët mësimore janë me frekuentim të detyrueshëm. Vlerësimi përfundimtar është i shpërndarë mes detyrave, projekteve, provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare si dhe seminareve. Vlerësimi ka një shkallë prej 5 nota më e ulët dhe 10 nota maksimale. Nga nota 5 në notën 10 vlerësimi është kalues dhe nën notën 5 është jo kalues. Nëse studenti nuk plotëson detyrimet akademike të përcaktuara në programin e lëndës, ai nuk pranohet në provim. Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullorja e KU “LOGOS”]; [Aneksi 5. Rregullorja e Programit të Studimit]; [Aneksi 4. Të dhënat mbi programin e studimit].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” në politikat e brendshme lejon transferimin e studentëve të tij dhe pranon transferime të studentëve nga universitete të tjera. Studentët kanë të drejtë të transferojnë studimet e tyre përmes sistemit të krediteve ECTS përpara fillimit të vitit akademik. Rregullorja e Transferimeve të Kolegjit Universitar Logos përcakton udhëzime të detajuara mbi procedurat dhe kriteret që duhet të ndiqen për të realizuar transferimin, qoftë për studentët e KU “LOGOS” që duan të transferohen në një universitet tjetër apo për student të cilët kërkojnë të transferohen në KU “LOGOS”. Megjithatë, vlen të theksohet fakti se duke qenë një program relativisht shumë i ri dhe ende nuk ka pasur një procedurë të mirëfilltë të transferimit të studentëve në këtë program studimi ose nga ky program studimi.

	Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme]; [Aneksi 5. Rregullore Programi]; [Aneksi 26. Rregullore e Transferimeve].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” zbaton një politikë transparente lidhur me informimin e studentëve mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Informimi i studentëve realizohet në fillim të vitit akademik, kryesisht në orën e parë të leksionit ku personeli akademik bën jo vetëm prezantimin e lëndës por edhe të syllabusit duke i njohur studentët me mënyrën sesi do të vlerësohen, si do të bëhet shpërndarja e vlerësimit, sa është detyrimi i frekuentimit. Përveç personelit akademik, struktura të tjera si koordinatorët akademikë apo sekretaria mësimore u vijnë në ndihmë studentëve në këtë aspekt. Microsoft Teams dhe EDUPAGE janë të disponueshme në çdo moment për studentët ku ato mund të gjejnë informacionet që kërkojnë lehtësisht, pasi në këto platforma është ngarkuar edhe syllabusi i secilës lëndë. Dokumentacioni referues: [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html]; [https://www.office.com/] ; [https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës për Çështjet Studentore]; [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” zbaton të drejtën e informimit për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomimin e tyre. Studentët dhe personeli i KU “LOGOS” konfirmuan gjatë vizitave në institucion se organizohen takime informuese në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës. Ky informacion është gjithashtu i publikuar në klasat virtuale dhe në teams. I lind e drejta për tu diplomuar të gjithë studentëve të këtij program studimi që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare. Studentët diplomohen në vitin e dytë dhe mbrojnë një temë diplome. Studentët zgjedhin udhëheqësin dhe më pas së bashku përcaktojnë temën e diplomës, edhe pse një temë e përgjithshme është përcaktuar paraprakisht nga studenti. Detaje mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit gjenden në rregulloren e departamentit dhe udhëzimin për përgatitjen e temës së diplomës.

	Dokumentacioni referues: [Aneksi 12.1. Rregullorja e Departamentit]; [Aneksi 38. Udhëzim për Përgatitjen dhe Mbrojtjen e Temës së Diplomës]; [Aneksi 5. Rregullore e Programit të Studimit] [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html]; [https://www.office.com/].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” organizon përpara fillimit të vitit akademik takime informuese me të interesuarit për tu regjistruar në këtë program studimi. Konkretisht realizohen fushata informuese të paktën 6 muaj përpara fillimit të vitit akademik. Për të realizuar këto fushata ngrihen grupe pune specifike. Përveç fushatave të informimit, KU “LOGOS” përdor edhe mjete të tjera komunikimi për informimin mbi këtë program studimi. Këto mjete janë, faqja zyrtare e internetit, fletëpalosje, broshura informuese, si dhe organizimin e ditëve të hapura dhe ditëve të karrierës, vizita informuese ku prezantohet oferta akademike, programet e studimit, kriteret e pranimit, infrastruktura, personeli akademik, dhe mundësitë e punësimit. Dokumentacioni referues: [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html] [Aneksi 53.2. Mjetet e Komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm të komunikimit]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës për Çështjet Studentore].
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit vëren që ky standard përmbushet plotësisht kjo pasi KU “LOGOS” ofron informacion të qartë dhe të aksesueshëm mbi kriteret dhe procedurat e pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, të cilat janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të internetit. Studentët e ndjekin këtë program për një periudhë dyvjeçare, dhe përfitojnë një total prej 120 kreditesh në përfundim të studimeve, dhe të paktën 30 kredite në vitin e parë. Ndjekja e mësimi është me kohë të plotë, dhe frekuentimi është i detyrueshëm. KU “LOGOS” ka politika të brendshme që lejojnë transferimin e studentëve nga institucione të tjera në KU “LOGOS” ose anasjelltas, duke u ofruar mundësi për t’u integruar në sistemin e krediteve ECTS. Gjithashtu, KU “LOGOS” siguron informacion të detajuar për studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit si</i>

	edhe organizon takime informuese për studentët për tu njohur me programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ pas vizitave në KU “LOGOS” konstatoi se ky institucion ndjek politika të qarta për informimin e studentëve lidhur me programin e studimi Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Konkretisht, me studentët e vitit të parë organizohet aktiviteti “Njihi me Kolegjin Universitar ‘LOGOS’”, në fillim të vitit akademik. Gjatë këtij aktiviteti ku janë të ftuar drejtues, akademikë dhe përfaqësues të administratës, studentët informohen mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ato njihen gjithashtu për mundësinë e organizimit në këshilla studentorë, nëpërmjet të cilëve mund të adresojnë problematika të ndryshme të studentëve. Mënyra të tjera të shpërndarjes së informacionit janë edhe faqja zyrtare e internetit, platforma EDUPAGE dhe Microsoft TEAMS si edhe prezantimi i syllabusit që bëhet në fillim të vitit akademik nga personeli akademik për çdo lëndë. Një mënyrë tjetër është vendosja e posterave të afishuara brenda institucionit ose informacioni që mund të merret drejtpërdrejtë në sekretarinë mësimore. Dokumentacioni referues: [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar “LOGOS”]; [Aneksi 52 dhe 52.1. Mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm]; [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	GVJ konstaton se KU “LOGOS” i njeh studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, në fillim të vitit akademik me informacion të nevojshëm mbi syllabuset, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Kjo gjë realizohet në aktivitetin “Njihi me Kolegjin Universitar

përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	“LOGOS”. Jo vetëm në fillim të vitit akademik, por përgjatë gjithë studimeve ata informohen nga përgjegjësi i departamentit, sekretaria mësimore, personeli akademik ose edhe nëpërmjet platformave Edupage dhe Microsoft Teams, të cilat mund ti aksesojnë online. Dokumentacioni referues: [Aneksi 52 dhe 52.1 Mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm]; [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstatoi gjatë vizitave në institucion se Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me personelin akademik dhe institucionet e tjera me të cilat KU “LOGOS” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim përmirësimin e performancës akademike të studentëve dhe aftësimin e tyre në tregun e punës. Kjo zyrë informon studentët për mundësitë e punësimit si edhe organizon aktivitete në formën e leksioneve të hapura për shkrimin e CV-ve dhe letër-motivimeve, panaiere të punës Work & Study, leksione të hapura me kompani që ofrojnë mundësi rekrutimi dhe internship, etj. Gjithashtu gjatë takimeve GVJ u informua se kjo zyrë organizon edhe leksione të hapura me Alumnin, duke promovuar ish – studentët e universitetit, me qëllim motivimin e studentëve aktualë. Marrë në konsideratë praktikën e departamentit, Alumni shpeshherë përfshihet në aktivitetet e KU “LOGOS” duke kontribuar në mënyra të ndryshme si transmetimi i ideve, prezantimi i nismave, rekomandime për përmirësim, etj, por për këtë program studimi ende nuk ka studentë të diplomuar ose Alumni. Gjithashtu, informacioni bëhet publik përmes faqes zyrtare të Kolegjit, platformës EDUPAGE, Microsoft TEAMS, duke u informuar kështu jo vetëm personat e interesuar por edhe studentët të cilët nuk mundën të ishin prezent. Dokumentacioni referues: [Aneksi 52 dhe 52.1. Mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm]; [Aneksi 65. Formular vlerësimi nga punëdhënësi]; [Aneksi 53. Aktivitete me studentët]; [http://www.kulogos.edu.al/al/index.html].

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

GVJ konstatoi se studentët e programit Master i Shkencave në Përkthim Profesional informohen vazhdimisht për zhvillimin e procesit mësimor. Orari është i afishuar në ambiente të institucionit, kryesisht pranë sekretarisë mësimore por ai është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KU “LOGOS” dhe në platformat Microsoft TEAMS dhe Edupage. Nëpërmjet këtyre platformave, personeli akademik mban komunikimin me studentët, japin detyra, japin informacione mbi syllabusin, literaturën shtesë ose materiale ekstra dhe mënyrën e vlerësimit. Klasat virtuale e bëjnë më të lehtë komunikimin e lektorit me studentin. Për zhvillimin e procesit mësimor gjithashtu studentëve u vihet në dispozicion salla e leksioneve, seminareve, laboratorëve, bibliotekës, në varësi të lëndës dhe nevojave. Gjithashtu kushtet në të cilat zhvillohet mësimi janë optimale.

Dokumente referuese:

[\[http://www.kulogos.edu.al/al/index.html\];](http://www.kulogos.edu.al/al/index.html)

[\[https://www.office.com/\];](https://www.office.com/)

[\[https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26\];](https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26)

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ofron për studentët e programit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, një sistem të brendshëm të informacionit nëpërmjet të cilit studentët mund të marrin informacion për çdo gjë lidhur me programin e studimit ose KU “LOGOS” në përgjithësi, në çdo kohë dhe nga çdo distancë. Kështu, Microsoft TEAMS dhe Edupage janë dy platforma të cilat studentët i përdorin për marrjen e informacioneve si, vlerësime, orare, syllabus, njoftime, kurrikula, etj. Këto platforma mund të përdoren nga studentët, personeli akademik dhe administrativ dhe janë të aksesueshme në çdo kohë. Në rast të ndonjë mos funksionimi të këtyre platformave, studentët për çdo informacion mund të drejtohen në sekretarinë mësimore ose personelin akademik, përfshirë edhe koordinatoren ose përgjegjësën e departamentit. Mbështetur në vizitat me studentët, rezultoi se strukturat e KU “LOGOS” janë të gatshme të ndihmojnë studentët në çdo mënyrë në varësi të problematikave që kanë.

Dokumentacioni referues:

[\[https://www.office.com/\];](https://www.office.com/)

[\[https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26\].](https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26)

Konkluzione	GVJ pas vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit vëren që ky standard përmbushet plotësisht pasi KU "LOGOS" vë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Ky informacion lidhet me objektivat formuese të lëndëve, syllabuset, mundësitë e punësimit dhe orientimit në tregun e punës. Informacioni shpërndahet nëpërmjet disa kanaleve, përfshirë faqen zyrtare të internetit, platformën EDUPAGE dhe Microsoft TEAMS. Gjithashtu, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me personelin akademik dhe institucionet e tjera për të përmirësuar performancën akademike dhe aftësimin e studentëve në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ pas vizitave në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatoi se KU "LOGOS" mban dhe përpunon të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Megjithatë edhe pse procedura është e parashikuar, të dhëna mbi diplomimin nuk ka ende pasi ky program është ofruar vetëm për dy vite akademike dhe ende nuk ka pasur student të diplomuar. Të dhënat e studentëve ruhen në regjistra dhe në format elektronik në zyrën e sekretarisë mësimore. Dokumentacioni referues: [Aneksi 55. Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2022-2024]; [Aneksi 38. Rregulla për diplomimin]; [Aneksi 40. Regjistër Themeltar]; [Aneksi 40.1. Regjistër i arritjeve akademike].

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konstatoi se sekretaria mësimore mban listat me të dhënat e studentëve të regjistruar për herë të parë në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Gjithashtu, sekretaria mësimore mban të dhëna të tjera statistikore si transferimet, tërheqjet nga program, largimet, pezullimet. Sekretaria mësimore administron regjistrat e posaçëm për secilin veprim, të dhënat përditësohen dhe përpunohen sipas procedurave institucionale dhe raportimeve të ndryshme kur kërkohet. Këto statistika i komunikohen edhe Departamentit përgjegjës për këtë program studimi për nevojat e vetëvlerësimit për raportin vjetor dhe planin strategjik. Dokumentacioni referues: [Aneksi 26. Rregullore e transferimeve]; [Aneksi 18. Raportet vjetore 2022 -2023].
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve të regjistruar në programin Master i Shkencave në Përkthim Profesional menaxhohen nëpërmjet platformës EDU PAGE LOGOS. Kjo platformë garanton mbrojtjen e informacionit, sigurimin e privatësisë dhe verifikueshmërinë e tyre lehtësisht. Kryesisht këto të dhëna administrohen nga sekretaria mësimore por edhe struktura të tjera në KU “LOGOS” mund ti përdorin kur është e nevojshme, kryesisht për hartimin e raporteve ose monitorimin e performancës akademike të studentëve. Gjithashtu këto të dhëna menaxhohen edhe në formatin hard copy nga sekretaria mësimore nëpërmjet regjistrave respektivë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 52 dhe 52.1 Mjetet e brendshme dhe të jashtme të komunikimit]; [https://www.office.com/]; [https://elearn.pi.ac.cy/moodle/course/view.php?id=26].
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe	GVJ konstatoi se mbështetur në aktet e brendshme KU “LOGOS” garanton kontrollin periodik të njësive bazë e cila ofron programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. KU “LOGOS” e ka realizuar kontrollin nëpërmjet Komisionit të DGJCG-së. Komisioni vlerëson gjendjen dhe saktësinë e dokumentacionit të ruajtur duke verifikuar edhe standardet ligjore. Gjithashtu është verifikuar saktësia e të dhënave të regjistrimeve, përditësimeve akademike, dhe dokumentacionit të lidhur me



dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	veprimtaritë e studentëve, duke përfshirë rezultatet e provimeve, kalimet e vitit akademik, dhe informacione të tjera. Dokumentacioni referues: [Aneksi 19. Raport Vjetor për Veprimtarinë e KU “LOGOS” 2022-2023]; [Aneksi 18. Raporti vjetor KU “LOGOS”]; [Aneksi 55. Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2022-2024]; [Aneksi 40 dhe 40.1 Regjistër Themeltar dhe Regjistër i arritjeve akademike].
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” harton raporte të cilat ofrojnë informacione mbi studentët e regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, që nga momenti që ato kanë filluar studimet e deri në përfundim, të dhëna që lidhen me performancën e tyre akademike apo edhe punësimin. Këto raporte mbajnë informacione më shumë për programet e tjera të studimit pasi program MSH në përkthim profesional është miratuar së fundmi dhe ka vetëm dy vite që ofron shërbim prandaj edhe alumni apo të dhëna të diplomimit apo punësimit mungojnë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 19. Raport Vjetor për Veprimtarinë e KU “LOGOS” 2022-2023]; [Aneksi 18. Raport vjetor KU “LOGOS”]; [Aneksi 55. Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2022-2024]; [Aneksi 40 dhe 40.1. Regjistër Themeltar dhe Regjistër i arritjeve akademike].
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit vëren që ky standard përmbushet plotësisht pasi KU “LOGOS” përpunon të dhëna statistikore të studentëve që nga momenti i regjistrimit të tyre deri në përfundim të studimeve. Të dhënat ruhen në format hard copy dhe në format elektronik. Aktualisht, duke qenë se ende nuk ka student të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, nuk ka të dhëna të diplomimit. Sekretaria mësimore administron listën e studentëve të regjistruar për herë të parë në program si edhe mban të dhëna të tjera si transferimet, largimet, pezullimet. Të dhënat statistikore menaxhohen përmes platformës EDU Page Logos, e cila garanton mbrojtjen e</i>




	informacionit dhe ruajtjen e privatësisë së tyre. KU "LOGOS" harton raporte që ofrojnë informacione mbi studentët e regjistruar në program nga fillimi deri në përfundim të studimeve, përfshirë performancën akademike dhe informacione të tjera. Informacioni i menaxhuar dhe raportet e përgatitura ofrojnë qëndrueshmëri për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se studentët organizohen dhe përfaqësohen në organe vendimmarrëse apo këshilluese. Studentët kanë përfaqësues në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë si dhe janë të organizuar në Këshillin Studentor. Kjo e drejtë është e përcaktuar edhe në rregulloren e Kolegjit Universitar Logos. Nga vizita me studentët rezultoi gjithashtu se këshilli studentor është i rregulluar me dokumente specifike të tilla si statuti i këshillit studentor, rregullore e këshillit studentor. Ata janë të njohur me të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe ndjehen të përfaqësuar në procesin e vendimmarrjes. Dokumentacioni referues: [Aneksi 61. Përbërja e Senatit Akademik]; [Aneksi 59. Statuti i Këshillit Studentor]; [Aneksi 58. Rregullore e Këshillit Studentor]; [Aneksi 58.1. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale,	GVJ konstatoi se përfshirja e studentëve është e garantuar dhe realizohet nëpërmjet akteve të brendshme të institucionit. Ata janë aktiv gjithashtu në vetëvlerësimin e brendshëm të institucionit duke ndihmuar në garantimin e sigurimit të cilësisë. Ata janë aktiv në pjesëmarrjen në pyetësorët për sigurimin e cilësisë së procesit mësimor dhe institucionit në tërësi. Kjo gjë u vërtetua gjatë takimeve në KU "LOGOS" jo vetëm nga personeli akademik,

konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore por edhe nga vetë studentët. Pjesë në takim ishte edhe përfaqësuesja e këshillit studentor. Dokumentacioni referues: [Aneksi 59. Statuti i Këshillit Studentor]; [Aneksi 58. Rregullore e Këshillit Studentor]; [Aneksi 58.1. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstatoi se numri i vogël i studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, është një avantazh për të garantuar një komunikim sa më efektiv dhe të vazhdueshëm me studentët. Gjatë takimeve në KU “LOGOS”, rezultoi se departamenti që ofron këtë program studimi angazhon dhe përfshin studentët në vlerësimin e proceseve akademike duke ndihmuar kështu në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe përmirësimin më tej të këtij programi. Studentët janë aktiv në dhënien e mendimit për përmirësimin e programit, siç ishte rasti i shtimit të orëve të praktikës dhe garantimi i një laboratorit specifik përkthimi ku ata mund të ushtrohen dhe praktikohen mjaftueshëm përpara se të përballen me tregun e punës. Gjithashtu, studentët shprehën se ata ftohen herë pas herë të marrin pjesë në takimet e hapura të departamentit ku mund të shprehin mendimin e tyre për çdo pakënaqësi ose ndryshim që e konsiderojnë të nevojshëm. Dokumentacioni referues: [Aneksi 59. Statuti i Këshillit Studentor]; [Aneksi 58. Rregullore e Këshillit Studentor]; [Aneksi 58.1. Organizimi i zgjedhjeve të Këshillit Studentor].
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ konstatoi edhe nga vizitat në KU “LOGOS” se studentët njihen me rezultatet e provimeve nga personeli akademik përgjegjës për lëndën përpara se ky vlerësim të vendoset në procesverbal nga sekretaria mësimore. Ata kanë të drejtë të rishikojnë provimin apo të kërkojnë rivlerësim nëse nuk janë të kënaqur me vlerësimin ose pretendojnë se meritojnë më shumë. Nëse edhe pas vlerësimit të dytë nga ana e personelit akademik studenti nuk është dakord me vlerësimin, ai ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim pranë sekretarisë mësimore e cila ia dërgon dekanit për trajtim dhe ky i fundit ngre një komision i cili bën rivlerësimin e provimit. Edhe pse studentët ishin të njohur me

	procedurën, nuk ka një praktikë të tillë pasi gjatë këtyre dy viteve nuk ka pasur student të cilët kanë pasur pakënaqësi për vlerësimin. Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e Përgjithshme KU “LOGOS”]; [Aneksi 5. Rregullore Programit Master i Shkencave në Përkthim Profesional].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë dhe vizitave institucionale vëren që standardi përmbushet plotësisht kjo pasi Studentët në Kolegjin Universitar Logos janë të organizuar dhe përfaqësohen në organe vendimmarrëse si Këshilli Studentor. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë përcaktuar në rregulloren e institucionit dhe atë të këshillit studentor. Studentët njihen me dokumentet specifike si Statuti dhe rregullorja e Këshillit Studentor, duke u ndjerë të përfaqësuar në këtë strukturë. Studentët kontribuojnë aktivisht në vlerësimin e brendshëm të KU “LOGOS” dhe ndihmojnë në garantimin e cilësisë, duke marrë pjesë në anketat për vlerësimin e procesit mësimor dhe atë institucional. GVJ konstatoi se studentët informohen në lidhje me rezultatet e provimeve nga personeli akademik përpara se këto të regjistrohen në procesverbalin e sekretarisë mësimore. Studentët kanë të drejta për rishikimin e provimeve dhe për të kërkuar rivlerësim në rast se nuk janë të kënaqur me vlerësimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” zhvillon procedura konkrete dhe të qarta mbi informimin e studentëve, procedura këto të cilat rregullohen me akte të brendshme dhe që shkojnë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen mbi programin e studimit, procedurat e regjistrimit, organizimin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, transferimet apo pezullimet, kohëzgjatjen e studimit dhe tarifat apo për çdo informacion tjetër

	që studentët mund të kërkojnë. Këto informacione ofrohen për studentët nëpërmjet sekretarisë mësimore, përgjegjësit të departamentit apo dekanit si edhe janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit. Në ndihmë në këtë drejtim vjen edhe koordinatori për marrëdhëniet me studentët. Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e përgjithshme e KU “LOGOS”]; [Aneksi 15. Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore]; [Aneksi 23. Vendim për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit]; [Aneksi 52 dhe 52.1. Mjetet e Komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm].
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ka ngritur një sistem informimi me në qendër studentin. Konkretisht, mbështetur në vizitat në KU “LOGOS” rezultoi se Zyra e Çështjeve Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës organizojnë aktivitete të cilat i vijnë në ndihmë përmirësimit të performancës akademike por edhe përfshirjes së tyre në tregun e punës më vonë. Gjithashtu, krahas takimeve në KU “LOGOS” studentët mund të informohen edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit ose platformave Microsoft Office dhe EduPage, pa qenë nevoja të shkëputen nga aktivitetet e tyre të përditshme. Dokumentacioni referues: [Aneksi 57. Rregullore e tutoratit]; [Aneksi 53. Dhe 53.1 Aktivitete]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore].
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	GVJ konstatoi se në KU “LOGOS” janë ngritur zyra e Këshillimit të Karrierës dhe zyra e Çështjeve Studentore të cilat ofrojnë mbështetje për studentët duke organizuar aktivitete në funksion të zhvillimit të tyre akademik ose për të sqaruar çdo paqartësi që studentët mund të kenë. Për të garantuar një praktikë profesionale sa më efektive, zyra e Këshillimit të Karrierës zgjedh mes marrëveshjeve të bashkëpunimit mes KU “LOGOS” dhe institucioneve të tjera për ti ofruar studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional një qasje sa më profesionale ndaj praktikës. Gjithashtu, zyra e këshillimit të karrierës bën edhe orientimin e studentëve drejt tregut të punës,

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	duke i këshilluar ata mbi mundësitë e punësimit, institucionet ku mund të punësohen, kërkesat e tregut të punës. Kjo gjë realizohet nëpërmjet takimeve që mund të ketë çdo student me përfaqësuesin e zyrës ose nëpërmjet trajnimeve ose orëve të hapura në KU "LOGOS". Dokumentacioni referues: [Aneksi 53 dhe 53.1. Aktivitete]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore]; [Aneksi 17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit].
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës pranë këtij institucioni mban të dhëna mbi studentët e diplomuar lidhur me punësimin e tyre pas diplomimit ose angazhimin profesional që ata mund të kenë. Gjithashtu, kjo zyrë organizon edhe takime ose leksione të hapura me studentët ku të ftuar janë alumni i KU "LOGOS", kjo me qëllim ndarjen e eksperiencave dhe përfitimeve që këta mund të kenë pas diplomimit. Në këtë mënyrë studentët motivohen për vazhdimësinë e studimeve. Të dhënat e grumbulluara në formën e statistikave u vihen në dispozicion organeve drejtuese përkatëse, për zhvillimin e politikave institucionale dhe për arsye promovimi. Për të mbajtur një pasqyrë të saktë mbi punësimin e të diplomuarve, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës gjithashtu disponon të dhëna statistikore të detajuara që pasqyrojnë suksesin e integritet të studentëve në tregun e punës por një gjë e tillë nuk mund të konfirmohet për studentët e diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional pasi ende nuk ka pasur studentë të diplomuar. Dokumentacioni referues: [Aneksi 53 dhe 53.1. Aktivitete]; [Aneksi 15. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore]; [Aneksi 17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]; [Tabela. 1- 24. Tab. 5].



Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit vëren që standardi përmbushet plotësisht pasi KU "LOGOS" ka krijuar një sistem informimi të strukturuar përmes Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, e cila organizon aktivitete për të mbështetur performancën akademike të studentëve dhe për t'i përgatitur ata për tregun e punës. Studentët mund të informohen përmes takimeve, si dhe platformave të tilla si faqet zyrtare të internetit dhe programet si Microsoft Office dhe EduPage, pa u shkëputur nga aktivitetet e tyre të përditshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Gjatë takimeve në KU "LOGOS" përfaqësuesit deklaruan se ky institucion ofron guidë mbi përdorimin e platformës Teams nga studentët dhe personeli akademik. Sipas KU "LOGOS" kryesisht guidat janë standarde të hartuara nga vetë platformat. Nga ana tjetër, KU "LOGOS" deklaroi se janë zhvilluar edhe trajnime mbi përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, këto trajnime kanë fokus përditësimin e njohurive mbi teknologjitë të cilat ndihmojnë në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies. Trajnimi është zhvilluar fizikisht dhe online. Megjithatë, pavarësisht se disa teknikalitete janë përmendur në aktet e brendshme të institucionit GVJ konstatoi se, nuk ka një manual

	<i>të mirëfilltë të hartuar nga vetë institucioni, por thjesht një draft të painstitucionalizuar.</i> Dokumentacioni referues: [Dok. Shtesë. Pika 10. Draft handbook]; [Aneksi 10. Rregullore e Njesisë të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ konstatoi se pranë KU “LOGOS” është ngritur një strukturë specifike për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, harton pyetësorë periodikë për të monitoruar procesin mësimorë. Këto pyetësorë u shpërndahen studentëve dhe rezultatet e tyre u bëhen të ditur personelit akademik. Gjithashtu, gjatë takimeve me përfaqësuesit e njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë u theksua fakti se janë përdorur edhe fokus grupe, përveç pyetësorëve. Këto mekanizma të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies shpërndahen dy herë në vit në përfundim të çdo semestri. <i>Ajo që u vu re ishte fakti se këto fokusgrupe nuk i përkasin programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. GVJ e konsideron këtë praktikë shumë të suksesshme dhe sugjeron të ndërmerren iniciativa të ngjashme edhe për këtë program studimi.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 32. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]; [Aneksi 28. Raporti i NjSBC mbi vlerësimin nga studentët stafin akademik për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II]; [Dok Shtesë. Pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok Shtesë. Pika 7. Platforma e fokusgrupit].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	GVJ konstatoi se studentët bëhen pjesë e procesit të vlerësimit periodik duke marrë pjesë në pyetësorë të cilët vlerësojnë lëndën dhe metodat e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit të dijeve si edhe japin sugjerime sesi mund të përmirësohet procesi i mësimdhënies. Gjithashtu, studentët kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin përfundimtar të provimit nëse konsiderojnë se vlerësimi nuk ishte i kënaqshëm ose ata mund të ankimohen edhe për shkelje të rregullave të provimit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 32. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën];

	[Aneksi 28. Raporti i NjSBC mbi vlerësimin nga studentët stafin akademik për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II]; [Dok. Shtesë. Pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok. Shtesë. Pika 7. Platforma e fokusgrurit].
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se pas plotësimit të pyetësorëve nga studentët, rezultatet e tyre u bëhen me dije personelit akademik nëpërmjet përgjegjësit të departamentit. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë harton një raport ku në mënyrë të detajuar paraqet analizën e gjetjeve, rekomandimet dhe sfidat e hasura. Një përmbledhje e raportit publikohet në faqen zyrtare të KU “LOGOS”. Dokumentacioni referues: [Aneksi 28. Raporti i Vlerësimit të NjSBC për vitin 2023-2024]; [Aneksi 19. Raport vjetor FSHHKGJ]; [http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html].
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstatoi se institucioni përdor mekanizma për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet pyetësorëve dhe fokusgrupeve. Rezultatet e pyetësorëve të cilët fokusohen në vlerësimin e mësimdhënies u bëhen me dije personelit akademik në mënyrë që të merren masat për përmirësimet e nevojshme si edhe nxitjen e praktikave më të mira. Ky proces është periodik dhe zhvillohet dy herë në vit, përpara përfundimit të semestrit. Një gjë e tillë u konfirmua gjatë takimeve të zhvilluara në KU “LOGOS” ku personeli akademik konfirmoi realizimin e pyetësorëve dhe analizimin e tyre në departament për përmirësimin e situatës. Evidentohet: - <i>KU “LOGOS” ndjek një politikë të qartë lidhur me garantimin dhe promovimin e praktikave më të mira si edhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> - <i>Mekanizmat që përdoren për sigurimin e cilësisë janë pyetësorët të cilët plotësohen nga studentët dhe vlerësojnë procesin e mësimdhënies.</i> - <i>Pyetësorët hartohen nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila harton gjithashtu raportin mbi vlerësimet e kryera.</i> - <i>Pasi personeli akademik njihet me vlerësimin zhvillohen takime ku rezultatet analizohen dhe merren masa për përmirësimin e praktikave kur është e nevojshme.</i> Sugjerohet:




	<i>GVJ e konsideron përdorimin e fokusgrupeve si një praktikë shumë të suksesshme dhe sugjeron të ndërmerren iniciativa të ngjashme edhe për këtë program studimi, njësoj siç janë marrë në programet e tjera të ofruara nga KU "LOGOS".</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 28. Raporti i Vlerësimit të NjSBC për vitin 2023-2024]; [Dok Shtesë. Pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok Shtesë. Pika 7. Platforma e fokusgrupit]; [http://www.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave institucionale vëren që standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" harton politika, ka ngritur struktura dhe ndjek procedura ligjore për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto reflektohen në akte të brendshme të institucionit si rregullore, udhëzime apo njësi specifike si ajo e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo e fundit është përgjegjëse për hartimin e mekanizmave të cilat vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies. Pyetësorët dhe fokus grupet janë dy prej mekanizmave që aplikohen. Vlerësimi është periodik dhe realizohet dy herë në vit, përpara përfundimit të semestrit. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët përpunohen dhe analizohen si edhe u bëhen publike personelit akademik me qëllim përmirësimin e procesit dhe reflektimin e rekomandimeve. Gjithashtu, në raportet e institucionit deklarohet edhe aktiviteti kërkimor shkencor i realizuar nga personeli akademik. <i>GVJ konstaton që deklarimi i aktivitetit kërkimor është i pakët, vetëm dy anëtarë të personelit akademik të këtij programi kanë raportuar aktivitetin e tyre kërkimor. Gjithashtu në dokumentacionet e vëna në dispozicion nuk ka një mekanizëm që shërben për mbledhjen e këtij informacioni. GVJ sugjeron</i>

	<i>përdorimin e një mekanizmi ku çdo personel akademik deklaron aktivitetin individual kërkimor shkencor të zhvilluar gjatë vitit akademik që është i angazhuar.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 10. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]; [Aneksi 1. Statuti i Kolegjit Universitar “Logos”]; [Aneksi 18. Raport Vjetor KU “LOGOS” 2022-2023]; [Dok. Shtesë. Pika 2. Vendimi për grupet kërkimore]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstatoi se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë është ngritur dhe funksionon në përputhje me planin strategjik të KU “LOGOS”, në përputhje me rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Studentët janë të përfshirë në këtë proces duke ofruar mendim objektiv ndaj pyetjeve që u drejtohen dhe rekomandojnë përmirësimin e procedurave të caktuara. Mekanizmat për garantimin e cilësisë janë pyetësorët dhe fokusgrupet. Pyetësorët janë periodikë dhe rezultatet e tyre u bëhen me dije personelit akademik për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Studentët janë të përfshirë edhe në procedura të tjera vendimmarrëse, sikurse parashikohet në rregulloren e programit të studimit apo të sigurimit të cilësisë, në statutin e KU “LOGOS”, rregulloren e këshillit studentor. Dokumentacioni referues: [Aneksi 7. Plan Strategjik i zhvillimit institucional 2018-2024]; [Aneksi 15. Rregullore e zyrës studentore]; [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit MSHPP].
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ka ngritur struktura të caktuara për garantimin e cilësisë. Kjo është e parashikuar edhe në aktet e brendshme të institucionit por është e mundur edhe nëpërmjet mekanizmave matës të tillë si pyetësorët dhe fokusgrupet. Pyetësorët vlerësojnë performancën akademike të personelit akademik, gjë e cila bëhet nga studentët. Në të dyja rastet, rezultatet bëhen publike dhe merren masa për përmirësimin e situatës. Lidhur me sigurimin e jashtëm të cilësisë, KU “LOGOS” i nënshtrohet akreditimit të programeve të studimit për t’ju përmbajtur standardeve ligjore dhe metodologjisë bashkëkohore. Dokumentacioni referues:

cilësinë në programin e studimit.	[Aneksi 15. Rregullore e zyrës studentore]; [Aneksi 28. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II]; [Dok. Shtesë. Pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok. Shtesë. Pika 7. Platforma e fokusgrurit].			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" përdor instrumente të ndryshëm matës të cilësisë të tillë si pyetësorë për vlerësimin e lëndës dhe mësimdhënies, raportime dhe analiza të pyetësorëve, publikimi dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ndërsa sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohej përmes akreditimit të programit të studimit. Strukturat e ngritura në KU "LOGOS" bashkëpunojnë me njëra tjetrën për të garantuar një cilësi sa më të lartë të shërbimit akademik. Dokumentacioni referues: [Aneksi 28. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II]; [Dok. Shtesë. Pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok. Shtesë. Pika 7. Platforma e fokusgrurit].			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe mbështetur në vizitat e kryera në institucion deklaroi përmbushjen kryesisht të këtij standardi kjo sepse megjithëse evidentohet që: KU "LOGOS" zbaton politika dhe procedura transparente për sigurimin e brendshëm të cilësisë e ka ngritur strukturat e duhura si edhe zbaton procedurat e nevojshme për mbledhjen e të dhënave, përpunimin, analizimin dhe publikimin e tyre si dhe përdor mekanizma të matjes së cilësisë të tilla si pyetësorë, formularë dhe fokusgrupe. Gjithashtu Sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohej nëpërmjet procesit të akreditimit të programit të studimit, por duke qenë që nuk në dokumentacionet e vëna në dispozicion nuk ka një mekanizëm që shërben për mbledhjen e këtij informacioni, kush është përgjegjës për mbledhjen e tij dhe si raportohet ai. Ndaj dhe GVJ sugjeron përdorimin e një mekanizmi ku çdo personel akademik deklaroi aktivitetin individual kërkimor shkencor të zhvilluar gjatë vitit akademik që është i angazhuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Mbështetur në vizitat e zhvilluara në KU “LOGOS”, GVJ konstatoi se ky institucion përdor mekanizma dhe procese për garantimin e mbikëqyrjes periodike të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë bashkëpunon me përgjegjësin e departamentit për përmirësimin e programit të studimit brenda standardeve të kërkuara dhe më pas propozimet apo ndryshimet miratohen në Senatin Akademik. Gjithashtu KU “LOGOS” përdor mekanizma konkrete për garantimin e cilësisë të tilla si pyetësorë, fokusgrupe. Të dhënat e grumbulluara nga këto mekanizma analizohen, raportohen dhe bëhen publike. Dokumentacioni referues: [Aneksi 10. Rregullore e NJSBC]; [Aneksi 67. Raporti i KPGSC]; [Aneksi 28. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II];
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pas plotësimit të pyetësorëve dhe analizës së tyre, harton një raport vjetor në të cilin pasqyrohen rezultatet e pyetësorëve si edhe matja e performancës. Këtij raporti i bashkëlidhen edhe vlerësimet e marra nga fokusgrupet e realizuara. Gjithashtu, pjesë e këtyre raportimeve janë edhe mënyrat e planifikimit dhe menaxhimit të procesit të vlerësimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 10. Rregullore e NJSBC]; [Aneksi 67. Raporti i KPGSC]; [Aneksi 28. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II];

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës , të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi se metodat e përdorura për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional janë gjithëpërfshirëse dhe në disa nivele. Monitorimi dhe vlerësimi realizohen nëpërmjet sondazheve të studentëve dhe analizës së rezultateve të përfuara prej tyre. KU “LOGOS” organizon testime të standardizuara për të matur njohuritë dhe aftësitë e studentëve. Ndër të tjera, KU “LOGOS” në RVB deklaroi se sigurimi i cilësisë përmbushet edhe nëpërmjet vëzhgimeve në auditor gjatë procesit mësimor. Sipas RVB këto vëzhgime ndihmojnë në identifikimin e elementëve të cilët nuk janë në përputhje me planin dhe në rast nevojë bëhen ndërhyrje të menjëhershme. Gjithashtu, analizohen rezultatet e arritura në testime kombëtare. Dokumentacioni referues: [Aneksi 67. Raporti i KPGSC]; [Aneksi 28. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II];
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ konstatoi se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përdor mekanizma për matjen e cilësisë të tilla si pyetësorë dhe fokusgrupe për studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të cilat shpërndahen në mënyrë periodike te studentët dhe feedback-u i marrë prej tyre analizohet dhe përpunohet në formën e raporteve dhe u vihet në dispozicion strukturave drejtuese dhe personelit akademik. Shpeshherë organizohen edhe mbledhje me qëllim diskutimin e rezultateve të pyetësorëve dhe ndërhyrjen në përmirësimin e situatës, kur është e nevojshme. Këto mbledhje nuk organizohen vetëm me këtë qëllim, por sa herë është e nevojshme diskutimi për ti dhënë zgjidhje problematikave të caktuara ose për ti përmirësuar ato. Organizimi i mbledhjeve u miratua nga personeli akademik gjatë vizitave në institucion. Studentët nuk përfshihen vetëm në vlerësimin akademik të institucionit, por ata shprehin lirshëm dhe në mënyrë anonime edhe vlerësimin institucional, administrativ dhe të shërbimeve. Dokumentacioni referues: [Aneksi 28. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I+II];

	[Dok. Shtesë. Pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok. Shtesë. Pika 7. Platforma e fokusgrupit].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave institucionale vëren që ky standard përmbushet kryesisht duke konsideruar që:</i> - KU "LOGOS" përdor mekanizma dhe procese të qëndrueshme për garantimin e mbikëqyrjes periodike të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional. - Strukturat e ngritura për këtë qëllim bashkëpunojnë në marrjen e vendimeve të cilat u shërbejnë të gjithë aktorëve. Njësia e sigurimit të cilësisë përdor mekanizma të tillë si pyetësorë dhe fokus grupe për të mbledhur vlerësimin e studentëve dhe më pas i analizon të dhënat dhe i publikon në raporte pasi ia ka bërë me dije paraprakisht personelit akademik. - Vëzhgimet në auditor janë mekanizma të tjerë që KU "LOGOS" deklaron se përdor për të garantuar dhe monitoruar cilësinë. <i>Sugjerohet:</i> - Përdorimi i mekanizmave të ndryshëm për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies jo vetëm nga studentët por edhe nga personeli akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" garanton sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm garantohej nëpërmjet përdorimit të mekanizmave vlerësues, analizimi i të dhënave të gjeneruara prej tyre dhe vlerësimi i jashtëm është një proces periodik i akreditimit dhe bashkëpunimit me agjencinë e sigurimit të cilësisë. Aktorë shumë të rëndësishëm të këtij procesi janë edhe studentët të cilët përfshihen ndër të tjera edhe në procese

vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	vendimmarrëse të brendshme, në komisionet e vlerësimit të kurrikulave. Dokumentacioni referues: [Aneksi 15. Rregullore e zyrës studentore]; [Aneksi 5. Rregullore e programit të studimit MSHPP].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ka miratuar akte të brendshme të cilat përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet e aktorëve të angazhuar për të marrë pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë. Anëtarët e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë kanë role dhe detyra specifike të cilat janë të parashikuara edhe në rregulloren e njësisë. Studentët kanë detyrë të jenë objektiv dhe të vërtetë pasi pyetësorët janë anonim. Gjithashtu, lidhur me përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse vlen të theksohet fakti se të drejtat dhe detyrimet e tyre u bëhen me dije paraprakisht. Ata janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 14. Rregullore e Departamentit i Gjuhës dhe Civilizimit Grek]; [Aneksi 24. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë KPGSC]; [Aneksi 70. Kalendari Akademik i KU “LOGOS” 2023-2024]; [Aneksi 71. Vendim për Ngritje Komisioni të Akreditimit të Master i Shkencave në Përkthim Profesional];
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ konstatoi se në procesin e sigurimit të cilësisë janë të përfshirë aktorë të ndryshëm si personeli akademik, studentët, njësitë kryesore dhe njësitë bazë, personeli administrativ. Secili ka detyra të përcaktuara qartë dhe përfshirja e tyre garanton një gjithëpërfshirje në procesin e vlerësimit të cilësisë. Vlerësimi i cilësisë është i brendshëm ku personeli akademik, administrativ dhe studentët angazhohen për shkrimin e raportit dhe mbështetjen e tij në Dokumentacioni referues: konkrete që faktojnë të dhënat e deklaruara si edhe vlerësimit të jashtëm i cili kryhet nga agjencia e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Komunikimi në të dyja rastet është i shpejtë dhe ndërveprimi efikas pasi përveç takimeve fizike komunikimi ruhet edhe nëpërmjet email-it. Dokumentacioni referues: [Aneksi 8. Rregullore e përgjithshme];

	[Aneksi 24. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë KPGSC]; [Aneksi 71. Vendim për Ngritje Komisioni të Akreditimit të Master i Shkencave në Përkthim Profesional].
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” ngarkon me detyrë për të marrë pjesë në proceset të cilat garantojnë cilësinë e institucionit personeli akademik, administrativ dhe studentë të cilët ruajnë integritetin akademik. KU “LOGOS” garanton që vendimet të merren bazuar në aktet nënligjore në fuqi duke lënë mënjanë gjykimet personale ose pabarazinë. Aktet e brendshme e përforcojnë më shumë garantimin e cilësisë pasi këto procedura dhe standarde janë të parashikuara edhe aty. Dokumentacioni referues: [Aneksi 5 Rregullore e Master i Shkencave në Përkthim Profesional]; [Aneksi 24 Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë KPGSC].
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi se KU “LOGOS” konsultohet me bashkëpunëtorë, kolegë dhe ekspertë të jashtëm për të marrë mendime mbi proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimi i jashtëm mund të vijë nëpërmjet leksioneve të hapura, trajnimeve, shkëmbimit me institucione të tjera ose ekspertë të cilët ndihmojnë në mënyrë aktive dhe të drejtpërdrejtë në evidentimin e praktikave më të mira. Dr. Olympia Tsaknaki është një nga ekspertët e jashtëm e deklaruar nga institucioni. Dokumentacioni referues: [Aneksi 68. Procesverbal Dt. 06.08.2024]; [Aneksi 24. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë KPGSC].
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioni dhe vizitave institucionale vëren që ku standard përmbushet plotësisht pasi KU “LOGOS” garanton sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë nëpërmjet mekanizmave vlerësues, analizimit të të dhënave të gjeneruara prej tyre ndërsa vlerësimi i jashtëm realizohet nëpërmjet njësisë së sigurimit të jashtëm të cilësisë apo edhe ekspertëve të jashtëm të cilët përfshihen në këtë proces. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm ofron një objektivitet të proceseve.</i>

	<i>Studentët, personeli akademik dhe administrativ janë gjithashtu të përfshirë në proceset e vlerësimit të cilësisë në këtë institucion. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces janë të njohur paraprakisht jo vetëm për rëndësinë e procesit por edhe për kriteret, detyrimet dhe standardet që ata duhet të përdorin. Këto të fundit janë të parashikuara dhe të dokumentuara në aktet e brendshme e miratuara nga KU "LOGOS".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" ka ngritur një njësi specifike e cila garanton zbatimin e proceseve transparente dhe të ligjshme lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Vlerësimet dhe matjet e performancës bëhen në mënyrë periodike. Të dhënat pasi grumbullohen analizohen dhe më pas bëhen publike me raportimin dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të institucionit. Sikurse deklarohet nga KU "LOGOS" por edhe në aktet e tyre të brendshme, sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohet edhe nëpërmjet përfshirjes në proces të personelit akademik, administrativ dhe të vetë studentëve të cilët shprehin lirshëm mendimin e tyre mbi problematika të caktuara. <i>Për të garantuar transparencë të plotë të vlerësimit GVJ sugjeron përdorimin e formularëve ose mekanizmave matës të cilët vërtetojnë këtë aktivitet.</i> Dokumentacioni referues: [Aneksi 14. Rregullore e Departamentit i Gjuhës dhe Civilizimit Grek]; [Aneksi 24. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë KPGSC]; [http://ëëë.kulogos.edu.al/al/quality-assurance.html].
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" ka miratuar akte të brendshme të cilat parashikojnë mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së institucionit. Publikimi bëhet duke

programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	respektuar parimet e lirisë dhe etikës profesionale dhe akademike si edhe parimi i anonimitetit. Të dhënat përpara se të publikohen analizohen dhe i bëhen me dije personelit akademik. Raportet e publikuara ndihmojnë në vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së institucionit. Dokumentacioni referues: [Aneksi 28. Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]; [Aneksi 18. Raport vjetor KU "LOGOS"]; [Aneksi 19. Raport vjetor FSHHKGJ].
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstatoi kryesisht gjatë vizitave të kryera në institucion se qëllimi i hartimit të mekanizmave matës të cilësisë është jo vetëm të identifikojë problematikat por edhe të marrë masa për përmirësim apo ndërhyrje të nevojshme. Lidhur me programin e studimit master i shkencave në përkthim profesional nuk ka konkretisht masa të marra në këtë kuadër pasi periudha për të cilën është ofruar ky program është shumë e shkurtër. Megjithatë, studentët theksuan se ata ndihen të lirshëm të shprehin mendimin e tyre mbi pakënaqësitë që mund të kenë dhe se për çështje të vogla të cilat kanë pasur nevojë për ndërhyrje, janë marrë masat e caktuara nga eprorët. Dokumentacioni referues: [Aneksi 28. Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]; [Aneksi 32. Pyetësori i vlerësimit të studentëve për lëndët.]
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" ka ngritur strukturat e nevojshme të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë e cila garantohet nëpërmjet përdorimit të mekanizmave vlerësues. Pjesëmarrës në këtë proces janë personelet akademike, administrative dhe vetë studentët. Për të garantuar një proces sa më transparent dhe të drejtë, të dhënat e grumbulluara analizohen dhe u bëhen me dijeni strukturave drejtuese përpara publikimit në faqen zyrtare të institucionit. Studentët nga ana tjetër përfshihen në grupe pune apo komisione si edhe mbledhje ku trajtohen dhe marrin zgjidhje problematikat e tyre. Edhe pse ende për programin e studimit master i shkencave në kërkim shkencor nuk ka pasur ankesa të dokumentuara, studentët pranuan gjatë vizitave në KU "LOGOS" se zëri i tyre është dëgjuar kur ata kanë bërë kërkesa të caktuara.

	Gjithashtu, në kuadër të monitorimit të cilësisë, KU "LOGOS" bën ndryshime të nevojshme në kurrikula, syllabus ose në metodologji të mësimdhënies. Sikurse u përmend edhe më lart, për shkak të kohëzgjatjes shumë të shkurtër të programit të studimit nuk ka një dokumentacion që e vërteton këtë gjë. Dokumentacioni referues: [Aneksi pika 6. Pyetësorët nga sistemi Teams]; [Dok. Shtesë pika 7. Platforma e fokusgrurit]; [Aneksi 1. Statuti i KU "LOGOS"]; [Aneksi 28. Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë];			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se KU "LOGOS" përfshin studentët, personelin akademik dhe administrativ në proceset e vlerësimit të cilësisë jo vetëm për të garantuar procedurat ligjore por edhe për ti ndërgjegjësuar ata mbi rëndësinë e procesit dhe rolit të tyre në këtë institucion. Kjo është edhe arsyeja se pse janë organizuar edhe aktivitete trajnuese, ndërvepruese dhe ndërgjegjësuuese mbi sigurimin e cilësisë, sikurse u deklarua gjatë takimeve në KU "LOGOS". Jo vetëm studentët, por edhe përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin e personelit akademik duke evidentuar problematikat të cilat kanë nevojë për ndërhyrje. Organizimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare të tilla si leksionet e hapura, takime me studentë, takime me personelin akademik apo trajnime të ndryshme, kanë ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë. Dokumentacioni referues: [Aneksi 68. Procesverbal i mbledhjes]; [Aneksi 24. Rregullore e Komisionit të Garantimit të standardeve të Cilësisë].			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave institucionale vëren që ky standard përmbushet kryesisht pasi lidhur me edhe pse rezultatet e pyetësorëve vlerësues bëhen publike, nuk ka një dokument që verifikon planin e masave të nevojshme për tu marrë nga KU "LOGOS" pas publikimit të rezultateve. Ofrohen vetëm rekomandime në raportin e KSGEKC, ndaj dhe sugjerohet hartimi e planit të masave të nevojshme pas marrjes së rezultateve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	----------	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Përkthim Profesional ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Logos”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Marrëdhëniet etike – komunikuese- informative të personelit akademik dhe strukturave të KU “LOGOS” janë të tilla që i ofrojnë studentëve çdo mbështetje dhe nevojë që ata kanë në çdo aspekt.
2. Personeli akademik i huaj është një përparësi dhe një vlerë e padiskutueshme për këtë program studimi sidomos për faktin që është një program në hapat e tij të parë të zhvillimit.
3. Raportet me Universitete të Huaja si ai i Aristotelit, Selanik i mundëson këtij programi jo vetëm përfitim nga përvojat tashmë të konsoliduara rajonale, por edhe një mundësi të mirë për hartimin e programeve për diploma të përbashkëta apo të dyfishta, realizimin e intershipeve dhe mobiliteteve për të ardhmen.
4. Ofrimi i bursave në masë 84% për studentët e këtij programi studimi paraqesin një mbështetje të madhe që u ofrohet studentëve nga DGJCG dhe nga KU “LOGOS”.
5. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional është i kualifikuar dhe profesionist për të dhënë mësim në këtë program.
6. Zyra e çështjeve studentore dhe e këshillimit të karrierës ofron mbështetje për studentët që nga momenti i fillimit të ndjekjes së programit e deri në përfundim të tij. Gjithashtu, zyra dokumenton punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve si edhe organizon aktivitete motivuese me Alumnin.
7. Revista Shkencore Kulogos është një vlerë e shtuar e kësaj IAL.

Pika të dobëta

1. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ka paqartësi lidhur me kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi, kjo lidhur sidomos me gjuhët e programit të cilat nuk janë të përshkruara në mënyrë definitive në dokumente të ndryshme. (Standardi II.1, Kriteri 1; Standardi II.3, Kriteri 2).
2. Gjithashtu rezulton se programi mësimor/ plani mësimor/ syllabuset kanë nevojë për rishikim lidhur me aspekte të trajtuara në standardet përkatëse si:
 - përfshirje e lëndëve lidhur me interpretimin;
 - përfshirje e lëndëve me zgjedhje;
 - përfshirje e gjuhëve të tjera të huaja;
 - shpërndarje më e ekuilibruar e krediteve;
 - hartimin e një manuali/udhëzuesi apo rregulloreje lidhur me praktikën mësimore
 - hartimi i syllabuseve sipas akteve rregullatore në fuqi (Standardi II.1, Kriteri 1; Standardi II.3, Kriteri 1).
3. Nga dokumentet e vëna në dispozicion dhe nga vizitat në institucion verifikohet se Grupet kërkimore- mësimore nuk janë shumë të përfshira në nivel departamenti. (Standardi II.6, Kriteri 3; Standardi II.7, Kriteri 2).
4. Nga dokumentet e vëna në dispozicion aktiviteti kërkimor shkencor i personelit akademik të DGCFG rezulton i limituar. (Standardi II 7, Kriteri 2).

5. Nga dokumentet e vëna në dispozicion rezultojnë të zhvillohen në nivel departamenti aktivitete të ndryshme, por lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional, aktivitetet janë të limituara. **(Standardi II.6, Kriteri 3).**
6. GVJ konstaton nga dokumentacioni i përcjellë, që ngarkesa mësimore e këtij programi e cila duhet sipas ligjit të mbulohet me 70% nga personeli akademik i brendshëm nuk përmbushet duke mos respektuar kështu kuadrin ligjor në fuqi. **(Standardi IV.1, Kriteri 2).**
7. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se edhe pse KU "LOGOS" ofron laboratorë për realizimin sa më profesional të procesit të mësimdhënies, nuk ka laboratorë specifikë të përkthimit për programin Master i Shkencave në Përkthim Profesional **(Standardi IV.1, Kriteri 5).**
8. GVJ konstatoi se dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi buxhetin afatmesëm nuk përputhet me atë që është deklaruar në RVB. Nga dokumentacioni rezultojnë shkresat përcjellëse por nuk ka buxhet bashkëlidhur apo pasqyra financiare që verifikojnë zërat e deklaruar. Informacione të përgjithshme mbi zërat e buxhetit janë pasqyruar vetëm në raportin vjetor të KU "LOGOS" **(Standardi IV.5 Kriteri 1 dhe Kriteri 2).**

Rekomandime

1. GVJ rekomandon saktësimin e gjuhëve të programit;
2. GVJ rekomandon rishikimin e programit/planit mësimor/syllabuseve sipas sugjerimeve të dhëna në standardet/ kriteret përkatëse dhe përshtatjes me kriteret e akteve rregullatore;
3. GVJ rekomandon shtimin e lëndëve të interpretimit; shtimin e lëndëve me zgjedhje; shtimin e ofertës së gjuhëve brenda programit;
4. GVJ duke konsideruar që është një program relativisht shumë i ri gjithsesi rekomandon përfshirjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe projekte në rang DGJCG si dhe përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në mobilitete në të ardhmen;
5. GVJ rekomandon aktivizimin e plotë të grupeve ekzistuese kërkimore- mësimore;
6. GVJ rekomandon aktivizim kërkimor – shkencor më të plotë të personelit akademik të DGJCG;
7. GVJ rekomandon angazhimin e personelit ndihmës akademik me qëllim mbarëvajtjen e procesit mësimor.
8. GVJ rekomandon DGJCG të shtojë mobilitetet si për stafin akademik si për studentët.
9. GVJ rekomandon krijimin e kushteve të përshtatshme për aftësimin në përkthim duke u ofruar studentëve mjedise specifike si laboratorë përkthimi-interpretimi.
10. GVJ rekomandon të respektohet kuadri ligjor në fuqi lidhur me mbulimin e ngarkesës së programit të studimit me 70% të saj me personel të brendshëm.
11. GVJ rekomandon përdorimin e një mekanizmi ku çdo personel akademik deklaron aktivitetin individual kërkimor shkencor të zhvilluar gjatë vitit akademik që është i angazhuar.
12. GVJ rekomandon që Qendra për Mësimdhënien dhe të Nxënët, të zgjerojë aktivitetin e saj duke e bërë atë më efikas dhe me fokus në funksion të formimit të vazhduar të studenteve dhe të personelit akademik.
13. GVJ rekomandon ngritjen e një Zyre Kërkimore Shkencore në funksion të zhvillimit cilësor të kërkimit në nivel IAL (me të cilën ishte përcaktuar një takim gjatë vizitave, por takimi nuk u krye pasi një zyrë e tillë në universitet nuk ishte.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Scientific Master "Professional Translation" provided by the Higher Education Institution "University College Logos"

Strengths and affirmations

1. The ethical - communicative - informative relations of the academic staff and the structures of UC "LOGOS" are such that they offer students every support and need they have in every aspect.
2. Foreign academic staff is an advantage and an indisputable value for this study program, especially due to the fact that it is a program in its first steps of development.
3. Relations with foreign universities such as Aristotle University of Thessaloniki enable this program not only to benefit from already consolidated regional experiences, but also a good opportunity for the design of joint or double degree programs, the realization of internships and mobilities for the future.
4. The provision of scholarships in the amount of 84% for students of this study program represents a great support offered to students by DGJCG and UC "LOGOS".
5. The full-time and part-time academic staff engaged in the Master of Science in Professional Translation study program are qualified and professional to teach in this program.
6. The Student Affairs and Career Counseling Office provides support to students from the moment they begin their program until their completion. The office also documents the employment of students after completing their studies and organizes motivational activities with Alumni.
7. The Kulogos Scientific Journal is an added value of this HEI.

Weaknesses

1. From the documentation made available, it results that there are uncertainties regarding the criteria for admitting students to this study program. This is related to the languages of the program, which are not definitively described in various documents.
2. It also results that the curriculum/teaching plan/syllabuses need to be reviewed regarding aspects addressed in the relevant standards, such as:
 - inclusion of courses related to interpretation;
 - inclusion of elective courses;
 - inclusion of other foreign languages;
 - more balanced distribution of credits;
 - drafting a manual/guide or regulation regarding teaching practice
 - drafting the syllabuses according to the regulatory acts in force
3. From the documents made available and from the visits to the institution, a limited number of mobilities for the academic staff of DGJCG is noted. A similar situation was also noted for student mobilities.
4. From the documents made available and from the visits to the institution, it is verified that the Research-Teaching Groups are not very involved at the departmental level.
5. From the documents made available, reference is made to projects where staff have participated in their drafting but without specifying the specific role played by this staff as well as their products.

(Standard II.6, Criterion 3). In this context, we can also mention the non-involvement of students in these DGJCG projects. (Table 1- 24, tab 10).

6. From the documents made available, the scientific research activity of the academic staff of DGCFG is limited. (Standard ...
7. From the documents made available, various activities are carried out at the department level, but related to the Master of Science in Professional Translation study program, the activities are limited.
8. From the documents made available, no academic support personnel were declared. After GVI requested additional documentation, the CVs of two academic staff of KU "LOGOS" were made available, but this does not confirm their engagement as academic support personnel (Standard IV.1, Criterion 1).
9. GVI ascertains from the attached documentation that the teaching load of this program, which according to the law should be covered by 70% by internal academic staff, is not fulfilled, thus not respecting the legal framework in force.
10. From the documentation made available, it resulted that although KU "LOGOS" offers laboratories for the most professional realization of the teaching process, there are no specific laboratories translation for the Master of Science in Professional Translation program (Standard IV.1, Criterion 5).
11. The GVI found that the documentation made available on the medium-term budget does not match what was declared in the RVB. The documentation results in accompanying letters but there is no attached budget or financial statements that verify the declared items. General information on budget items is reflected only in the annual report of KU "LOGOS" (Standard IV.5 Criterion 1 and Criterion 2).
12. The GVI found that regarding scientific research KU "LOGOS" does not use a mechanism for collecting information from academic staff. This information is provided in a summarized form only in the annual report (Standard VI.2 Criterion 1)

Recommendation

1. GVI recommends specifying the languages of the program;
2. GVI recommends reviewing the program/curriculum/syllabus according to the suggestions given in the relevant standards/criteria and adapting it to the requirements of regulatory acts;
3. GVI recommends adding interpretation courses, increasing the number of elective courses; increasing the number of languages offered within the program;
4. GVI, considering that it is a relatively new program, nevertheless recommends the involvement of students in research activities and projects at the DGJCG level as well as the involvement of academic staff and students in future mobilities;
5. GVI recommends activating existing research-teaching groups;
6. GVI recommends more complete research-scientific activation of the academic staff of DGJCG;
7. GVI recommends the engagement of academic support staff to ensure the smooth running of the teaching process.
8. GVI recommends the creation of appropriate conditions for training in translation by offering students specific environments such as translation laboratories.

9. GVJ recommends respecting the legal framework in force regarding covering the study program workload with 70% of it with internal personnel.
10. GVJ recommends the use of a mechanism where each academic staff declares the individual scientific research activity developed during the academic year in which they are engaged.
11. GVJ recommends the establishment of a Training Center at the HEI level in order to facilitate the continuous training of students and academic staff.
12. 12. GVJ recommends that the Center for Teaching and Learning expand its activity by making it more efficient and focused on the continuous training of students and academic staff.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

